

**Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes**



Viti i 91-të i botimit  
Shtator 2023 / Nr.6

# **Mbrojtja**



**Forcat e Armatosura, garancia e  
vlerave demokratike dhe perëndimore**

**DREJTOR I QKMBMMFA**

ARBEN SKËNDERAJ

**Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktore**

ANJEZA MUSOLLARI

**GAZETARË:**

MIMOZA GOLIKJA

**GRAPHIC DESIGNER**

AFËRDITA HYSAJ

**REDAKTORE / KORREKTORE**

SUELA HODA

**BASHKËPUNËTORË**

KOLONEL HYSNI GJERGJI

GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

DR. ASLLAN ZEMANI

© Ministria e Mbrojtjes

*Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të  
riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfuturi, pa marrë  
autorizim nga botuesit e saj.*

**Botues:**

*Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe  
Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes*

**Adresa:**

*Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"*

*Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:*

*<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja>*



# Mbrojtja

- Ministri Peleshi: Shqipëria do të jetë garant i vlerave demokratike dhe perëndimore, si parime bazë të diplomacisë së Tiranës 4
- Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi merr pjesë në takimin e radhës të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën 5
- Ministri Peleshi: Mirënjohje për mbështetjen e pakushtëzuar të SHBA-së në zhvillimin e kapaciteteve të FARSH-së dhe bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes 6
- Ministri Peleshi pret në vizitën e tij të parë, ministrin e ri të Mbrojtjes së Kosovës Ejup Maqedonci 7
- SHSHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në konferencën e Kartës së Adriatikut 10
- SHSHPPFA, gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Oslo, Norvegji 11
- Gjeneralmajor Arben Kingji priti në një vizitë zyrtare komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia 13
- Komandanta e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade Lisa Hou, vizitë zyrtare në Komandën e FT-së 14
- Përmbillet me sukses stërvitja e përbashkët "Joint Ionian Livex 2023" 16
- Shqipëria, pjesë e samitit "European Senior Enlisted Leader" (ESEL) 18
- "Balkan Master Championship" shpall kampionë përfaqësues të FARSH 20
- Ekipi i Detachmentit CIMIC i Komandës Mbështetëse mori pjesë në stërvitjen "Saber Junction 2023", në Hohenfels, Gjermani 23
- "Njohuritë e rreme", më të rrezikshme se injoranca 24
- Mësim nga Ukraina: "7 kapacitetet kritike për fatin e luftërave të ardhshme" 28
- Kundëradmiral Adnand Agastra: Siguria detare, sfidë e të gjithë kombeve 30
- Femrat, janë një forcë e fuqishme, ato mund të ndryshojnë historinë, të mobilizojnë ushtritë dhe të fillojnë revolucionet 38
- Skënderbegasi Agim Gjini, vend nderi në fushën e shkencës 42
- "Unë arrij në përfundimin se pjesa më e madhe e të këqijave të njerëzimit kanë ardhur nga vlerësimet e gabuara që iu janë bërë vlerave" 44
- Bullizmi, "epidemia sociale" e shekullit XXI 46
- Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, NATO dhe OKB, dialog të gjerë përballë sfidave të sigurisë 48
- Gruaja në politikë, roli dhe rëndësia e saj 52
- Nora e Kelmendit, gruaja e fuqishme shndërruar në legjendë 54
- 'Teutat' shqiptare, entiteti i një kombi 56
- 66 vjet Shërbimi Hidrografik Shqiptar... 60
- Mbi historikun e spitalit ushtarak qendror në Shqipëri 63
- Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile, BMEC e 'Heronjve të Heshtur' të FA-së 67
- Njerëzimi duhet të kujtojë se paqja nuk është dhuratë e zotit për krijesat e tij, paqja është dhuratë jonë për njëri-tjetrin 70
- 11 Shtatori, dita e terrorit që ndryshoi botën 72
- "Është koha për të rregulluar Inteligjencën Artificiale si makinat dhe drogat" 74
- Si po e shkatërrojmë shtëpinë tonë: Njerëzit kanë tejkaluar gjashtë nga nëntë kufijtë për ta mbajtur Tokën të banueshme 76
- Historia e krijimit të qyteteve shqiptare 80
- "Ne kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet" 88
- Ushtria, aty ky nisi rruga për shumë nga yjet e Hollivudit 91
- 81 vjet nga Konferenca e Pezës 96
- Ismail Haki Kuçi, atdhetar i madh i kombit 98

# 24

**Gjeneral brigade  
Ferdinant Dima,  
komandanti i ri  
i Forcës Ajrore**

Forca Ajrore do të drejtohet nga komandanti i ri, gjeneral brigade Ferdinant Dima. Në ceremoninë e kalimit të detyrës ishte i pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi...

# 24

**"Njohuritë e  
rreme", më të  
rrezikshme se  
injanca**

# 04

**Ministri Peleshi: Shqipëria do të jetë garant i vlerave demokratike dhe perëndimore, si parime bazë të diplomacisë së Tiranës**

# 10

**SHSHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në konferencën e Kartës së Adriatikut**

Shefat e Shtabit të vendeve pjesëmarrëse në iniciativën e Kartës së Adriatikut, së bashku me komandantin e Komandës Amerikane në Evropë, gjeneral Christopher Cavoli, përfaqësues të Gardës Kombëtare të SHBA-së dhe të Komandës së NATO-s në Itali, morën pjesë...



**Kundëradmiral Adnand Agastra: Siguria detare, sfidë e të gjithë kombeve**

Intervistë me komandantin e Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura...

Faqe 30



**Femrat janë një forcë e fuqishme, ato mund të ndryshojnë historinë, të mobilizojnë ushtritë dhe të fillojnë revolucionet**

Kolonel Razije Mehmeti, Shefe e Departamentit të Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në FA

Faqe 40





# Shqipëria do të jetë garant i vlerave demokratike dhe perëndimore, si parime bazë të diplomacisë së Tiranës

**P**ërfaqësues të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Departamentit Amerikan të Mbrojtjes zhvilluan në Tiranë, konsultimet dypalëshe në kuadër të bashkëpunimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, duke hedhur kështu bazat e një bashkëpunimi intensiv afatmesëm dhe afatgjatë.

Në takimin mes dy delegacioneve u diskutua mbi situatën aktuale në rajon dhe më gjerë, si dhe Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi konfirmoi gjatë fjalës së tij përkushtimin e vendit tonë në ruajtjen e stabilitetit, paqes dhe sigurisë jo vetëm në rajon, por dhe më gjerë. Ai garantoj se Shqipëria do të jetë gjithmonë garant i vlerave demokratike dhe perëndimore, si parime bazë të diplomacisë së Tiranës.

Ministri Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen e pakushtëzuar të SHBA-së ndaj Shqipërisë. Sipas ministrit Peleshi, bashkëpunimi i shkëlqyer që karakterizon marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve është përkthyer në një kontribut të vyer në përpjekjet e vendit tonë për të qenë eksportues të sigurisë, jo vetëm në rajon, por si një partner i besueshëm i SHBA-ve dhe NATO-s.

Delegacioni amerikan kryesohej nga z. Spencer Boyer, zëvendës ndihmës sekretari amerikan i Mbrojtjes për Politikën Evropiane dhe NATO. Takimi u asistua nga ekspertë të fushës së të dy palëve.

Delegacionet ranë dakord se integrimi në strukturat euroatlantike i të gjithë Ballkanit Perëndimor si dhe prezenca ndërkombëtare në rajon, konsiderohen të domosdoshme dhe faktor stabiliteti. Ky takim zgjeroi linjat e bashkëpunimit me qëllim transformimin e kapaciteteve institucionale të sigurisë dhe ato ushtarake, duke mbështetur dhe zbatuar se bashku projekte konkrete si: mbështetja e FARSH për rritjen e kapaciteteve të Grup - Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë, Mbrojtjen Kibernetike, Edukimin Profesional Ushtarak, Trajnimin dhe Ushtrimet dhe Modernizimin e Forcave Ajrore.

Në përfundim kryetarët e delegacioneve nënshkruan dokumentin bazë, në të cilin përshkruhen hapat konkretë për realizim me sukses të objektivave të parashikuara në planin afatshkurtër dhe afatmesëm. Shtetet e Bashkuara u angazhuan të ofrojnë një mbështetje edhe më të gjerë për përmirësimin e kapaciteteve në përballje me sfidat reale për Forca të Armatosura sa më efikase, në përmbushje të misionit dhe detyrave të tyre.

Zhvillimi i bisedimeve të këtij formati përkon me 30 - vjetorin e nënshkrimit të marrëveshjes së parë kuadër për bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara.

# Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi

## merr pjesë në takim të radhës të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën

Në fokus të takimit ishte konfirmimi i unitetit dhe zotimit të vendeve aleate në vijimin e ndihmës ushtarake dhe humanitare për Ukrainën, të nevojshme për rezistencën ndaj agresionit rus.

**M**inistri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në Takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, që u zhvillua në Bazën Ajrore në Ramstein, Gjermani. Ky ishte takimi i pesëmbëdhjetë, i organizuar nga sekretari i Departamentit të Mbrojtjes së SHBA z. Lloyd Austin dhe kreu i Shefave të Shtabit të Përbashkët të NATO-s, gjeneral Mark A. Milley, me pjesëmarrjen e mbi 50 vendeve aleate dhe partnere të NATO-s

dhe shërben si një platformë për konsolidimin e përpjekjeve ndërkombëtare në mbështetje të Ukrainës.

Në fokus të takimit ishte konfirmimi i unitetit dhe zotimit të vendeve aleate në vijimin e ndihmës ushtarake dhe humanitare për Ukrainën, të nevojshme për rezistencën ndaj agresionit rus.

Në këtë kuadër, edhe vendi ynë është angazhuar krah aleatëve, duke ofruar kontribute ushtarake, si dhe mbështetje diplomatike, politike, ekonomike dhe sociale për Ukrainën.





# Gjeneral brigade Ferdinand Dimo, komandanti i ri i Forcës Ajrore

**F**orca Ajrore do të drejtohet nga komandanti i ri, gjeneral brigade Ferdinand Dimo. Në ceremoninë e kalimit të detyrës ishte i pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, ish-komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj e komandantë të forcave të ndryshme.



Teksa i uroi punë të mbarë në ushtrimin e detyrës së re, gjeneral brigade Ferdinand Dimos, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi shpalosi edhe objektivat që e presin përpara Forcën Ajrore, të cilën e konsideroi një nga strukturat më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, e cila është në mbështetje të përhershme të komuniteteve dhe autoriteteve lokale e qendrore të vendit.

“Baza e parë Ajrore Taktike e NATO-s po ndërtohet në Shqipëri, pikërisht në Kuçovë dhe kjo kërkon padyshim përgjigjen nga ana jonë, me rritje kapacitetesh, rritjen e teknologjisë së integruar dhe aftësive për ta menaxhuar. Jemi në përfundim të investimit, mbi 90 % e të cilit ka përfunduar dhe së shpejti ne presim të bëjmë inaugurimin e të parës bazë taktike”, - u shpreh z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes foli edhe për një tjetër objektiv, ndërtimin e flotës së helikopterëve “Black Hawk”.

“Për të arritur në këtë ditë na është dashur të ecim në një proces jo të lehtë, në krah të partnerëve tanë strategjikë, në një projekt, i cili është menaxhuar dhe ka ardhur tek ne si paketë e plotë që përmban edhe ngritjen e kapaciteteve, trajnimin e helikopterëve, stafit mbështetës, teknikëve të mirëmbajtjes. Pra, është bërë një punë e madhe dhe dua ta falënderoj gjeneral Pulajn dhe të gjithë ata ushtarakë e civilë, që kanë qenë në krah të tij për të arritur deri



këtu. Edhe procesi inovativ dhe risia e ndërtimit të flotës së parë të mjeteve luftarake pa pilot, pra dronëve, është tani në zbatim e sipër. Shpresoj në tremujorin e parë të vitit që vjen ne ta bëjmë atë realitet”, - sqaroi ministri Peleshi.

Sipas tij, pranë Bazës së Kuçovës do të ndërtohet edhe qendra e operimit dhe menaxhimit të kësaj flote të re që ka përdorim jo vetëm ushtarak, jo vetëm në kohë lufte por edhe në kohë paqe, edhe në përdorim civil.

Ministri i Mbrojtjes vlerësoi punën shumë të mirë të Forcës Ajrore gjatë sezonit të zjarreve. “Ky vit është nga më të suksesshmit në menaxhimin e zjarreve. Ka patur mbi 500 vatra zjarri, por po të pyesim qytetarët nuk e kanë perceptuar si shqetësim. Nuk është vetëm çështje fati, por edhe çështje menaxhimi, së pari nga strukturat vendore, por Forca Ajrore ka qenë aty. Nuk ka patur asnjë ankesë publike dhe jopublike për gatishmërinë e helikopterit për mbështetje në vatra zjarri”, - theksoi Ministri Peleshi. “Por, - shtoi ai, - sfidat janë shumë më të mëdha përpara. Çështja e mirëmbajtjes së helikopterëve



është një prej tyre. Duhet të jemi gati për çdo situatë, jo vetëm në kohë paqeje, pasi e kemi të garantuar sigurinë, por për çdo situatë tjetër të cenimit të sigurisë. Deri dje dukej si përrallë nga e kaluara, por lufta në Ukrainë ka treguar që konfliktet sidomos në Ballkanin Perëndimor, një rajon me konflikte të fjetura mund të aktivizohen për shkak të prishjes së ekuilibrave gjeopolitikë që solli lufta në Ukrainë”.

Një projekt tejet i rëndësishëm është edhe ai i Sistemit shqiptar të Mbrojtjes Ajrore. “Ne kemi patur disa sulme kibernetike, të cilat u menaxhuan me sukses, që do të thotë se nuk u arrit nga ana e agresorëve ajo që synonin, fshirja e të dhënave. Por ishte një sulm shumë serioz që na bëri ta vendosim sigurinë kibernetike në rreshtat e para të prioritetëve tona. Dhe po kështu është edhe Mbrojtja Ajrore. Ne po punojmë me Shtabin e Përgjithshëm, për Sistemin shqiptar të Mbrojtjes Ajrore, të cilin tashmë e kemi dizajnuar, kemi projektet, buxhetet e nevojshme. Po diskutojmë edhe me Ministrinë e Financave se si do ta mbulojmë në një periudhë afatmesme këtë shpenzimet për këtë sistem që është i kushtueshëm, por i domosdoshëm në këtë situatë që po jetojmë”, - u shpreh z. Peleshi, i cili i kërkoi komandantit të ri ta kenë në qendër të vëmendjes.

Në fjalën e tij, komandanti i ri i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ferdinant Dima falënderoi ministrin Peleshi dhe presidentin Begaj për besimin e dhënë, ndërsa tha se “Krijimi i Batalionit të Mbrojtjes Ajrore dhe i Detashmentit të Dronëve, pasurimi i fuqisë ajrore me kapacitetet e reja të helikopterëve ‘Black Hawk’, përfundimi i implementimit të sistemeve të SIVHA dhe GAG, i projekteve të ASBE dhe NATINADS do të jenë kryefjala e punës dhe veprimtarisë së përditshme të Forcës Ajrore”.

Nga ana e tij edhe ish-komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj përmendi reformat e kryera deri më tani, duke prekur në veçanti realizimin e mirëmbajtjes së mjeteve ajrore nëpërmjet Agjencisë së Prokurimeve dhe Mbështetjes së NATO-s, e cila, sipas tij, ka bërë që shumë prej problematikave të merrnin rrugën e zgjidhjes.

# Ministri Peleshi: Mirënjohje për mbështetjen e pakushtëzuar të SHBA-së në zhvillimin e kapaciteteve të FARSH-së dhe bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, priti në një takim zyrtar, të ngarkuarin me punë të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë, z. David Wisner.

Ministri vlerësoi rolin dhe përgjegjësitë e misionit të SHBA-së në vendin tonë, duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakushtëzuar të SHBA-së për zhvillimin e kapaciteteve të FARSH-së dhe bashkëpunimin e shkëlqyer në fushën e Mbrojtjes.

Gjatë takimit u diskutua mbi mjedisin aktual të sigurisë, sfidat në kufirin lindor të Aleancës, situatën rajonale dhe luftën në Ukrainë. Fokus të veçantë gjatë këtij takimi mori siguria kibernetike, angazhimet e vendit tonë në kuadër të NATO-s dhe bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes me SHBA-në.

Ministri i Mbrojtjes foli gjithashtu me z. Wisner për rolin dhe angazhimet e vendit tonë për garantimin e paqes dhe sigurisë në rajon, duke u shprehur besimplotë në thellimin e bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes.

Nga të dyja palët u shpreh shqetësimi për konfliktin në Ukrainë dhe rëndësia e mbështetjes nga aleatët. Në të njëjtën



kohë u diskutua për situatën në veriun e Kosovës, si dhe ndikimi i mundshëm në stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Z. Wisner shprehu mirënjohjen e tij për rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe kontributin e vendit tonë për Aleancën, duke vlerësuar Shqipërinë si një vend partner dhe aleat tepër i besueshëm, ku mbështetja e SHBA-së do të jetë e vazhdueshme për përmirësimin e kapaciteteve të FARSH-së në përballje me sfidat e kohës.

## “Medalje Mirënjohje” për kolonelin Nicola Piccolo

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi i akordoi “Medaljen e Mirënjohjes”, kolonelit Nicola Piccolo, në përfundim të mandatit të tij si Atashe Ushtarak i Republikës së Italisë, në Shqipëri.

Në fjalën e tij ministri Peleshi vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm në fushën e mbrojtjes si dhe shprehu mirënjohjen për kontributin e vazhdueshëm të vendit mik, në edukimin dhe trajnimin e personelit të FA-së!



# Ministri Peleshi pret në vizitën e tij të parë, ministrin e ri të Mbrojtjes së Kosovës, Ejup Maqedonci

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji, priti ministrin e ri të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, z. Ejup Maqedonci si dhe delegacionin që e shoqëronte.

Ministri Peleshi vlerësoi faktin që vizitën e parë zyrtare si ministër i Mbrojtjes, z. Maqedonci e zhvilloi në Tiranë, duke demonstruar dhe njëherë rëndësinë e marrëdhënieve, miqësinë dhe bashkëpunimin midis dy shteteve tona.

Z. Peleshi i shprehu z. Maqedonci urimet më të mira për emërimin në këtë detyrë. Diskutimet mes dy ministrave u fokusuan në bashkëpunimin dypalësh në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes si dhe vlerësimin e mundësive mbi intensifikimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Gjithashtu dy ministrat biseduan për situatën në rajonin e Ballkanit Perëndimor, bashkëpunimin rajonal si dhe sfidat, me të cilat rajoni po përballet.

Ministri Peleshi siguroi ministrin Maqedonci, se Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë do të vijojë kontributin e saj në promovimin e “Politikës së Dyrve të Hapura” në të gjitha iniciativat rajonale



dhe ndërkombëtare, duke ndihmuar kështu anëtarësimin e Kosovës në veçanti, por dhe çdo vendi tjetër në Ballkanin Perëndimor që aspiron integrimin në strukturat euroatlantike.

Nga ana e tij ministri Maqedonci shprehu falënderimet për mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë ndaj çështjes së Kosovës, ndërsa u ra dakord për identifikimin e fushave të reja të bashkëpunimit për të intensifikuar më tej raportet mes Kosovës e Shqipërisë.

## Peleshi pret komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, priti gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, me rastin e përfundimit të mandatit të tij si komandant i Misionit të KFOR-it. Ministri Peleshi nënvizoi rëndësinë e prezencës së KFOR-it në Kosovë si kontribuues në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon si dhe vlerësoi rolin e gjeneralmajorit Ristuccia në drejtimin e këtij misioni.

Ministri i Mbrojtjes dhe gjeneralmajor Ristuccia diskutuan mbi situatën aktuale të sigurisë në rajon dhe ndanë shqetësimet mbi trazirat e ndodhura së fundmi në Kosovë. Z. Peleshi falënderoi gjeneralmajorin për rolin aktiv në menaxhimin e situatës dhe parandalimin e përshkallëzimit të mëtejshëm. Ministri i Mbrojtjes nënvizoi edhe njëherë rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit dhe Ohrit si dhe riaktiv-



izimin e dialogut si e vetmja mënyrë për normalizimin e marrëdhënieve dhe gjetjen e zgjidhjeve afatgjata politike midis Kosovës dhe Serbisë. Në fund të takimit ministri i Mbrojtjes i dorëzoi gjeneralmajorit Angelo Michele Ristuccia “Medaljen

e Mirënjohjes”, për përkushtimin e tij në mbarëvajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Republikën e Kosovës dhe mbështetjen e tij të pakursyer ndaj kontingjentit ushtarak shqiptar që shërben në Misionin e KFOR-it.



# SHSHP të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në konferencën e Kartës së Adriatikut

**S**hefat e Shtabit të vendeve pjesëmarrëse në iniciativën e Kartës së Adriatikut, së bashku me komandantin e Komandës Amerikane në Evropë, gjeneral Christopher Cavoli, përfaqësues të Gardës Kombëtare të SHBA-së dhe të Komandës së NATO-s në Itali, morën pjesë në Konferencën e 26-të të Kartës së Adriatikut, e cila u zhvillua në Shkup, Maqedoni e Veriut.

Kjo konferencë përkon me 20 - vjetorin e kësaj nisme rajonale, e cila përveç rolit të pazëvendësueshëm në integrimin euroatlantik të anëtarëve të saj, ka kontribuar në operacione paqeruajtëse në Afganistan dhe Irak.

Fokusi i konferencës ishte intensifikimi i luftës së informacionit, sfidat dhe mundësitë që e shoqërojnë atë në mjedisin modern të sigurisë.

SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji, në fjalën e tij në këtë konferencë, fillimisht theksoi përkeqësimin e mjedisit të sigurisë si rezultat i luftës në Ukrainë dhe mbështetjen që vendi ynë, krahas me vendet aleate dhe partnere, ka dhënë dhe do të vijojë të japë në mbështetje të Ukrainës. Më tej, gjatë fjalës së tij gjeneralmajor Kingji u ndal dhe në karakteristikat e mjedisit të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, përkeqësimin e saj në veri të Kosovës, ku dhe dënoi me forcë sulmin terrorist si pasojë e të cilit humbi jetën në krye të detyrës një nënoficer i Policisë së Kosovës. Gjeneralmajor Kingji vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të KFOR-it për sigurinë në Kosovë, duke vënë theksin në nevojën për rritjen e masave të sigurisë në veri të Kosovës, për të shmangur ngjarje të tilla të jashtëzakonshme. Në vijim të fjalës së tij referuar temës së konferencës, gjeneralmajor Kingji trajtoi paqartësinë e kufijve të luftës së informacionit dhe rritjen e rëndësisë së saj në kushtet e zhvilli-

meve teknologjike të ditëve të sotme, duke sjellë në vëmendje sulmet kibernetike ndaj vendit tonë dhe rritjen e masave dhe kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike, të mundësuar në bashkëpunim me SHBA-të.

Duke u kthyer tek rëndësia e Kartës së Adriatikut, gjeneralmajor Kingji theksoi rezultatet e prekshme të kësaj iniciative dhe bëri thirrje për zgjerimin e saj me anëtarë të rinj, si Kosova, të cilët do t'i japin shtysë të mëtejshme bashkëpunimit rajonal, stabilitetit të rajonit dhe angazhimit të vendeve anëtare në operacione ndërkom-bëtare të mbështetjes së paqes.

Në përfundim të fjalës së tij, gjene-ralmajor Kingji shprehu an-gazhim për rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe kënaqësinë për t'u takuar vitin tjetër në Shqipëri, në cilësinë e vendit pritës të inicia-tivës për vitin që vjen.





# SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në Oslo, Norvegji

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel Shef Shtabi, të mbajtur në Oslo, Norvegji. Takimi u drejtua nga kryetari i Komitetit të NATO-s, admiral Rob Bauer, me mbështetjen e komandantit Suprem të Aleancës në Evropë, gjeneral Cavoli, dhe komandantit të Lartë të Aleancës për Transformim, gjeneral Lavigne.

Gjatë punimeve të këtij takimi, përfaqësuesit e lartë ushtarakë diskutuan mbi një seri temash, të cilat përfshinin materializimin e vendimeve të marra gjatë Samitit të Vilnius, shkurajimin dhe mbrojtjen, aftësinë për të zbatuar planet rajonale si pjesë e familjes së planeve të NATO-s, përshtatjen e strukturave të komandim - kontrollit të NATO-s, situatën në Ukrainë dhe ndikimin e saj në zonën euroatlantike.

Në fjalën e tij përshëndetëse në hyrje të takimit, admiral Bauer, pasi përshëndeti përfaqësuesit norvegjezë për organizimin e konferencës, theksoi ndër të tjera: "...Sot, si asnjëherë më parë në historinë e NATO-s, planet e mbrojtjes kombëtare të vendeve aleate janë të ndërthurur me planet e mbrojtjes së NATO-s. Planet për të cilat u ra dakord në Samitin e Vilnius-it do të ndikojnë në zhvillimin e Forcave tona të Armatosura për dekadat në vijim..."

Një sesion i veçantë në këtë takim iu kushtua gjithashtu situatës në Ukrainë. Në fjalën e tij gjatë këtij sesioni, gjeneralmajor Kingji njohu pjesëmarrësit me mbështetjen që vendi ynë ka dhënë për trajnimin dhe mbështetjen me armatim, municione dhe automjete për forcat ukrainase, si dhe gatishmërinë e vendit tonë për ta vijuar këtë mbështetje dhe në të ardhmen.

Po kështu, gjeneralmajor Kingji theksoi ndikimin që lufta në

Ukrainë ka pasur në mjedisin global të sigurisë dhe nevojën për të mos shmangur nga vëmendja një ndikim të mundshëm në mjedisin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor.

Në lidhje me këtë pikë, gjeneralmajor Kingji theksoi rolin e KFOR-it për sigurinë në Kosovë dhe me gjerë, si dhe angazhimin e tij për mbështetjen e këtij operacioni të NATO-s.

Në sesionin të dedikuar mbi aftësinë për të ekzekutuar planet e Aleancës, ku përfshihet mbështetja logjistike, mbështetja e vendit pritës, lëvizja e kapaciteteve ushtarake dhe sigurimi i rezervave, gjeneralmajor Kingji theksoi se, "Përfshirja nga Bashkimi Evropian i Korridorit 8 në rrjetin kryesor transevropian, ka një rëndësi të veçantë për lëvizjen e forcave dhe mjeteve nga brigjet e Adriatikut deri në kufijtë lindorë të Aleancës, dhe në këtë kuadër vendi ynë me aeroportin e Kuçovës dhe cilësitë e portit të ri të Porto Romanos, ofron gjithë kapacitetet për të mbështetur lëvizjen e forcave", - u shpreh SHSHPFA, gjeneralmajor Kingji në fjalën e tij në këtë takim.





# SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti në takim zëvendës ambasadorin e SHBA-së, David Wisner

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji zhvilloi një takim zyrtar me zëvendës ambasadorin dhe të ngarkuarin me punë në ambasadën amerikane, z. David Wisner.

Takimi u fokusua në bashkëpunimin e suksesshëm në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes midis dy vendeve dhe forcave të armatosura.

Gjeneralmajor Kingji fillimisht i uroi mirëseardhjen zëvendës ambasadorit dhe të ngarkuarit me punë në ambasadën amerikane, si dhe e falënderoi atë për mbështetjen e vazhdueshme që SHBA-ja ka dhënë dhe vijnë të japin për Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura.

Më tej gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit u shprehën optimistë për arritjet e deritanishme, të cilat do të njohin progres edhe në takimin dypalësh në fushën e Mbrojtjes, që do zhvillohet këtë muaj në vendin tonë.

Zëvendës ambasadori, pasi falënderoi shefin e Shtabit të

Të dy bashkëbiseduesit u shprehën optimistë për arritjet e deritanishme, të cilat do të njohin progres edhe në takimin dypalësh në fushën e Mbrojtjes, që do zhvillohet këtë muaj në vendin tonë.

Përgjithshëm të FARSH-së për pritjen, theksoi ndër të tjera se SHBA-ja do të vijojë mbështetjen për modernizimin e FARSH-së, me qëllim që Shqipëria të japë një kontribut gjithmonë e më të madh për sigurinë, stabilitetin e paqen përkrah aleatëve të saj.

# Gjeneralmajor Arben Kingji priti në një vizitë zyrtare komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia

**K**omandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, me rastin e përfundimit të detyrës, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ku u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji.

Fokusi kryesor i vizitës ishte rritja e bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të RSH dhe misionit të NATO-s, arritjet dhe problematikat e evidentuara prej tij gjatë mbajtjes së detyrës si komandant i KFOR-it, në Kosovë.

Shefi i SHPFA, gjeneralmajor Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen, e falënderoi gjeneralmajorin Ristuccia për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar gjatë periudhës që ai ka mbajtur detyrën e rëndësishme të komandantit të KFOR-it, për mbështetjen e personelit të FA-së që shërbejnë në këtë operacion, si dhe për rolin që KFOR-i ka luajtur për sigurinë në Kosovë dhe në rajon. Më tej, gjeneralmajor Kingji, theksoi se po ndjek me vëmendje situatën e krijuar në veri të Kosovës, dënoi dhunën e ndodhur në fund të muajit maj ndaj personelit të KFOR-it, forcave të sigurisë dhe gazetarëve, dhe theksoi nevojën që të gjitha palët të angazhohen në dialog konstruktiv dhe të shmangen ngjarje të kësaj natyre.

Në përfundim të fjalës së tij, gjeneralmajor Kingji theksoi



angazhimin për të kontribuar në misionin KFOR për sa kohë të jetë e nevojshme, mbështetjen për Forcat e Sigurisë së Kosovës në fushën e arsimit dhe stërvitjes, si një forcë profesioniste, shumë

etnike, e cila do të kontribuojë në rritjen e sigurisë në Kosovë.

Nga ana e tij gjeneralmajor Ristuccia, pasi falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingjin për mikpritjen dhe mbështetjen e vazhduar të Shqipërisë në misionin KFOR, theksoi performancën e lartë të personelit tonë në këtë strukturë dhe rolin e tyre në krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt në Kosovë.

Gjatë takimit u diskutuan gjithashtu çështje që lidhen me situatën e sigurisë në Kosovë dhe rajon, duke evidentuar dhe disa nga masat që duhen marrë për përballimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që i kanosen zonës së këtij operacioni.



# Komandantja e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade Lisa Hou, vizitë zyrtare në Komandën e FT-së

**N**ë kuadër të programit të konsultimeve dypalëshe Shqipëri - Shtetet e Bashkuara të Amerikës, komandantja e Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, gjeneral brigade Lisa Hou zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën e Forcës Tokësore. Qëllimi i vizitës ishte informimi mbi ecurinë e aktiviteteve dhe bashkëpunimit të Forcës Tokësore me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, si dhe diskutimi i nevojave dhe mundësive për bashkëpunimin gjatë vitit 2024.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, pasi i uroi mirëseardhjen gjeneral brigade Lisa Hou, shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e ngushtë e të frytshëm me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit. Ai vlerësoi profesionalizmin dhe performancën e ekipeve trajnuese të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit dhe SFAB-it, përgjatë zhvillimit të stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta, kryesisht me Batalionin e Dytë të Këmbëorisë dhe strukturave GBKL, me fokus zhvillimin e kapaciteteve të mirëmbajtjes logjistike, aftësimin e trupës së oficerëve dhe nënoficerëve, përmirësimin e procedurave standarde ushtarake, përdorimin e teknikës së re dhe armatimit, mbrojtjen ndaj armëve të dëmtimit në masë, trajnimit të personelit mjekësor dhe përgatitjen e tyre për certifikimin "MEDEVAL".

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia theksoi se: "SHBA është aleati ynë më i rëndësishëm dhe i jemi mirënjohës për bashkëpunimin dhe marrëdhënien e shkëlqyer që ekziston mes dy vendeve tona. Mbështetja e dhënë ndër vite, ka përmirësuar kapacitetet operacionale dhe ndërvepruese të strukturave të Forcës Tokësore".

Gjatë fjalës së tij në takim, gjeneral brigade Xhebexhia solli në vëmendje nisjen e një sërë projektesh të rëndësishme të modernizimit me SHBA-të, duke u bazuar edhe në strukturën e re organizative të Forcës Tokësore. "...vijimi i bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit dhe



mbështetja me ndihma dhe ekipe trajnimi e këshillimi nëpërmjet programeve të ndryshme të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes gjatë vitit 2024 e në vijim, do t'i shërbejë rritjes së kapaciteteve dhe aftësive operacionale të strukturave prioritare të FT-së, për t'iu përgjigjur në çdo kohë sfidave të ndryshme brenda e jashtë vendit, u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Xhebexhia. Nga ana e saj, gjeneral brigade Lisa Hou, pasi e falënderoi komandantin e Forcës Tokësore për mikpritjen dhe njohjen me zhvillimet dhe përmirësimet e kapaciteteve

operacionale në Forcën Tokësore, theksoi se bashkëpunimi midis Gardës Kombëtare të Nju Xhersit dhe Forcës Tokësore do të vazhdojë jetë gjithmonë në rritje me qëllim zhvillimin e një force të mirë trajnuar dhe aftë të ndërveprojë me vendet partnere të NATO-s. "Këtij bashkëpunimi do t'i shërbejë dhe vizita gjatë muajit tetor 2023 e një ekipi të Forcës Tokësore në Gardën Kombëtare të Nju Xhersit, ku ndër të tjera do të diskutohen edhe aktivitetet e përbashkëta në fushën e mbrojtjes gjatë vitit 2024", - u shpreh gjeneral brigade Lisa Hou.





# Prezantohet komandanti i ri i Batalionit të Mbështetjes me Luftim

**N**ë garnizonin Babrru u zhvillua ceremonia e prezantimit në detyrë të komandantit të Batalionit të Mbështetjes me Luftim, nënkolonel Edvis Spahi. Prezantimi i tij, u bë nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, i cili e vlerësoi nënkolonelin Spahi si një ushtarak me eksperiencë dhe formim të lartë profesional.

“Puna e bërë në këtë repart, disiplina dhe profesionalizmi i treguar në trajnime dhe stërvitje brenda dhe jashtë vendit, si dhe angazhimet në mision në kuadër të NATO-s, më forcojnë besimin se nën drejtimin e komandantit të ri, me përvojën që ai mbart, përkushtimin ndaj detyrës dhe kërkesat e larta, do të bëjë që ky repart, t’i çojë më tej arritjet në të gjithë spektrin e detyrave të ngarkuara për përmbushjen e misionit”, - tha në fjalën e tij gjeneral brigade Xhebexhia.

Nga ana e tij, nënkolonel Spahi shprehu mirënjohjen personale për leadershipin politik dhe atë ushtarak, për besimin e treguar me emërimin e tij në këtë detyrë të lartë.

Ai, i garantoj ata se përkushtimi në detyrë, përgatitja profesionale dhe gatishmëria e efektivit të Batalionit të Mbështetjes me Luftim, do të jenë gjithmonë në nivelin e detyrës kudo dhe kurdo, që të kërkohet kontributi i tyre si brenda ashtu edhe jashtë vendit.



## Starton Stërvitja Individuale Bazë në QAPU

Në QAPU dhe FT (b1k & b3k), startoi Stërvitja Individuale Bazë.

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, dhe në repartet e FT (b1k & b3k), për 10 javë rresht, 160 vajza e djem nga të katër anët e vendit, do të trajnohen në programin e SIB, program intensiv dhe i larmishëm që synon transformimin e civilëve të rekrutuar në qytetarë me uniformë.

“Atdhedashuria dhe profesionalizmi janë pjesë përbërëse e këtij programi. Përgatitja për shërbim ndaj vendit, për 160 rekrutët filloi!”





# Përmbillet me sukses stërvitja e përbashkët "Joint Ionian Livex 2023"

**P**as diskutimeve në nivel të lartë në Athinë, vitin e kaluar dhe dëshirën e mirë të Forcave Detare të të dy vendeve, këtë vit u finalizua me sukses stërvitja e parë bilaterale e përbashkët, "Joint Ionian Livex 23", ndërmjet Forcës Detare Shqiptare dhe Forcës Detare të Greqisë, stërvitja u zhvillua në ujërat e detit Jon.

Në këtë stërvitje të përbashkët morën pjesë 2 anije të Forcës Detare shqiptare, anija Iliria P-131 dhe Oriku P-132 si dhe anija e Forcës Detare greke Troupakis P-23.

Gjatë tri ditëve në det anijet zhvilluan stërvitje për procedurat e zhvillimit të operacioneve të kërkim - shpëtimit SAR, operacionet e zbatimit të ligjshmërisë, procedurat e ndalimit në det, formacione të ndryshme lundrimi, furnizimi në det, mbrojtja e afërt e anijeve nga sulmet asimetrike. Stërvitja u zhvillua bazuar në procedurat standarde të NATO-s, për zhvillimin



e operacioneve detare.

Në ceremoninë përmbylëse të aktivitetit në portin e Sarandës, stërvitja u ndoq nga afër në det nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, si dhe përfaqësuesi i Forcës Detare greke komo-

dor Vasileios Gyparis. Gjithashtu në ceremoni morën pjesë dhe autoritetet lokale të qytetit të Sarandës. Ky aktivitet luan një rol të rëndësishëm në rritjen e sigurisë detare, ndërveprueshmërisë ndërmjet dy vendeve dhe stabilitetit në rajon.

# Forca Detare përcjell Kontingjentin II në misionin në detin Egje

Në Komandën e Forcës Detare, u zhvillua ceremonia për përcjelljen e Kontingjentit II për në operacionin e NATO-s në detin Egje. Të pranishëm në ceremoni ishin gjeneralë, drejtorë të shtabit, komandantë të forcave dhe personel të shtabit të Forcës Detare. Në fjalën e tij komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra u shpreh ndër të tjera: “Në vijim të angazhimeve tona në NATO, po zhvillojmë ceremoninë e përcjelljes në mision Kontingjentit II të Forcës Detare, të përbërë nga 21 efektivë në aktivitetin e NATO-s në detin Egje. Efektivët e Kontingjentit II, me marrjen e detyrës dhe anijes “Butrinti P - 134”, do të kalojnë nën komandën e Grupit II të Gatshëm Detar të NATO-s dhe do të kryejë detyrat e patrullimit në zonën e saj të përgjegjësisë me qëllim parandalimin e fluksit të emigrantëve të paligjshëm dhe, ajo që është më kryesorja, vijimi i suksesit për shpëtimin e njerëzve, të cilët mund të jenë në rrezik për jetën e tyre në ujërat e detit Egje. Efektivëve të Kontingjentit II i



uroj rrugë të mbarë, suksese në shërbimin tuaj ndaj atdheut dhe Aleancës dhe erëra të mbara gjatë kryerjes së detyrës tuaj në zonën e operacionit.” Ceremonia vijoi me dorëzimin e Flamurit

Kombëtar nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, komandantit të kontingjentit kapiten i Rangut III Ilir Nezha, i cili do të drejtojë kontingjentin për tre muajt në vazhdim.

## Suksesi i radhës i anijes “Butrinti” në detin Egje

Anija P-134 “Butrinti”, pjesë e misionit “SNMG2 TU 01”, vuri re një gomone me 16 emigrantë nga Sudani dhe Somalia, mes tyre 6 gra. Emigrantët po tentonin kalimin drejt Greqisë në rrugë të paligjshme. Në bashkëpunim me dy anijet e Rojës Bregdetare greke (P-27 dhe LS 611) ky mision përfundoi me sukses. Emigrantët u shoqëruan drejt portit të Chios, Greqi.



# Shqipëria, pjesë e samitit “European Senior Enlisted Leader” (ESEL)

European Senior Enlisted Leader Summit (ESEL) - Samiti i nënoficerëve të lartë të forcave ajrore, i zhvilluar për herë të parë në Slloveni nën drejtimin e Komandës së Forcave Ajrore Amerikane për Evropën & Afrikën dhe Regjimentin e 15-të të Forcave Ajrore Sllovene, bëri bashkë 29 shtete të përfaqësuar nga nënoficerët e lartë të forcave ajrore.

Samiti kishte si qëllim forcimin e respektit, besimit dhe bashkëpunimit midis Forcave Ajrore partnere dhe aleate. Gjithashtu ndër të tjera në këtë samit u fol për rolin e nënoficerit në marrëdhënien me eporët dhe vartësit, roli i tyre në luftën asimetrike, u fol për programin e partneritetit dhe shumë pika të tjera të rëndësishme. Diçka e veçantë në këtë samit ishte edhe njohja me situatën në Ukrainë nga nënoficeri i Forcës Ajrore të Ukrainës.



Në ambientet e Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, priti në një takim kortezie, Atasheun Ushtarak të Turqisë për Shqipërinë, kolonel Muhamet Kelami Kablay dhe zëvendës Atasheun, kapiten Celal Tekin.

Gjeneral Pulaj, e falënderoi Atasheun për kontributet që Turqia ka dhënë për Forcën Ajrore.

Gjithashtu, gjatë takimit u diskutua krijimi i kapaciteteve fillestare operationale për përdorimin e dronëve.

Në përfundim të takimit, gjeneral Pulaj, falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Ajrore dhe i uroi suksese të mëtejshme në detyrë, duke e siguruar se bashkëpunimi do të vazhdojë dhe në të ardhmen.

## Komandanti i Forcës Ajrore priti Atasheun Ushtarak të Turqisë



# Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit të XIV bazë të Forcave Speciale

Në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të XIV bazë të Forcave Speciale.

Në këtë aktivitet morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtorë nga Shtabi i Përgjithshëm, komandantë të reparteve të vartësisë të FT, përfaqësues nga Operacionet Speciale të Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe miq dhe familjarë të kursantëve specialë. Ceremonia filloi me një demonstrim stërvitor të përgatitur nga kursantët, duke kryer veprime taktike si: luftim i afërt, goditje objekti, qitje ndaj objektivave të lëvizshme, qitje me precizion, qitje me pengesa, qitje me snajper etj.

Në fjalën e tij, komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale nënkolonel Ajet Jata, theksoi ngarkesën e lartë stërvitore në këtë kurs, e cila ka patur si qëllim t'i për-



gatisë kursantët si operatorë të Forcave Speciale me të gjitha aftësitë taktike dhe psikologjike, si dhe përmirësimin e aftësive profesionale, drejtuese dhe luftarake për të qenë të suksesshëm në të gjithë spektrin e gjerë të operacioneve speciale.

Ceremonia vijoi me fjalimet e dy kursantëve më të mirë, shpërndarjen e certifikatave dhe vendosjen e beretës së kuqe nga kursantët e certifikuar.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi gjithë personelin që mori pjesë në këtë kurs dhe theksoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kursi i XIV bazë i Forcave Speciale u zhvillua për një periudhë 6 - mujore me pjesëmarrjen e kursantëve nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës.

## Qendra Shëndetësore ROL-L përfundon me sukses stërvitjen “Pre-Medeval Evaluation”

Qendra shëndetësore Rol - 1 e batalionit të dytë të këmbësisë përfundoi me sukses stërvitjen mjekësore nën mbikëqyrjen e vlerësuesve “MEDEVAL” nga Garda Kombëtare e Nju Xhersi dhe United States Air Forces in Europe – Air Forces Africa. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte përgatitja e personelit të qendrës shëndetësore Rol - 1 për vlerësimin NATO MEDAVAL.

Gjatë stërvitjes u inskenuan situata të ndryshme si: vizita rutinë, dhënia e ndihmës së parë në fushën e luftimit, tërheqja taktike e të dëmtuarve, evakuimi mjekësor për në Rol-1, dhënia e ndihmës mjekësore dhe stabilizimi në qendrën shëndetësore Rol-1, 9-linjat e MEDEVAK-ut, dhe evakuimi i të dëmtuarve në Rol-2 dhe 3. Gjithashtu gjatë stërvitjes u inskenuan



edhe situatat MASKALL, dhe CBRN.

Personeli shëndetësor i angazhuar në stërvitje, tregoi përkushtim dhe profesionalizëm të lartë në të gjitha fazat e zhvillimit të stërvitjes, si nga ana taktike në tërheqjen e të dëmtuarve nga fusha e luftimit, evakuimin e tyre në pikën e grumbullimit të të dëmtuarve, evakuimin e tyre në Rol-1 dhe Rol -2; ashtu edhe nga përgatitja profesionale në menaxhimin e traumave të ndryshme të inskenuara gjatë stërvitjes, menaxhimin e situatës MASKALL dhe triazhimit e të dëmtuarve.

Në përfundim të stërvitjes, ekipi para-vlerësues, pasi shprehu konsideratë të lartë për angazhimin dhe profesionalitetin e treguar gjatë stërvitjes nga ekipi mjekësor Rol - 1, shpërndau certifikatat e vlerësimit për pjesëmarrësit në stërvitje.



# “Balkan Master Championship” shpall kampionë përfaqësues të FARSH

Ekipi i Forcave të Armatosura që mori pjesë në kampionatin “Balkan Master Championship” në Izmir, Turqi, arritën të shpallen kampionë në disa disiplina në atletikë, hedhje gjyle dhe kërcim së gjati.

Major Bledar Mesi u shpall kampion në garën 3000 m me pengesa, i dyti në 800 metra dhe i pari në garën 400 m me pengesa.

Major Gernat Qirici kampion në disiplinën e 400 metrave me pengesa.

Major Ervin Hysi, u shpall kampion në disiplinën e kërcimit së gjati.

Major Edison Kaja u shpall kampion në hedhje gjyle.

Mirënjohje për të gjithë efektivat tanë që ngrenë lart Flamurin Kombëtar dhe sa më shumë suksese në aktivitetet e ardhshme.



# “Voskopoja edicioni i 6”, shpal fitues përfaqësues të AFA-së

Në Voskopojë, Korçë, për herë të gjashtë u zhvillua aktiviteti ndërkombëtar “Shtegu i ujkut” në distancën 5 km/10 km dhe 21 km, për femra dhe meshkuj.

“Trail Running Albania” së bashku me organizatorin, zotin Altin Sholla në bashkëpunim me Bashkinë Korçë organizuan aktivitetin për promovimin e sportit dhe turizmit në vendin tonë.

Nga AFA mori pjesë major

Bledar Mesi, i cili zuri vendin e parë në garën 10 km.

Në ceremoninë përfundimtare për fituesit u shpërndanë kupat dhe çmimet e vendeve të nderit, ku spikati personeli i AFA-së.



Kategoria 10 km, vendi i parë major Bledar Mesi.

Në fund të aktivitetit u krye edhe foto e përbashkët e aktivitetit sportiv “Voskopoja edicioni i 6”.

Studentët e ciklit të parë Bachelor, viti i dytë, në kuadër të programit të tyre ekstrakurrikular, në bashkëpunim me departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave të Komunikimit, zhvilluan vizitën studimore në ishullin e Sazanit.

Qëllimi i vizitës ishte njohja me pozicionin strategjik të këtij ishulli gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë. Gjithashtu studentët patën mundësi të shkëmbejnë njohuritë e tyre mbi lundrimin, të drejtën ndërkombëtare të lundrimit me ekuipazhin e anijes “Oriku”.

Pedagogët sollën shembuj konkretë të shfrytëzimit të gjirit të Vlorës si një aset shumë i rëndësishëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si para viteve 90’ të ashtu dhe në ditët e sotme. Stafi i FMS falënderon ekuipazhin e anijes “Oriku” për mundësimin e kësaj vizite.

Më pas studentët realizuan një vizitë kulturore-historike. Duke filluar nga Qafa e Llogorasë, ku studentët u njohën me “Pishën flamur”, një monument natyror, pastaj qëndruan në pikën panoramike “Ballkoni i Llogorasë”, për të vijuar më tej në kalanë e Porto Palermos, Kalanë e Lëkurësit, Butrint, etj. Në çdo pikë qëndrimi u zhvilluan shpjegime nga ana e pedagogëve për vlerat kulturore-historike dhe strategjike të këtyre vendeve. Në qytetin antik të Butrintit studentët u njohën me vlerat historike që nga periudha antikitetit deri në shekullin e XX.





## Përfundon ura në fshatin Gjeroven, bashkia Berat

Specialistët e kompanisë së urave të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse, përfunduan montimin e urës 54 m 2/1 në fshatin Gjeroven, bashkia Berat. Kjo urë, e cila lidh dy njësitë administrative: njësinë Velabisht me pjesën e njësisë administrative të Sinjës, do u shërbejë rreth katër fshatrave me rreth 800 banorë si pikë lidhëse me fshatin Gjeroven dhe do u shërbejë banorëve kalimin normal në periudhat vjeshtë - dimër për në fshatrat e tyre.

Ura është e gjatë 54 m dhe rreth 2 m e gjerë dhe mund të mbajë peshë deri në 40 ton.

## Përfundon me sukses operacioni EOD në Shkodër

Një grup EOD i Batalionit të Xhenios, kreu një operacion për eliminimin e municioneve të paplasura në fshatin Hajmel, bashkia Vau Dejës.

Gjatë rikonicionit u konstatuan: një predhë artilerie 120 mm dhe një predhë mortaje 81 mm.

Municionet u quajtën të sigurt, të lëvizshme dhe u magazinuan në depot e Batalionit të Xhenios. Operacioni përfundoi me sukses.



## Efektivët shqiptarë përfunduan me sukses misionin në Greqinë e goditur nga zjarret

Efektivët shqiptarë përfunduan me sukses misionin në Greqinë e goditur nga zjarret masive.

Ekipi, i përbërë nga punonjës të specializuar të emergjencave civile dhe bashkive të Korçës dhe Maliqit, u angazhua në operacionet e ndihmës për shuarjen e zjarreve në Greqi dhe tashmë kthehet në atdhe me vetëdijen e detyrës të plotësuar si dhe me ndjenjën e krenarisë për kontributin e tyre në ndihmën e popullit mik grek në kohë të vështira.





## Ekipi i Detashmentit CIMIC i Komandës Mbështetëse mori pjesë në stërvitjen “Saber Junction 2023”, në Hohenfels, Gjermani

Një ekip prej shtatë efektivësh nga Detashmenti CIMIC i Komandës Mbështetëse, mori pjesë për herë të parë në stërvitjen “Saber Junction 2023” në Qendrën e Përbashkët Shumëkombëshe të Gatishmërisë (JMRC) në Hohenfels, Gjermani.

Në këtë stërvitje u zhvilluan takime koordinimi e bashkëpunimi, deklarata për shtyp e negociata me aktorët e ndryshëm në terren si: pushteti lokal, përfaqësues të popullatës, organizatat qeveritare e ato jo qeveritare, UNHCR, USAID, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar etj., me qëllim mbështetjen dhe realizimin e misionit të njësisë në zonën e operacionit.

Stërvitja u zhvillua nën klimën e veprimeve dinamike dhe pati vlera të veçanta në rritjen e aftësive të Detashmentit CIMIC shqiptar për zgjidhjen e detyrave konkrete në mbështetje të misionit, testimin e kapaciteteve operationale të këtij detashmenti në stërvitje multi-



nacionale dhe shkëmbimin e eksperiencave në pikëpamje të bashkëpunimit civilo-ushtarak. “Saber Junction - 23” është një stërvitje vjetore e ushtrisë amerikane me aleatët dhe partnerët e NATO-s, duke përfshirë 5000 pjesëmarrës nga 16 vende

të ndryshme të Aleancës dhe Pfp, që u stërvitën së bashku nga 28 gushti deri më 20 shtator 2023, dhe i shërbeu zhvillimit dhe përmirësimit të ndërveprueshmërisë dhe gatishmërisë të aleatëve dhe partnerëve të NATO-s.

# “Njohuritë e rreme”, më të rrezikshme se injoranca



KOLONEL HYSNI GJERGJI



**Çfarë është  
“dija e rreme”?  
Informacioni i rremë  
është histori e krijuar  
për të mashtruar  
qëllimisht lexuesit,  
për të arritur një  
objektiv botuesi apo  
sponsor i tij.**



Tradicionalisht dijet dhe njohuritë i kemi marrë në shkolla nga botime, tekste, burime, gazetarë dhe media, të cilave u kërkohet vërtetësi dhe kode strikte të një publikimi. Aktualisht shumë njerëz tani nuk i përdorin këto burime për të mësuar të vërtetën, por i marrin “dijet” nga faqet

dhe rrjetet e mediave sociale, ku shpesh është e vështirë të thuash nëse historitë janë të besueshme apo jo. Interneti ka mundësuar një mënyrë krejtësisht të re për të publikuar, ndarë dhe konsumuar njohuri dhe lajme me pak rregulla apo standarde editoriale.

‘Njohuritë e rreme’ i referohen një game të larmishme dezinformatash që mbulojnë tema dhe subjekte të tilla si ushtria, shëndeti, mjedisi dhe ekonomia në të gjitha platformat dhe zhanret. Përmes informacionit të rremë, “propaganda” ka të bëjë me skenarë që krijohen për të mashtruar qëllimisht audiencën, për të promovuar një këndvështrim të njëanshëm, një kauzë ose agjendë të veçantë politike. Çfarë është “dija e rreme”? Informacioni i rremë është histori e krijuar për të mashtruar qëllimisht lexuesit, për të arritur një objektiv botuesi apo sponsori i tij. Shumë gjëra që lexojmë në internet, veçanërisht në burimet e mediave sociale mund të duken të vërteta, shpesh herë jo. Këto histori krijohen ose për të ndikuar në pikëpamjet dhe vendimet e njerëzve, për të nxitur një axhendë politike ose për të shkaktuar konfuzion, madje shpesh mund të jenë një biznes fitimprurës për botuesit.

“Informacioni i rremë” në internet mund t’i mashtrojë njerëzit, duke u dukur si Web-e të besueshme, ose duke përdorur emra dhe adresa të ngjashme për organizata me reputacion të mirë. Sipas Martina Chapman (eksperte



e medias) “dija e rreme” ka tre qëllime që duket të arrijë: Mosbesimi, keqinformimi dhe manipulimi.

Më mirë është të mos e dish diçka, sesa ta mësosh në mënyrë të shtrembëruar dhe të manipuluar qëllimisht. Duke mësuar dhe studiuar në shkolla tekste, revista dhe burime të besueshme dhe të certifikuara, “injanca” për një ose disa çështje zhduket gradualisht. Mbingarkesa e informacionit dhe mungesa e të kuptuarit se si funksionon interneti nga njerëzit, ka kontribuar në rritje të lajmeve të rreme ose mashtrimit. Faqet e mediave sociale luajnë një rol të madh në përhapjen e shpejtë të informacionit në përgjithësi dhe atij të rremë në veçanti. Por, nëse e mëson diçka gabim atëherë pasojat janë zinxhir dhe shpesh të

rënda. Kjo ndodh në politikë, siguri, diplomaci, ekonomi apo shkenca të tjera, ku të pranuarit e një dije të gabuar do të shkaktojë dëme të pariparueshme.

Propaganda, “dija e rreme”, “gënjeshtër” ose “fake news”, janë armët e vjetra të luftërave, që synonin mendjen e luftëtarëve, popullatave, aleatëve dhe kundërshtarëve. Lufta kundër terrorizmit në vitin 2001 u përball me fenomenin e “dijes së rreme” rreth besimit islam dhe pati shumë pasoja. Njohuritë e rreme rreth fenomenit dhe besimit islam, futën në konflikt të përgjakshëm, që vazhdon edhe sot, shoqëri, shtete, individë dhe grupe sociale, të cilat e vuajtën në vite fenomenin e “njohurive të rreme” që në atë kohë quheshin si teoria e “lavazhit të trurit”. Në fakt, nuk ishte lavazh në

kuptimin e heqjes së informacionit nga truri i xhihadistëve dhe ekstremistëve, pasi truri i tyre u mbush qëllimisht me njohuri të rreme radikale, që nuk kishin asnjë lidhje me besimin islam. Pas 20 vjetësh këto metoda po përdoren masivisht në kushtet e reja gjatë luftës në Ukrainë, në një kontekst social dhe realitet teknologjik të ri. Megjithëkëtë qëllimi dhe aktorët mbeten të njëjtë, si përdorim i dijeve dhe trurit të njeriut për arritjen e qëllimeve të caktuara, ushtarake, politike por edhe ekonomike. Ka mendime të ndryshme dhe është sfidë e pazgjidhur, kur bëhet fjalë për identifikimin e llojeve të informacionit të rremë. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për vlerësimin e përmbajtjes në internet, ka lloje të ndryshme lajmesh të rreme ose mashtruese për të cilat duhet të jemi të vetëdijshëm. Media aktualisht nuk konsumohet më në mënyrë pasive, por ajo tashmë krijohet, shpërndahet, pëlqehet, komentohet, sulmohet dhe mbrohet në mënyra të ndryshme nga qindra miliona njerëz. Algoritmet e përdorura nga kompanitë më të fuqishme të teknologjisë, “Google” dhe “Facebook” në veçanti, janë krijuar për t’i personalizuar dhe përshtatur këto shërbime, për profilin e çdo përdoruesi. Kur hyjmë në internet ose identifikohemi në një rrjet social, përgjithësisht na prezantohen lajme, artikuj dhe përmbajtje të bazuara në kërkimet tona të mëparshme në internet. Kjo lloj përmbajtjeje është “blerje e vëmendjes” dhe ka qëllim të kanalizojë dhe pasqyrojë pëlqimet, pikëpamjet dhe besimet tona. Në këtë mënyrë na izolon nga pikëpamjet dhe opinionet e ndryshme, kritike dhe alternative të provuara nga burime të besueshme. “Google” dhe “Facebook” kanë njoftuar masa të reja për të trajtuar lajmet e rreme me prezantimin e mjeteve të raportimit.

Sasia e madhe e informacionit të disponueshëm në internet dhe rritja e lajmeve të rreme, nxjerr në pah nevojën për të menduarit ndryshe apo kritik. Të rinjtë veçanërisht duhet të zhvillojnë të menduarit kritik që në adoleshencë, por ato janë shtresa më e varur në median sociale. Çdokush mund të bjerë pre e informacioneve të rreme në internet. Ka një sërë gjërash për t’u kujdesur kur vlerësojmë përmbajtjen në internet. Shumica e figurave publike dhe mediave shfaqin një “distinktiv blu ose shenjë kontrolli” që do të thotë se publikimi i tyre është i vërtetuar. Kjo mund të nënkuptojë se përmbajtja e postimit ka më shumë gjasa të jetë e besueshme, edhe pse jo gjithmonë. Përtej titujve bombastikë duhet parë dhe kontrolluar burimi i tregimit, a e njohim ne faqen e internetit dhe a kemi histori të mëparshme që kanë rezultuar të vërteta? A është ai një burim i besueshëm? Nëse nuk jemi të njohur me website-t, duhet të shikojmë nëse gjejmë më shumë informacion rreth autorit dhe punëve të tij. Shumë lajme të rreme përdorin tituj sensacional ose tronditës për të tërhequr vëmendjen, me shkronja të mëdha dhe pikëçuditje, si karrem për të tërhequr kureshtarët. Ballafaqimi me ndikimet e “njohurive të rreme” duhet të zhvillohet edhe në nivel shtetëror, me strategji dhe burime

specifike, sepse rinia është veçanërisht e ekspozuar ndaj luftës hibride dhe propagandës.

Duke qenë se lufta në Ukrainë është quajtur si konflikti më i mbuluar mediatikisht, Rusia por edhe perëndimi dhe Ukraina, janë përpjekur të përdorin avantazhet dhe disavantazhet që media digjitale i jep palëve në konflikt. Rrjeti i propagandës ruse me “informacione të rreme” është i zhvilluar mirë në vend, duke përfshirë përfaqësues të institucioneve zyrtare ruse, të diasporës dhe partive politike të paguara. Për ilustrim, askush nuk e dinte identitetin e vërtetë të ‘Babushka Z’, para luftës. “Babushka Z” ose “gjyshja Z” që shihet interesante, e veçantë, e thjeshtë në rrjetet sociale, duke ecur teksa mban në dorë një flamur të kuq sovjetik. Propaganda ruse e vlerësoi këtë grua ukrainase, si një model i popullit të thjeshtë që i vinte keq për rënien e Bashkimit Sovjetik dhe që i konsideronte rusët si çlirimtarë. Valëvitja e flamurit sovjetik nga kjo grua, përkonte me qëllimin e shpallur të luftës dhe si provë për mediat, se veprimet e Rosisë janë mbështetur nga banorët vendas.

Fëmijët janë target-grupi që i nënshtrohen propagandës anti-ukrainase, ku vëmendja më e madhe i kushtohet studimit të gjuhës dhe historisë ruse, nga një këndvështrim që i përshtatet agresorëve rusë. Duke investuar me propagandë të gënjeshtërt tek rinia, Moska synon përfitimin afatgjatë të këtij investimi.

Propaganda dhe lufta me dezinformacionin e Rosisë, nuk është e përqendruar vetëm në Ukrainë dhe SHBA, por në të gjithë kundërshtarët dhe aleatët e saj. Propaganda me informacione të rreme dhe agresioni rus mund të vërtetohen vetëm duke përdorur teknologji dhe prova moderne, si dhe duke përfshirë video dhe raporte krahasuese nga gazetarë të



pavarur. Shembulli më i qartë për përdorimin shtetëror të medias, në manipulim të audiencave është në zgjedhjet amerikane të 2016, si kundërshtari strategjik i Moskës, të cilin do ta trajtojmë në një shkrim tjetër. Gjermania shikohet nga Rusia si një objektiv i rëndësishëm për t'u goditur me informacione të rreme, pikërisht në pikën më të dobët të saj: rolin në luftën e dytë botërore. Siç ishte rasti i Kancelarit Scholz, në kohën kur ndoqi programin e trajnimit për ushtarët ukrainas në tankun kundër-ajror "Gepard" në Putlos (Schlesëig-Holstein). Fotoja e tij në tank krijoi një fushatë shpifjesh dhe lajmesh të rreme nga media ruse. Rusia i shfrytëzoi imazhet, i vendosi pranë njëri-tjetrit, majtas: Adolf Hitler, djathtas: Olaf Scholz. Në rrjetet sociale qarkulloi lajmi: "Scholz u ngjiti në tank për të imituar Hitlerin, idhullin e tij me mustaqe".

Ndikimi përmes propagandës së lajmeve të rreme të Rusisë, është shtrirë edhe në territoret e Moldavisë, Gjeorgjisë, Çeçenisë, Finlandës, Polonisë, vendet baltike dhe Ballkanit. Fqinjët, madje edhe aleatët, por edhe çdo vend tjetër që kundërshton politikën ruse është target i lajmeve të rreme ruse, me qëllim manipulim të gjykimit të publikut në ato vende.

Në shkurt 2023, Rusia megjithëse mohoi se po bënte komplot për të destabilizuar Moldavinë, "bëri akuza", duke përdorur informacione të rreme se Ukraina po planifikonte të kryente një operacion të fshehtë në Transnistri, kundër separatistëve të mbështetur nga Rusia, më 1992. Kjo deklaratë zyrtare u shpërnda "në mënyrë masive nga mediat shtetërore ruse dhe pro-Kremlinit", por edhe nga "burimet pro-Kremlinit në Moldavi", sipas Task Forcës "East Start Com", që është themeluar nga BE-ja. Keqpërdorimi i fotografive apo videove të vjetra, është një taktikë e zakonshme që përdoret nga aktorët dezinformues, për të rritur besueshmërinë e skenarëve të tyre. Katër nga gjashtë kanalet moldave, "First In Moldova", "RTR Moldova", "NTV Moldova" dhe "TV6", rregullisht

kanë ritransmetuar programe nga burime televizive ruse. "First In Moldova", "TV6", dhe "Accent TV" janë të lidhura me oligarkun Shor, i cili është në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, për përpjekjet për të destabilizuar Moldavinë. Lideri i Partisë së Socialistëve të Republikës së Moldavisë (PSRM), Dodon, që ka qenë president i Moldavisë nga vitit 2016 deri më 2020, dyshohet se ka marrë 300 000 dollarë nga Moska, nga tetori i vitit 2021 deri në prill të vitit 2022.

Që nga koha e luftërave ballkanike, Rusia u paraqit si vendi vëlla i Serbisë, përveç pikave të tjera të përbashkëta, si gjuha sllave apo feja ortodokse. Media propagandistike ruse "RT" (ish-"Russia Today") dhe "Sputnik" luajnë rol kyç në përhapjen e asaj narrative për Serbinë, si viktimë e komplotit perëndimor. Ato kanë redaksi të pajisura mirë në Beograd dhe përhapin propagandë ruse çdo ditë, e cila gjen terren në Serbi. Një nga fokuset kryesore të propagandës me "lajme të rreme" ruse është edhe nxitja e tensioneve ndëretnike në Ballkan, duke nënvizuar gjithmonë se "Rusia qëndron pa rezerva në anën e Serbisë në çdo mosmarrëveshje, veçanërisht kur bëhet fjalë për Kosovën". Kur diçka i prek serbët personalisht, ata çuditërisht nuk kërkojnë punë në Rusi, apo nuk shkojnë në Kinë për të studiuar, por në Perëndim. Ndërsa kur bëhet fjalë për politikën zyrtare, njerëzit janë të bindur se Rusia dhe Kina janë të mirat dhe Perëndimi është negativ?! Më shumë se një vit e gjysmë pas fillimit të luftës në Ukrainë, qytetarët e Serbisë "bombardohen me informacione të rreme, se Rusia nuk është fajtorë për fillimin e saj.

Portalet dhe gazetat serbe për luftën në Ukrainë, duken sikur janë shkruar drejtpërdrejt nga Kremli me tituj si: "Filloi rendi i ri botëror, Putini mundi BE-në dhe NATO-n", (Srpski telegraf, 15.11.2016.); "Blickrig - Një uragan rus ka zbritur në Ukrainë: Putin arriti në Kiev brenda një dite", (Alo, 25/02/2022); "Goditja ruse si përgjigje ndaj kërcënimeve të NATO-s", (Veçernje Novosti, 25/02/2022); "Ukraina sulmoi Rusinë!", (Informer, 22.02.2022); "Fashistët po gjuajnë serbët - ndërsa Evropa hesht dhe shikon", (Informer, 16.01.2023); "Lufta e pistë e BE-së kundër Serbisë", (Informer, 7 tetor 2022); "Amerikanët dhe britanikët pranuan: Putini e fitoi luftën!", (Srpski Telegraf, 7.4.2022); "Putin: Rënia e hegjemonisë perëndimore është e pakthyeshme", (Peçat, 7 tetor 2022).

Nga këndvështrimi i Perëndimit, koncepti i bashkëpunimit të pakushtëzuar me të ashtuquajturit "stabilokratë" në Ballkan, në vend të demokracisë, vazhdon prej vitesh. Përveç Vuçiqit në Serbi, të tillë për shembull kanë qenë edhe Milo Gjukanoviq në Mal të Zi, Bakir Izetbegoviq dhe Dragan Çoviq në Bosnje-Hercegovinë ose Nikola Gruevski në Maqedoninë e Veriut. Ata kopjuan llojin e qeverisjes së krijuar nga Putini në Rusi, kontrollin e mediave dhe gjyqësorit, gjithëfuqinë e shërbimeve sekrete dhe policisë, si dhe eliminimin e konkurrentëve politikë edhe përmes gënjeshtërave të fabrikuar dhe shpërndara nga profesionistë.



# Mësime nga Ukraina: “7 kapacitetet kritike për fatin e luftërave të ardhshme”



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

**M**ë 22 shkurt 2022, bota u zgjua e shokuar nga riciklimi i luftës neonazite, e ndërmarrë nga Rusia “Putiniste” për të pushtuar tërësinë territoriale të një vendi sovran (Ukrainës).

Që në krye të herës është nënvizuar, por rreth 19 muaj luftime, konfirmuan se agresioni ushtarak i Rusisë “Putiniste”, nuk ishte vetëm kundër sovranitetit të Ukrainës por edhe: “kërcënim serioz ndaj rendit global të sigurisë si dhe ndaj interesave dhe vlerave transatlantike (USA/UN/NATO/BE/UK)”.

**Paraprakisht**, po ri-sjell “6 Betejat e Humbura” përgjatë 1 vit e 7 muaj luftime të përgjakshme në Ukrainë:

- Kurrsesi nuk e pushtoi Ukrainën por është strukur e rraskapitur në transhetë e Donbaskut, Zaporizhia, Oblast, Klishchiivka, Bakhmut, etj.
- Humbi betejën për ta minuar, ndërsa përkundër e forcoi kohezionin mes vendeve të NATO-s dhe marrëdhëniet transatlantike (USA/BE).
- Humbi edhe për t’i tronditur rendin dhe mekanizmat e sigurisë globale dhe po diskreditohet në KS/OKB. Mbas 19 muajsh, vetëm soji i Kim-Jong-ut dhe 3/4 të ngjashmit e tij pranojnë t’i japin dorën Putinit!
- Nuk arriti të tërheqë Pekinin në një aventurë gjeostrategjike, për të hapur një fronti të ri lufte ndaj Tajvanit.
- Gjithsesi dështoi për të ndezur fitilat e luftës në Ballkan, duke frymëzuar Beogradin Zyrtar: “deri me agresion ushtarak ndaj sovranitetit të Kosovës si dhe prezencës së NATO/KFOR.
- Me gjithë vetë-izolim stalinist, ka humbur betejën për të mbajtur kohezionin dhe krenarinë e kombit rus.

Në përmbledhje: “dështimi në 6 betejat e sipërpërmendura”, shënojnë vetëm fillimin e humbjes turpëruese të luftës si dhe diskreditimit gjeopolitik, që pret Rusinë “Putiniste”.

**Së dyti:** Në vend të parathënies, kam përzgjedhur mesazhin-

epitaf të ish-Presidentit të SHBA-ve, Kennedy, i cili plot 60 vjet më parë (1963) në hapje të Konferencës së parë të Sigurisë së Mynihut (MSC) shprehej: “Ti hedhim sytë përtej rreziqeve të së sotmes, te shpresat e së nesërme”.

Porë kështu, ndërsa fundi i luftës në Ukrainë mbetet çështje kohe, institucionet, Universitetet/Akademitë/Kolegjet Ushtarake, institutet, qendrat studimore, strategjistët/kolegët e fushës së sigurisë dhe të mbrojtjes në Washington, Bruksel dhe 31 kryeqytetet e vendeve të NATO-s, etj., janë duke mirë-peshuar mësimet e nxjerra nga fushëbeteja, jo vetëm për Ukrainën, në mënyrë që përtej kësaj lufte t’i mirë adresojnë ato në transformimin sistemit të sigurisë dhe më posaçërisht në modernizimin e kapaciteteve ushtarake (armatimit, infrastrukturave, personelit dhe rregullave të angazhimit).

Në vijim po paraqes shtatë kapacitetet kritike që do të përcaktojnë fatet e luftërave, ndoshta përtej 50 viteve që vijnë:

**1. Kapacitete të Luftës Hibride:** Rëndësia e strategjisë, taktikave dhe kapaciteteve të mbrojtjes nga kërcënimet hibride qëndron në aftësinë për të shfrytëzuar dobësitë e kundërshtarit dhe për të prishur proceset e tyre vendimmarrëse, duke lejuar përfundimisht një qasje më të shkathët për arritjen e qëllimeve strategjike, në fund të fundit për të mposhtur kundërshtarin dhe demoralizuar aleatët e tij. Sulmet kibernetike marrin përparësi, pasi mund të paralizojnë infrastrukturën kritike, të prishin komunikimet dhe të depërtojnë në sistemet e armikut. Ndërsa fushatat e dezinformimit mbjellin përçarje, manipulojnë opinionin publik dhe gërryejnë besimin tek institucionet, presionet apo sanksionet ekonomike dhe kufizimet tregtare, po ashtu imponojnë vështirësi që minojnë vendosmërinë e kundërshtarit.

**2. Kapacitete të luftës së informacionit,** synojnë mbrojtjen e hapësirës informative dhe përfshijnë një sërë masash proaktive të domosdoshme për të mbrojtur e zhvilluar kapacitet e një vendi të përfshirë në luftë. Lufta e Informacionit mbështetet në tre shtylla kryesore: siguria kibernetike, që përfshin mbrojtjen e të dhënave, të infrastrukturës kritike dhe rrjeteve qeveritare nga hakerat dhe aktorët e tjerë me qëllime armiqësore; masat dhe kapacitetet kundër dezinformimit për të ndaluar përhapjen e informacionit të rremë ose mashtrues; rritja e qëndrueshmërisë publike për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin që ata gjejnë në internet. Pra në thelb, lufta e Informacionit është një qasje proaktive për të mbrojtur sferën tonë dixhitale si dhe besimin të vlerat demokratike.

**3. Kapacitete kundër Avionëve pa Pilotë (dronëve ose UAV-në gjuhën e NATO-s):** Masat kundër UAV-ve janë strategji dhe teknologji moderne dhe kapacitete thelbësore të domosdoshme për luftën kundër dronëve, të cilat përfshijnë

sisteme të avancuara të radarëve, bllokues të frekuencave të radios dhe raketa anti-dronë.

Për më tepër, zhvillimi i kapaciteteve efektive kundër UAV-ve kërkon një qasje gjithëpërfshirëse mbrojtëse dhe sulmuese me teknologji të avancuar, bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërgjegjësime publik.

**5. Kapacitete për Luftën Urbane** përfshin zhvillimin, e strategjive, kapaciteteve dhe aftësi operacionale të përditësuara për sfidat unike të luftimit në mjediset urbane. Ndërsa kështu, mbetet thelbësore që: trupat duhet t'i nënshtrohen një trajnimit gjithëpërfshirës që përfshin luftime nga afër, pastrimin e ndërtesave dhe kontrollin e popullatës. Kjo përfshin përmirësimin e aftësive të qitjes dhe përdorimit të teknologjisë si p.sh syzet e shikimit natën, etj.; lufta urbane kërkon taktika të adaptueshme ndaj forcave armiqësore të fshehura midis civilëve. Armët jo vdekjeprurëse si gaz lotsjellës dhe plumba gome duhet të përdoren me precizion dhe maturi për të ruajtur jetën e kalimtarëve të pafajshëm.

**3. Kapacitete të Mbledhjes së Inteligjencës.** Këto kapacitete përfshijnë investimin në kapacitetet e avancuara të grumbullimit të informacionit në fusha të shumta, duke përfshirë imazhet satelitore, inteligjencën e sinjaleve (SIGINT) dhe inteligjencën me burim të hapur (OSINT).

**4. Kapacitete të Lëvizshmërisë Strategjike:** Mbetet një koncept kritik në strategjitë ushtarake dhe të menaxhimit të krizave, që synon të sigurojë një përgjigje të shpejtë dhe efektive ndaj kërcënimeve dhe emergjencave të paparashikuara. Ajo përfshin investimin në aftësinë për të lëvizur me shpejtësi trupat, pajisjet dhe burimet e mbrojtjes. Nga ana tjetër, këto kapacitete luftimi "imponojnë" zhvillimin e forcave të reagimit të shpejtë, të cilat kanë si mision për t'iu përgjigjur "në kohë reale" krizave. Këto forca mund të vendosen për të menaxhuar situata të ndryshme, nga fatkeqësitë natyrore deri te kërcënimet e integritetit territorial dhe interesave kombëtare. Për të arritur lëvizshmërinë strategjike, bëhen investime në infrastrukturën e transportit, si avionë me dislokim të shpejtë, anije dhe personel të trajnuar mirë.

**5. Kapacitete të Mbrojtjes Civile:** Mbrojtja e civilëve në konfliktet modernë po merr një fokus vendimtar. Kjo është e rëndësishme veçanërisht sot, kur bota bëhet gjithmonë e më e lidhur, dhe media ka një vëmendje të shtuar se çfarë ndodh me njerëzit e zakonshëm në konfliktet e armatosura. Kjo mbrojtje përfshin masa, si krijimi i zonave të sigurta për civilët, ofrimi i ndihmës humanitare dhe ndëshkimi i atyre që dëmtojnë qëllimisht jo-luftëtarët. Ideja është të kufizohen dëmet e shkaktuara nga konfliktet dhe të parandalohet humbjen e jetëve të pafajshme.

**Konkluzione:** Mësimet e nxjerra nga lufta "jo vetëm për Ukrainën" demonstrojnë domosdoshmërinë për zhvillimin e "shtatë kapacitetet thelbësore për fatet e luftërave të ardhshme", krahas atyre konvencionale. Këto kapacitete do të shërbejnë edhe si "shportë kapacitetesh" për t'u përzgjedhur nga NATO. Prandaj këto kapacitete, NATO i merr nga vendet (ose force goals) dhe që të gjitha së bashku përbëjnë fuqinë ushtarake të planëzuar në Konceptin Strategjik të Aleancës, që u miratua në Samitin e Lituaniës, në korrik 2023.

**Së treti,** si edhe në disa dhjetëra vlerësime strategjike, nga



kapaciteti i ekspertit për çështjet e SK, Rajonit dhe NATO-s, do t'i këshilloja faktorët me peshë politike të Tiranës dhe Prishtinës Zyrtare që: "humbja e luftës, kolapsi ekonomik dhe diskreditimi ndërkombëtar që e pret Rusinë "Putiniste" si dhe mësimet e nxjerra nga Lufta "jo vetëm për Ukrainën", mbeten rrethana (por jo dhurata) të favorshme gjeopolitike në dobi të faktorizimit edhe me tej të RSH-së në tavolinat e vendimmarrjeve të mëdha (SHBA/NATO) si dhe për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat mbarëkombëtare në Rajon, Mesdhe, etj.."

Po ashtu do këshilloja aktorët shtetërorë të RSH-së dhe të Kosovës (2 Shtete sovraane të 1 Kombi të vetëm) që, përtej kësaj lufte të konfirmojnë angazhimin afatgjatë dhe vendosmërinë konstante për: "transformimin e sistemit të mbrojtjes mbarëkombëtare; modernizimi e kapaciteteve; përmirësimin e aftësive operacionale dhe kulturës së bashkëpunimit mes strukturave shtetërore, në interes të sigurisë së jetës, pronës dhe mirëqenies së qytetarëve; forcimin e besimit në vlerat euro-atlantike; mbrojtjen e interesave kombëtare si dhe përmeshjen e detyrimeve në NATO!"

Me këtë rast, do doja të përcillja publikisht edhe një mesazh për politikëbërësit: "përkushtimi, përlësia fisnike, sakrificat sublime dhe përgjegjshmëria e spikatur e ushtarakëve, policisë, inteligjencës, mjekëve, infermierëve, personelit të emergjencave civile, etj., meritojnë të trajtohen me dinjitet".



# Kundëradmiral Adnand Agastra: Siguria detare, sfidë e të gjithë kombeve

Intervistë me komandantin e Forcës Detare,  
kundëradmiral Adnand Agastra

## **INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA**

**S**igurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatimi i ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëveprim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare, ishte tema që na çoi tek Forca Detare për t'i marrë një intervistë komandantit të saj, kundëradmiral Adnand Agastra, pikërisht në 65-vjetorin e krijimit të njërës prej njësive më speciale të Flotës Luftarake Detare, siç ishte Njësia e Nëndetëseve.

Kundëradmiral Adnand Agastra, ushtaraku me karrierën më të spikatur në Forcën Detare nën një rrëfim brilant na sjell një përshkrim të kësaj historie, por dhe të transformimit që pësoi ndër vite Forca Luftarake Detare në Forcë Detare, tashmë të modernizuar.

Në postin e Komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, është krenar jo vetëm për historinë e tij personale, të lidhur me këtë forcë, por edhe për atë që është sot Forca Detare brenda Forcave të Armatosura shqiptare dhe në krah të strukturave detare të Aleancës së NATO-s. Ai na tregoi për atë se çfarë është FD dhe se çfarë ajo bën, admiralit na foli për objektivat e së ardhmes, synimet, sfidat dhe ambiciet që ka sot Forca Detare.

Kundëradmiral Adnand Agastra, ka kryer Akademinë Detare, Kursin Bazë të Oficerit, Akademinë ushtarakë “Spiro Moisiu”, në Tiranë. Ai ka kryer “Naval Staff College” (NWC – Newport R.I. USA), “International Senior Officers Staff Course” (Defense Institute/USA), “College of International & Security Studies, Leaders Program” (“George C. Marshall, European Center for Security Studies” - Germany) dhe “Naval Command College” (NWC– Newport R.I. USA).

Ai është aktualisht Komandant i Forcës Detare, dhe vjen pas një numër detyrash të kryera si Shef i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes, Forca Detare, Shef i Qendrës së Programeve dhe Vlerësimit, Shkolla e Trupës AFA, Komandant i Flotiljes së Anijeve, Përfaqësues Kombëtar Ushtarak në SHAPE/ACO, NATO, Zëvendëskomandant i Forcës Detare, Shef Shtabi i Forcës Detare, Oficer Shtabi, Komanda Detare e NATO-s (MARCOM), Shef Shtabi i Flotiljes Detare Jugore, Shef i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes, Distrikti II Detar, Shef Shtabi i Flotiljes Detare, Komandanti i Grupit të Rojës Bregdetare, Specialist i Lundrimit dhe Rojës Bregdetare, Distrikti II Detar, Komandant anije Patrulluese, Zëvendëskomandant ‘Gjuajtësi i Madh Detar’, Shef organi në anije (OL-2/3), Shef Lundrimi në nëndetëse.

Kundëradmiral Agastra, është nderuar me tituj dhe medalje si, “E drejta e lundrimit të anijeve”, Medalja e Shërbimit, Medalja e Karrierës, Medalja e Shërbimit të Shquar, Medalje e NATO-s për Operacionin “Unified Protector” (OUP), Qytetar Nderi i Rhode Island, USA, Medalja e detarit.

**Kundëradmiral, e nisim këtë intervistë me ju pikërisht sot në 65-vjetorin e themelimit të Njesisë së Nëndetëseve, njësi që u transformua gjatë historisë së saj, por që në të njëjtën**

**kohë është edhe një nga strukturat e FD, ku nis dhe fillimi i rrugëtimit tuaj si ushtarak/detar, në detyrën e parë si Shef Lundrimi në nëndetëse. Si e kujtoni atë ditë si një oficer detar i ri i sapo diplomuar?**

Unë e quaj veten, ose më pëlqen ta konsideroj veten si oficeri i fundit operacional që u emërua në Brigadën e Nëndetëseve dhe që kreu lundrimet e fundit në det me nëndetëse, sepse pas kësaj nëndetëset dolën nga formacioni i Flotës Detare. Unë e kam pasur krenari personale dhe kjo ka ardhur nga një arsye shumë e thjeshtë, një lidhje shpirtërore që unë kam pasur me Brigadën e Nëndetëseve të Pashalimanit, pasi unë kam lindur në Orikum, në qytezën pranë Nëndetëseve të Pashalimanit, por dhe sepse babai im ka qenë një efektiv i Flotës Luftarake Detare të asaj kohe dhe si rrjedhim kisha një afekcion të veçantë shpirtëror me Pashalimanin. Atëherë Baza e Pashalimanit ka qenë baza e Brigadës së Nëndetëseve. Kur kam filluar Akademinë e Marinës, që përsëri këtë e kam bërë në mbështetje të vullnetit dhe dëshirës time të veçantë dhe jo aq shumë të dëshirës së prindërve, pasi ata i njihnin vështirësitë e detit, kurse për mua ishte një gjë e bukur. Me thënë të drejtën e kam marrë Akademinë e Marinës me dëshirën time dhe kam bërë kërkesë, ndërkohë, që ka qenë e vetmja kërkesë, që kur të diplomohesha emërimi im të ishte në Brigadën e Nëndetëseve.

Isha rritur me imazhin e bukur që kisha krijuar për të vetmen kërkesë që pas diplomimit në Akademinë e Marinës emërimi im të ishte në Brigadën e Nëndetëseve. Kisha parë punën e prindërve të mi edhe pse ata siç e thashë nuk donin të ishte atje puna ime, sepse e dinin se kush ishte realisht vështirësia dhe kuptohet përkujdesja e prindërve ndaj fëmijës, por kjo ishte ëndrra ime dhe ajo që unë kisha zgjedhur. Por dita e parë e punës time ka qenë pak e veçantë për mua, pasi edhe pse këmbëngulja për të shkuar atje, emërimi im ende nuk kishte dalë, ndërkohë që pothuaj të gjithë shokët e mi që kishin mbaruar me mua kishin marrë tashmë emërimin e tyre, në repartet e Forcës Detare apo në anije. Mua po më vonohej procesi dhe nuk dija ku kishte ngecur, sepse ishin edhe disa rrethana të tjera që më shqetësonin si ato të natyrës, sepse Brigada e Nëndetëseve ishte në mbyllje të aktivitetit të saj mungonte vullneti nga strukturat eprorë të bënin emërimet atje. Por këmbëngulja ime vazhdonte dhe rastësia bëri që komandanti i Brigadës së Nëndetëseve i asaj kohe, të më hasë në rrugët e qytetit dhe pasi ndali makinën më tha, “Çfarë bën ende, emërimi yt ka dalë!”. Nuk prita më, por të nesërmen u nisa menjëherë dhe u paraqita në Porto Palermo. Në fakt u gëzova shumë dhe “u bëra me krahë” si thonë fjalës, por kur shkova në Porto Palermo rrethanat ndryshuan përfytyrimin tim, pasi atje prezantohesh me realitetin.

### **Si ishte?**

Kam një ndjesi që e ruaj ende sot e kësaj dite në memorien time, është momenti kur kam zbritur tek baza. Në të njëjtë kohë ishte dhe ndjesia, emocioni që po provoja, pasi edhe im kishte shërbyer në atë bazë për disa vite. Përshtypja e parë ishte se, përveç nëndetësës që më tërhiqte, asgjë tjetër nuk ishte siç e kisha imagjinuar. Porto Palermo gjeografikisht ndodhet në një gropë që të jep një impresion jo të mirë për një djalë 22 vjeçar që sapo kishte mbaruar shkollën. Por jo se nuk e dija se ku do të shkoja, thjesht ishte prezantimi i parë me realitetin. Ishin ndjenjat që përzihehin brenda meje, emocioni që po hyja pikërisht në nëndetësen ku kishte shërbyer im atë, “ai ka shërbyer këtu, ka jetuar këtu”, dhe

në atë çast i premtova vetes që edhe unë do ta bëj. Atë pamje do ta mbaj me vete përgjithmonë. Nga lart rruga që të çon për në bazë, shpaloseshin dy pamjet, nëndetësja në bankinë dhe baza. E vetmja gjë që më shkonte syri ishte nëndetësja dhe jo baza, se nëndetësja ishte ajo për të cilën unë po shkoja. Më pas gjeta atje kolegët, efektivët, eprorët.

### **Dhe u bëtë ushtaraku me gradën më madhore dhe të nderuar në krye të Forcës që drejtoni. Cila është eksperiencia juaj që nga ai fillim?**

Ka qenë mesi i shtatorit të vitit 1992, kur nisi rrugëtimi im brenda strukturës së Flotës Detare dhe ja ku jemi pas tre dekadash, sërish në mesin e shtatorit të vitit 2023. Gjatë kësaj kohe, Forca Detare ka kaluar të gjithë elementët dhe fazat që kanë kaluar Forcat e Armatosura dhe shoqëria shqiptare, por doja të shtoja këtu ndoshta edhe më shumë se forcat e tjera, në kontekstin e angazhimit dhe zhvillimit që shoqëria shqiptare pati me detin, jo vetëm të historisë së '92-shit të emigrantëve që iknin, por edhe të '97-ës, të asaj ikje të madhe të shqiptarëve nga vendi i tyre. Flota Detare si askush tjetër ka ndjerë, përjetuar dhe është e cenuar shpirtërisht, në gjithë fazat e zhvillimit të shoqërisë shqiptare. Për rastësi të fatit dhe të vetë moshës tonë, unë dhe brezi im kemi qenë pjesë e gjithë këtij zhvillimi. Pra ne kemi filluar detyrën dhe punën si oficerë të FLD-së të një shteti të konsoliduar në kontekstin e zhvillimit të vet, të një shteti monist, dhe kaluam në një zhvillim tjetër shoqëror në demokraci me gjithë elementët e saj, pjesë e së cilës do të ishim edhe ne 22-vjeçarët që po fillonim të merrnim tani detyrimet ligjore mbi vete për shkak të punës. Para fillimit të kësaj karriere nga pikëpamja profesionale, në Flotën Detare u përballëm sigurisht me ekzistencën e atij momenti të trashëgimit të kulturës të modelit të vjetër të punës të FLD-së, të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe rregulloreve, si dhe udhëzimeve të formatuara, nga ish-ushtarakët e FLD. P.sh., unë megjithëse sapo isha diplomuar në Akademinë e Marinës kam kaluar në një provimin tjetër. Ai ishte një provim që nuk e mësoje nga librat, pavarësisht rregulloreve apo manualeve për nëndetëset, ai ishte provimi që ti e mësoje në praktikë. Dhe unë këtë e kam mësuar nga kapteri, nga marinari i thjeshtë e deri tek oficeri, pra ishin 'leksionet' e tyre, sepse ne duhet të kalonim në provimin e marrjes së drejtimit të nëndetësës. Ishte një provim që një oficer marine apo nëndetëseje duhet ta përvetësonte nga tre muaj, 6 muaj e deri në 9 muaj. E nëse ti brenda një viti nuk arrijë të merrje këtë provim, detyrimisht do të largohesh nga nëndetësja. Pa këtë provim të rëndësishëm, ishte shumë e vështirë, në mos e pamundur të ecje përpara. Ato provime kanë qenë më të vështirat, madje edhe më shumë se sa ato në shkollë dhe në akademi. E ndërsa në shkollë ishe brenda një grupi shokësh të së njëjtës moshe, këtu tek nëndetësja tashmë ishe i vendosur midis vartësve dhe eprorit. Ishe ai ushtaraku që marinari, nënoficeri, eprori, kolegu të kishin treguar e mësuar, të kishin bërë praktikë, (herë-herë ndoshta edhe jo të gjitha proceset e njohjes), të kishin orientuar dhe të dilje keq në një provim të tillë, ishte sedër mbi të gjitha. Kur kam dhënë provimin, që tashmë në Forcat Detare jepet në një formë dhe kontekst tjetër për anijet mbiujëse, inxhinieri i nëndetësës, më tha papritur "nga vjen kjo zhurmë?", shkoi pas, hapi një pajollë e goditi me çelës anglez. Pra unë duhet të isha mësuar me gjithçka se si funksiononte një nëndetëse, madje edhe me zhurmat më të lehta.

Të punosh në nëndetëse ishte shumë e rrezikshme sidomos në kohën kur filluam ne, pasi ato ishin pothuaj në degradim të plotë teknik. Kemi pasur edhe raste të rrezikut, për shembull ka qenë rasti kur në nëndetëse pajisja e rregullimit të pastrimit të ajrit nuk funksionoi normalisht. Ajo ishte pajisje automatike, por për një çast kishte mbetur në pozicion manual, duke u tejnxehur dhe kjo do të mund të shkaktojte rënin e zjarrit që është rreziku më i madh në një nëndetëse.

### **Komandant, Forca Detare si pjesë e Forcave tona të Armatosura është aktive që nga viti 1925 e deri më sot, por gjithashtu ajo është një nga forcat e rëndësishme ushtarake që ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e sovranitetit të hapësirës detare të Shqipërisë dhe zbatimin e ushtrimit të ligjshmërisë në det, si e realizon FD këtë detyrë?**

Forca Detare ka kaluar në tre faza gjatë historikut të saj që nga viti 1925, si dhe sot që po flasim. 1925-'45 është periudha e fillimit të ngritjes së një flote detare me qëllime kryesisht të njëjta me misionin që kemi edhe sot, të zbatimit të ligjshmërisë së ligjit fiskal të kohës, por edhe të faktit të elementeve të mbrojtjes si një strukturë, pjesë e rëndësishme e mbrojtjes. Në vitin 1945 flota detare, filloi ringritjen pas LIIB, ku disa ish-oficerë detarë e trajtojnë 15 gushtin si datën e fillimit të FLD, (dhe 21 shtatorin '58 si datën e krijimit të Njesisë së Nëndetëseve). Këta ish-oficerë detarë janë pjesë e historianëve dhe historikut të FD-së, të terminologjisë së flotës moderne shqiptare, kur filloi pajisja e flotës me mjete të kohës. Flota në atë kohë u rivalizua me disa mjete që i mbetën asaj nga LIIB, por mund të themi se fryma dhe ringritja e flotës shqiptare filloi në bashkëpunim me Bashkimin Sovjetik dhe me Kinën, më tej, deri në vitet 1978-'80. Në këtë periudhë kohe flota njohu zhvillimin e saj galopant në sasi dhe cilësi. Mjetet tona detare ishin moderne për kohën në të cilën flasim. Pjesë e kësaj ishin edhe nëndetëset dhe kjo ishte faza e dytë, e cila për nga kohëzgjatja e saj dhe emri që la prapa në kuadër të strukturave mbrojtëse të ushtrisë është akoma e pathyeshme me kohën në të cilën ne po jetojmë.

Faza e tretë është faza që ne po jetojmë, tranzicioni nga FLD në FD që kemi sot, e cila është përmirësuar dhe nga pikëpamja ligjore për shkak të misionit dhe detyrave që ne mund të kryejmë sot, jemi transformuar në një FD kryesisht me interesa dhe kapacitete të Rojës Bregdetare të zbatimit të misionit dhe të ligjit në det. Dhe ka një arsye, për këtë, pasi e gjithë FA-ja dhe sigurisht FD-ja për të cilën po flasim është pjesë integrale e shoqërisë që vetë qeveria dhe shteti shqiptar gëzon në përputhje me interesat tona, që është mbrojtja e vendit, zbatimi i ligjshmërisë dhe angazhimet e tjera dhe këto lidhen edhe me objektivat e Shqipërisë, si me integrimin dje në NATO dhe sot në BE. Këto objektiva shkojnë paralel, jo vetëm me interesat e vendit por edhe në përputhje me kapacitetet ekonomike dhe financiare që kemi pasur, që do të thotë se nga njëra anë kishim të trashëguar një FLD me disa kapacitete, të cilat po shkonin drejt degradimit dhe nga ana tjetër nevojën që RSH të zbatonte detyrimet e saj në përputhje edhe në raport me administrimin dhe kontrollin e saj në det, ku këtu bën pjesë lufta kundër trafikeve të ndryshme dhe përdorimi i gjithë hapësirës detare të RSH. Dhe nga të gjitha analizat e vlerësimit të kapaciteteve që FA dhe institucionet e tjera shtetërore me interesa në det kishin, FD ishte e vetmja strukturë me kapacitete njerëzore



dhe teknike të pjesshme të kohës, e aftë për të marrë në kohë rekord aftësinë për të reagues në det. Në vitin 2002 ne morëm dhe një mision tjetër ligjor, atë të Rojës Bregdetare. Në atë kohë ka pasur debate lidhur me këtë, pasi ishin disa institucione që donin ta merrnin autoritetin e Rojës Bregdetare, por argumenti, vullneti i Forcës Detare e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe MM-së, por edhe në komunikim dhe diskutim me aleatët strategjikë, prevaloi zgjidhja që është sot, që atributet e Rojës Bregdetare t'i atashohen për zbatim Forcës Detare.

## **Z. Agastra, cilat janë strukturat e FD-së që ju keni sot në drejtim? Sa efektive janë ato, ku janë të dislokuara?**

Forca Detare si pjesë e FA-së ka kaluar disa faza transformimi, por ne ende vijojmë të rristrukturohem, të përmirësohem, ne shohim mundësitë e kapaciteteve që të përdoren në mënyrë sa më operacionale dhe optimale, sepse flota në tërësinë e vet është teknologji, është kosto, është përgatitje. Ne duhet të jemi të aftë që këtë lloj shpenzimi të shtetit ta optimizojmë në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne kemi kaluar në disa faza rristurimi nga pikëpamja gjeografike nga disa baza të komunizmit që trashëguam, tani jemi fokusuar në dy baza siç është Pashalimani dhe Durrësi dhe kemi prezencë të Forcave Detare nga Saranda deri në Shëngjin. Por ndërkohë ne jemi transformuar në ndryshimin e strukturës brenda FD-së për të qenë më ekonomikë dhe më racionalë. Kemi ndryshuar elementë të Forcës Detare dhe sot përbëhet nga ajo që është reparti dhe struktura më kryesore siç është Flotilja Detare, distrikti detar i dikurshëm, e cila ka kapacitete detare të sigurimit të misionit të Forcës Detare. Flota luftarake është ezauruar tashmë në term dhe këtë rol e luan Flotilja, e cila në tërësinë e vet ka të gjitha asetet detare për të bërë këto dy misione, misionin e mbrojtjes të hapësirës detare të RSH-së dhe zbatimit të ligjshmërisë në det. Sot që unë jam komandanti i Forcës Detare, krahu im operacional është Flotilja e Pashalimanit. Ky repart, kjo strukturë mbështetet nga Qendra Kombëtare e Zhytjes që është një repart i palombarëve e i specialistëve zhytës, unik në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Sot mund të dëgjoni

për zhytës, por jo në pikëpamjen e zhytësve të FD-së. Në të gjithë hapësirën shqiptare, trajnimi dhe certifikimi i zhytësve siç janë edhe zhytësit e policisë, forcave speciale të FA-së dhe zhytësit e FSK-së së Kosovës trajnohen dhe certifikohen nga zhytësit e Qendrës së Zhytjeve të FD-së. Tjetër strukturë e rëndësishme është edhe Qendra e Vëzhgimit Detar, që siç jeni në dijeni është qendra e cila monitoron dhe kontrollon të gjithë sistemin e radarëve të bregdetit të RSH, me qëllim që ne të dimë se kush e përdor hapësirën tonë detare. Ky është sistem modern, të cilin ne e mirëmbajmë e përditësojmë me qëllim që ai të ruajë aftësitë e veta identifikuese për të ruajtur dhe monitoruar të gjithë hapësirën tonë detare. Përveç kësaj kemi edhe Qendrën e Shërbimit Hidrografik që po merr një rol të rëndësishëm. Këtë vit që jemi, ne kemi arritur disa objektiva madhorë në shërbimin hidrografik. Shqipëria u bë pjesë integrale e Organizatës Ndërkombëtare të Hidrografisë (IHO-International Hydrographic Organization), pjesë e IMO-s (Organizata Ndërkombëtare e Detarisë - International Maritime Organization), ku zëri ynë tashmë është i barabartë me të gjithë. Po ashtu Forca detare është anëtarësuar këtë vit edhe në IALA (International Association of Lights and Aid to Navigation - Shoqata Ndërkombëtare e Sinjalistikës dhe Ndhmës Hidrolundrimore) që është pjesë e sigurisë detare, për sigurinë e farofenerëve. Të dy këto organizata janë përgjegjëse për sigurinë hidro-lundrimore në bregdetin shqiptar dhe në të gjithë botën.

Shumë herë dëgjoher në media për skafe të ndryshëm që kanë rënë në cekëtinë etj., kjo ndodh për shkak të paftësisë dhe gabimeve drejtuesve të tyre. Shërbimi hidrografik është përgjegjës për të dëshmuar, për të prodhuar harta, për të mbajtur shërbimin e njoftimit dhe sinjalistikës detare në të gjithë bregdetin shqiptar në gatishmëri, me qëllim që të gjitha mjetet e lundrimit të mos bëjnë gabime, gjë që shpesh neglizhohet prej tyre. Siç po shihet, përdorimi i hapësirës detare shqiptare po dy a trefishohet me ritme galopante. I njëjti ritëm po funksionon në turizëm. Është i njëjti ritëm që na jep ne angazhim në hapësirën

detare. Dhe, nëse një nga këto hallka të hapësirës detare nuk do të funksiononte, impakti do të ishte i drejtpërdrejtë në turizëm dhe relativisht me financat e shtetit. Prandaj ne shpesh përpiqemi që ta trajtojmë veten si një krah kontributor, jo konsumator në të ardhurat në financat e shtetit.

### **Admiral, si janë sot aftësitë operacionale të Forcës Detare, po gatishmëria luftarake si është? A ka FD-ja kapacitetet e nevojshme për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve?**

Kjo është një pyetje në fakt që edhe nëse ju nuk do ta kishit bërë, është e nevojshme unë të shtjelloja diçka për publikun, për të treguar se çfarë jemi dhe se çfarë bëjmë. Sepse taksapaguesi shqiptar është ai, të cilit në fund të fundit ne i përgjigjemi. Siç ua shpjegova, historiku i Flotës Detare kaloi nga një FLD e mirëfilltë për të mbrojtur hapësirën e RSH, në një flotë kryesisht ligj zbatuese, për të siguruar, pra jo për të mbrojtur, në mënyrë të mirëfilltë hapësirën e RSH. Vendi ynë tashmë është anëtar i NATO-s që në vitin 2009 dhe rrjedhimisht shumë elementë të sigurisë dhe mbrojtjes tashmë nuk shihen individualisht por shihen në konsideratat e Aleancës. Dua të them që është domosdoshmëri për RSH por edhe për ne si FD të jemi iniciatorët dhe gjeneratorët e nevojave të kapaciteteve. Me krenari ju bëj me dije që ka ardhur momenti, sepse FD është e kthjellët në objektivat e saj, por që dhe këto nuk i bën dot vetë, nëse nuk do të gjente një bashkëpunim me SHP dhe me MM, si me shefin e Shtabit të Përgjithshëm ashtu dhe me Ministrin aktual; kjo jo për shkak të intervistës por për shkak të mirëkuptimit që kemi gjetur me të në komunikimet tona të nivelit strategjik për rritje të kapaciteteve të vendit. Dua ta them me krenari që planet e përhershme të FD, që kanë qenë që në vitin 2010 e deri sot, nuk do të shtyhen më, por them se ne po shkojmë drejt konkretizimit të kapaciteteve të FD-së, dhe jemi në rrugë të mbarë. Shumë shpejt, në një konsideratë afatshkurtër, do të njoftojmë që në FD po ngrihen kapacitete të mirëfillta luftarake. Nuk është e lehtë për t'u bërë, por nga ana tjetër kjo tashmë nuk është vetëm një dëshirë, por është një nevojë e kohës.

Ne jemi të aftë të përcaktojmë prioritetet, me qëllim që ato t'i zhvillojmë për të mbërritur tek objektivi. Qëllimi dhe misioni im nga pikëpamja e zbatimit financiar është kryerja e detyrave të flotës, e cila është një strukturë teknike duke konsideruar anijet, radarët dhe ku duhet një personel i aftë për t'u përballur me teknologjinë dhe ku ne kemi nevojë të motivojmë më shumë personelin. Është momenti të them se këto dy vite në këtë drejtim kemi pësuar një ndryshim galopant dhe kemi pasur frymë mirëkuptuese nga qeveria për të mbështetur FA-të si me pagat por dhe me paketën ndihmëse për ushtarakët dhe ndryshimin e disa ligjeve që ndryshojnë jetën e ushtarakut.

### **Cilat janë sfidat e FD-së?**

Sfidat janë të shumëllojshme. Nëse do ta nisim me nevojën për të zbatuar misionin, siguria detare është sfidë e të gjithë kombeve. Në kontekstin tonë si Forcë Detare dhe Roje Bregdetare, sfidat e sigurisë së hapësirës detare janë monitorimi i vazhdueshëm i hapësirës detare, lufta ndaj trafikeve të paligjshme, zbatimi i ligjeve për peshkimin, turizmin dhe kontrabandën. Përveç tyre një sfidë e veçantë është edhe ruajtja dhe monitorimi i TAP-it dhe linja e kabllave nënujore, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me mirëqenien e vendit tonë. Për të siguruar kontrollin, monitorimin dhe sigurinë detare, pra për të kryer misionin tonë, është e

nevojshme jo vetëm mbajtja e kapaciteteve operacionale por edhe rritja dhe modernizimi i këtyre kapaciteteve. Është e rëndësishme të kesh kapacitete të gatshme dhe bashkëkohor në kohën, vendin dhe sasinë e duhur. Gjithçka që bëjmë është në funksion të këtyre elementeve. Një sfidë tjetër është edhe kontributi me kapacitete në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO. Pjesëmarrja në to është një sfidë, pasi nuk është e lehtë të mbash operacionale një kapacitet larg vendit tënd, por me profesionalizmin e efektivave tanë deri tani ia kemi dalë. Ne aktualisht jemi në një mision në detin Egje. Gjithashtu kemi marrë pjesë në Operacionin e NATO-s FOCOPS në kuadër të gjithë sanksioneve që komiteti ndërkombëtar ka vendosur sot ndaj Rusisë. Sot Forca jonë Detare po projekton siguri, pra ne jemi duke u thënë aleatëve të NATO-s dhe BE-së se Shqipëria është projektues i sigurisë me ato kapacitete operacionale që ne kemi sot. Një sfidë tjetër e veçantë është trajtimi i efektivit, që do të thotë se kudo se "efekti moral" është kryesori. Njeriu përpara se të kryejë detyrën dhe misionin si në kohë paqeje ashtu dhe lufte, duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe i përgatitur moralisht, sepse sfidat kërkojnë deri edhe në sakrificën sublime. Lidhur me këtë për momentin ka zhvillime pozitive nga qeveria që shpresojmë të jenë edhe në të ardhmen.

### **Si sigurohet dhe mbrohet hapësira detare territoriale dhe bregdeti shqiptar? Sa të kërcënuara janë ato?**

Duke qenë se deti është një hapësirë që lidh të gjitha vendet dhe një hapësirë e lirë për lundrim, nuk mund të thuhet asnjëherë që kërcënimi është larg. Kryesisht në bregdetin tonë kërcënimet janë në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë. Duke qenë se këto janë pjesë e historikut të zhvillimit detar, në varësi të kërcënimeve kryesore vendet zhvillojnë si forca të sigurisë ashtu dhe forca të mbrojtjes luftarake. Aktualisht ne me kapacitetet operacionale që kemi, mundohemi të monitorojmë dhe kontrollojmë sa më mirë hapësirën tonë detare nëpërmjet sistemit të vëzhgimit detar me radarë, por sidomos me prezencën e shtuar dhe të vazhdueshme të anijeve tona në det. Ajo që shohim sot është se ato që kanë qenë në mënyrë të mirëfilltë flota luftarake detare me misione të qarta dhe të pastra lufte sot po arrijnë dhe po zhvillojnë detyra ligjshmërie. Pra nevoja për të kontrolluar hapësirën detare ka qenë, është dhe do të mbetet, se nga kjo hapësirë detare varet prosperiteti i vendeve.

Anijet në vetvete e fillojnë zbatimin e detyrës që në momentin kur ato dalin nga baza dhe valëvitin flamurin e tyre. Që në këtë moment anija po kryen detyrën. Është ajo që ne themi prezencë. Prandaj ne kemi shtuar këto dy vitet e fundit numrin dhe orët e patrullimit në det dhe vëmë re dhe konstatojmë me kënaqësi që numri i akteve në kundërshtim me ligjin është pakësuar. Vëmë re me kënaqësi që anije të dyshimta, të cilat janë edhe të sanksionuara nga BE dhe OKB, i largohen hapësirës tonë dhe nuk janë më të shpeshta. Kjo vjen si rezultat i kapaciteteve që ne kemi në gatishmëri operacionale, ndërsa kur kalojmë tek elementët e mbrojtjes jemi pjesë e strukturave të FA-së dhe pjesë e aleatëve tanë në NATO dhe i aplikimit në BE.

### **Komandant, si sigurohet monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe në vijën bregdetare të Shqipërisë, në hapësirën detare dhe liqenore të vendit?**

Të gjitha strukturat që janë pjesë e FD-së, që unë përmenda më sipër, janë kapacitete të cilat ne i përdorim për njohjen e

hapësirës detare, nuk mund të bëhet vetëm nga Flota. Janë edhe institucionet e tjera me të cilat ne jemi në bashkëpunim të përhershëm. Ne kemi një qendër koordinuese që është QNOD, ku të gjitha institucionet me interesa në det japin informacione dhe aty mbledhet informacioni i përgjithshëm për gjithë hapësirën detare të Shqipërisë. Të dhënat që mbledhin kapitaneritë e porteve me komunikimet për trafikun detar, hyrje-dalje në porte shqiptare, qëndrimet në rada, fluksi i anijeve turistike apo të peshkimit, të Policisë Kufitare dhe Doganave, ushqejnë me të dhëna sistemet në QNOD dhe sigurojnë këtë bashkëpunim ndërmjet institucioneve tona. Sot, edhe pse është e vështirë për të thënë se kontrollohet e gjithë hapësira detare, ne jemi në kushte që themi se e kontrollojmë dhe e monitorojmë në mënyrën më operacionale të mundshme hapësirën detare të RSH.

**Sa siguri teknike kanë mjetet e lundrimit? Si mirëmbahen ato, ku i riparoni për t'i pasur në gjendje gatishmërie, ku janë të vendosura pajisjet e lundrimit?**

Mjetet tona të lundrimit janë të sigurta për shkak të aftësive dhe profesionalizmit që kanë efektivat që i përdorin ato. Unë jam shumë konfident me përgatitjen e njerëzve. Dua të bëj një parantezë të shkurtër. Në vitin 2016 filluam misionin për herë të parë, në 2018 u njoftuam nga Komanda Detare e NATO-s në Londër se në takimin me komandantët e flotave, një takim i përvitshëm, ata kërkonin nga FD-ja shqiptare një prezantim, një shpjegim se si është e mundur që një vend i vogël si Shqipëria, arriti të zbatonte pjesëmarrjen në operacionin në Detin Egje pa shqetësim, larg kapaciteteve të vendit, që janë njësi mbështetëse. Është një sfidë për NATO-n dhe për të gjitha vendet, aftësia e strukturës për të mbajtur në mënyrë operacionale një mjet detar në operacion larg vendit të tyre, sepse ato kanë nevojë për kapacitetet riparuese dhe logjistike të mbështetjes, dhe ata kërkonin të dinin nga unë si drejtues, se si ne, një vend kaq i vogël si Shqipëria me një anije 40 m, prej dy vjetësh në operacion nuk po nxirrte asnjë shqetësim. Dhe përgjigja ishte tepër e thjeshtë, njerëzit e duan atë gjë që kanë dhe po e bëjnë me përkushtim. Pra njerëzit tanë e duan punën e tyre.

**Ju folët për përkushtimin e efektivëve tuaj, po ku shkollohet sot personeli i Forcës Detare dhe ku trajnohet ai?**

Këto janë sfida të FA-së. Këto vitet e fundit ka një zhvillim pozitiv në këtë drejtim. Ne jemi kthyer tek AFA-ja. Ne si strukturë speciale jemi me deficiencën dhe nevojën për arsimim, arsyeja është se ne jemi forcë e vogël dhe si e tillë nuk e kemi shumë nevojën për rotacione. Për këtë arsye Akademia Detare sot, jashtë dëshirës dhe shpirtit tim, është e mbyllur, dhe personalisht kjo më dhemb dhe na bën vërtet jo vetëm të keqardhur por edhe të nevojshëm për të plotësuar kërkesën për ushtarakë detarë. Ne sot i përgatisim oficerët tanë sipas ligjit në dy forma, brenda sistemit të arsimit në FA, por edhe me personel nga dy universitete navigacionale në Vlorë dhe në Durrës, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh me vende të tjera të NATO-s, si SHBA, Turqi, Itali, Gjermani, Greqi, Angli etj. Pra në këtë formë ne plotësojmë nevojën për personel, pra boshllëkun që është krijuar për të siguruar burimet njerëzore.

**Admiral, shpesh në situatat e emergjencave në vend kemi parë operacione të zhytjes nën ujë. Çfarë niveli kanë zhytësit tuaj, ku i siguron ju ata? Ku certifikohen dhe sa të pajisur janë zhytësit ushtarakë për të mbështetur operacionet FARSH?**

Më pëlqen ta them që Qendra e Zhytjes është një strukturë elitare e FD-së, ajo ka qenë një strukturë tepër e përgatitur dhe profesionale, por edhe kjo strukturë ka pësuar ristrukturime si gjithë strukturat e tjera të FD-së, por edhe pas kësaj ajo vijon të jetë forca më profesioniste e zhytjeve në RSH, në ato kapacitete që kemi. Ne kemi humbur sot një kapacitet që është palombari i rëndë dhe është në pikëpamje të kapaciteteve dhe të planeve tona oportune. Por sot për sot ne po mendojmë që kemi shumë profesionistë zhytës, të cilët kanë kryer të gjitha detyrat në hapësirën detare dhe liqenore, jo vetëm nga pikëpamja operacionale e forcave tona por edhe të forcave policore, në shërbim të popullatës, me shumë përkushtim dhe profesionalizëm në operacionet tona në lumenj, liqene, dete e rezervuarë. Por ne kërkojmë më shumë, ne nuk kufizohemi dhe ajo qendër zhytjeje do të ketë të gjitha kapacitetet e duhura me anije palombare për të kryer punime nënujore apo çminime me pajisje të ndryshme. Diçka tjetër për t'u theksuar është se ne do t'i japim një kapacitet të ri shumë shpejt qendrës së zhytjes. Në bashkëpunim me disa shtete të tjera të vendeve aleate siç është Belgjika, në pikëpamje të orientimit të një pjese të qenësishme siç është palombari, ne do të krijojmë një kapacitet të luftës kundra minave detare. Këtë e bëjmë për dy arsye. Në konsideratë të përgjithshme në hapësirën detare në të gjithë botën gjenden akoma mina të mbetura, p.sh. në detin e Veriut vitin e kaluar shpeshherë gjendeshin mina të vjetra. Edhe ne kemi të tilla në bregdetin tonë, ku shpesh peshkatarët kanë nxjerrë mina të vjetra, që do të thotë se asnjëherë nuk mbaron puna së kontrolluari bregdetin nga mbetjet e municioneve apo minave detare. Këto kapacitete apo pajisje do të na japin ne më shumë mundësi për kontrollin dhe monitorimin e hapësirës nënujore dhe për më tepër unë e shikoj edhe si një kontribut që RSH mund të japë në NATO. Sot vendet krijojnë disa kapacitete speciale në NATO dhe atje ti fokusohesh në një diçka që mund ta bësh dhe iu thua aleatëve që këtë do ta bëj unë ose dhe dy tre vende bashkë, brenda një grupi më të madh të zhvillojmë një kapacitet special që ky të jetë i disponueshëm brenda nesh por edhe që është një kontribut madhor brenda aleancës. Dhe ne e kemi kapur këtë p.sh. siç kemi anijen tonë në detin Egje.

**Komandant, si është bashkëpunimi i FD-së me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura?**

Ndërkohë që ju shtroni pyetjen tuaj, dua t'ju them se para se unë të vija këtu, isha në një konferencë, ku ne po hedhim bazat përfundimtare të një stërvitjeje. Në këtë stërvitje, që është e FD-së, ne po shikojmë mundësitë që të ftojme për pjesëmarrje kapacitete nga FT dhe FAj. Disa detyra të Forcës Detare janë domosdoshmërisht të lidhur me të dy forcat që përmenda. Si shembull në një operacion kërkim-shpëtimi ose në një mision zbatimi ligjshmërie në shumë raste bashkëveprimi me FAj është i domosdoshëm dhe vendimtar për suksesin e operacionit, gjithashtu në rastet e një bordimi, ku shkalla për të inspektuar këtë anije është e kategorisë të përdorimit të forcës ekstreme, nëse nuk bashkëveprojmë me Forcat Speciale të FT-së nuk mund të kryejmë operacionin. Tashmë kemi dy stërvitje vjetore që organizon Forca Detare me pjesëmarrjen e Forcës Tokësore dhe Forcës Ajrore.

**Po me institucionet shtetërore që janë me interesa në hapësirën detare si bashkëveproni, si ushtroni ligjshmërinë në det?**

Përgjigjen e pyetjes tuaj dua ta shoh në një aspekt tjetër. Bashkëpunimi i FD-së me institucionet e tjera është një histori suksesi. Bashkëpunimi me ta si në komandën time, por edhe më përpara, në kohët e sotme është një sfidë edhe në vendet më demokratike. Kushdo dëshiron të ketë pushtetin e informacionit, dhe nuk është i lehtë komunikimi institucional pavarësisht aspektit ligjor. Sigurisht komunikimi i rrjedhshëm, i shpejtë në kohë ka të bëjë edhe me personalitetin e drejtuesve. Jam krenar të them që si me policinë kufitare, që është aktori ynë kryesor bashkëpunues, si me autoritetin portual, si me Ministrinë e Bujqësisë për peshkimin, unë kam një marrëdhënie të respektueshme dhe tepër korrekte institucionale por dhe të ndërlidhur. Sot po shohim që në të gjitha rastet kushdo nga këto institucione, ku ne kemi kërkuar ndihmë kemi gjetur zgjidhjen. Konkretisht ne e kemi rritur gamën e bashkëpunimit, p.sh. sot që po flasim ne po zhvillojmë një sesion trajnimi për policinë kufitare dhe ku po trajnohen nga Forcat Detare, pra oficerët e mi sot po trajnojnë policinë e shtetit dhe po i trajnojmë nën ombrellën e BE-së, pra kjo nevojë trajnimi është identifikuar dhe kërkuar nga BE-ja me financimin e tyre, pra ka një bashkëpunim dhe një aftësi nga ana jonë dhe në vend që ata të sillnin trajnuesit e tyre, nga vendet e tjera ne thamë se kemi oficerët tanë. Dhe kjo na bën krenarë të themi se edhe qeveria jonë edhe BE merr informacionin se ekziston një forcë e aftë që rrit imazhin dhe shton kontributet.

**Admiral, përveç operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA-së, siç ju e përshkruat më sipër, sot ju jeni pjesëmarrës në stërvitjet e përbashkëta detare me flotat e vendeve të ndryshme të botës. Si janë mjetet tona në këto stërvitje?**

Forca Detare jep kontributin e saj me ato kapacitete që disponon dhe në ato detyra specifike që i ngarkohen në stërvitje të ndryshme të NATO-s dhe aleatëve tanë, brenda dhe jashtë Shqipërisë sa herë që i jepet mundësia. Në këto stërvitje ne mbështetemi në kapacitetet operacionale që ne kemi por ajo që është më e rëndësishmja në kapacitetin njerëzor. Sot dhe programet tona stërvitore që zhvillohen në anije janë të unifikuara me programet stërvitore të NATO-s dhe procedurave standarde (STANAG-ëve) që janë përvetësuar plotësisht nga efektivi ynë detar. Pra ne kemi përvetësuar dhe e zbatojmë plotësisht standardet e NATO-s dhe angazhohemi me kapacitetet operacionale që disponojmë në këto stërvitje. Si rrjedhojë mund të themi që me profesionalizmin tonë edhe me kapacitetet operacionale aktuale mund të jemi pjesë integrale e një Task Grupi Detar në të cilën kryejmë detyra të caktuara nga Aleanca. Ky profesionalizëm është rrjedhojë e trajnimit dhe pjesëmarrjeve në stërvitje të herëpashershme me Grupet e Gatshme të Anijeve të NATO-s, pjesëmarrjes në stërvitjet e drejtuara nga NATO apo me anijet e FD të vendeve aleate. Një stërvitje e rëndësishme është edhe stërvitja rajonale "ADRION" midis FD-ve të vendeve të rajonit. Kjo stërvitje zhvillohet çdo vit në një vend të ndryshëm nga vendet që lagen nga Detet Adriatik dhe Jon. Në Shqipëri është zhvilluar tre herë dhe po së shpejti vjen radha përsëri që ta drejtojmë këtë stërvitje. Drejtimi i saj nënkupton të gjitha aspektet që nga konceptimi, planëzimi dhe drejtimi i saj. Gjithashtu rëndësi të madhe u kushtojmë edhe stërvitjeve dypalëshe si ajo së fundmi me Greqinë, që u planëzua dhe u drejtua nga ne, por dhe pjesëmarrjeve në stërvitje dypalëshe

me vendet aleate si Italia, Franca, Turqia, Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar apo edhe Spanja, sa herë që anijet e tyre ndodhen në afërsi të ujërave tona. Ne jemi në komunikim në kohë reale me aleatët, dhe ja, sapo po më njoftojnë se sot anija jonë, marinarët tanë, sapo kanë shpëtuar në detin Egje 16 emigrantë.

**Si ka qenë ky bashkëpunim gjatë stërvitjeve dhe operacioneve ushtarake jo vetëm me pajisjet e nevojshme por edhe në komunikim apo në bashkëveprimin e mëtejshëm midis palëve?**

Ne jemi në pararendje të FT-së dhe FAj. Si shembull mund të themi se jemi në fillim të zhvillimit të një plani me Malin e Zi, plan bashkëpunimi për të rritur kapacitetet profesionale të Flotës Detare malazeze. Ka një angazhim të të dy FA-ve, por ajo që ne po bëjmë tani është që FD ka fituar një pozicion besueshmërie tek homologët tanë. Ky është një pozicion krenarie. Ata po bëjnë një plan organizimi, po prokurojnë anije të ngjashme me tonat në kapacitete dhe kanë parë aritjet tona të kontributit në Detin Egje, pasi ne jemi për herë të dytë në Mesdhe si dhe pjesëmarrës në operacionin tjetër të NATO-s, atë FCOCPs, dhe si duket Forca Detare e Malit të Zi kërkon të jetë kontributore në NATO ashtu si ne dhe të bëhet edhe ajo pjesë e këtyre angazhimeve. Anijen e kanë në dorë ta prokurojnë, por duhet përgatitur dhe stafi, pra ata, duke qenë pragmatistë, shohin përgatitjen e oficerëve tanë, të cilët ne i kemi trajnuar duke parë vendet e mëdha, pasi nuk kemi pasur një shembull në aftësitë e kapaciteteve të vendit tonë që t'i ngjasonim. Ne jemi përpjekur të aplikojmë përvojën e tyre në strukturat tona në kapacitete më të vogla dhe struktura më të kufizuara. Mali i Zi në këtë rast, duke qenë pragmatist nga pikëpamja financiare merr shembullin tonë, pasi kemi ngjashmëri strukturore kapacitetesh dhe ata kanë kërkuar në komunikim me komandën tonë që ne t'i ndihmojmë. Madje ata do të dërgojnë edhe oficerët e tyre të trajnohen nga ne. Në nëntor hapet dritarja e bashkëpunimit që është miratuar edhe nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nga ministri i Mbrojtjes.

**Admiral, kur mund të themi se ka qenë periudha që shënon fillimin e stadi të ri të zhvillimit, por tashmë të FD-së, gjatë historisë të saj por dhe të pajisjeve të saj?**

Fati e solli që unë dhe brezi im të punonin në dy sisteme dhe për shkak të kësaj historie të ndryshimit të të gjitha fazave të FD-së, me të mirat dhe të këqijat e saj, në të njëjtën kohë na la një pasuri të madhe, duke na bërë dëshmitar të të gjithë atyre transformimeve që kaloi FD-ja. Ishte një kohë e lavdishme, në respekt të jashtëzakonshëm të FLD, por mund të them se e kemi zgjatur shumë kohën e tranzitit të kapaciteteve luftarake, sepse mbi të gjitha, kapaciteti njeri, human, i kushton shtetit më shumë në përgatitjen e tyre se sa është thjesht teknologjia. Unë e kam parë fillimin e modernizimit të Forcës Detare që në vitin 1999, kur ne filluam të merrnim anijet e dhuruara nga SHBA-ja e pastaj nga Italia në mënyrë masive me sasinë e mjeteve që ata na dhuruan, mjete të cilat na ndihmuan në zbatimin e ligjshmërisë në det. Dhe kulmin në këtë periudhë 30 vjeçare post komuniste të kapaciteteve të Forcës Detare ne e arritëm në vitet 2009-2014, kur u modernizuam me 4 anije që janë krenaria jonë, këto që dalin në detin Egje, si dhe ringritja e kontrollit të vëzhgimit të hapësirës detare, që është sistemi i radarëve. Këto dy kapacitete kishin hopin cilësor dhe sasior në konsideratë të modernizimit të

forcës detare. Tashmë në planin e modernizimit që kemi, kemi përmirësimin e kapaciteteve të qendrës të zhytjes dhe ringritjen e kapaciteteve mbrojtëse luftarake të FD-së, që janë anijet, radarët dhe mjetet pa pilot siç janë dronët nënujorë për luftën kundra minave detare. Dhe objektivi ynë tjetër është anija luftarake që shpresojmë ta kemi. Shpresoj të kemi aftësi argumentuese të FD-së, për të bindur strukturat eprorë e sidomos qeverinë për të argumentuar nga pikëpamja operacionale e financiare.

**Le të kthehemi edhe njëherë atje ku e nisëm intervistën me ju, tek një nga njësitë më speciale e më të rëndësishme të FLD-së shqiptare, siç ishte Njësia e Nëndetësive. Pra Admiral, po ju rendis disa pyetje në këtë jubile të 65-vjetorit të krijimit të kësaj njësie, me qëllim për të mos e ndërprerë fjalën tuaj.**

**Kur u krijua kjo njësi dhe mbi çfarë baze? Çfarë rëndësie kishin ato në fushën ushtarake, por dhe në kontekstin kohor? Ku lundruan nëndetëset e FLD-së shqiptare? Kur erdhën nëndetëset e para në Shqipëri dhe nga erdhën ato? Sa nëndetëse kishte Shqipëria? Ku u shkolluan dhe u trajnuan marinarët shqiptarë? Po ata për drejtimin e nëndetësive, pasi ishin mjeteve luftarake të pazakonta, për kohën dhe jo vetëm? Si kryhej zhytja dhe manovrimi i nëndetësive? A kanë kryer ato dhe ekuipazhet e tyre operacione lundrimi të gjata e të vështira? Sa ishte vështirësia që haste ekuipazhi i tyre edhe për shkak të ndërtimit apo kushteve që paraqisnin ato?**

Nëndetëset erdhën në Shqipëri në vitin 1958, si pjesë e një pakete ndihme të Bashkimit Sovjetik, kuptohet në kuadër të marrëdhënieve në lulëzim, pjesëtarë të Traktatit të Varshavës, si dhe nga nevoja operacionale e Bashkimit Sovjetik për të pasur këtë vend, që ishim vendi më perëndimor detar në detin Mesdhe. Ne ishim vendi që mund të përdorëshim mu në zemër të Mesdheut. Këto kapacitete që morëm ishin një dëshmi force. Ato nuk vinin thjesht vetëm për popullin shqiptar, por dhe si nevojë e BS dhe traktatit të Varshavës të kontrollonte për të pasur hegjemoni në Mesdhe. Ato fillimisht, sipas planit, ishin 14 nëndetëse, por në Pashaliman kanë ardhur 12 nëndetëse dhe kishin një projekt bashkëpunimi midis dy shteteve që kishte të bënte edhe me përgatitjen e efektivave tanë nga efektivat rusë. Efektivat tanë u përgatitën në shkollat ruse, dhe jo vetëm të nëndetësive por dhe të anijeve mbiujëse, dhe patëm në Baku, në shkollën e nëndetësive, një kontingjent të shkëlqyer me medalje ari, të inxhinierëve dhe oficerëve që mbaruan shkollimin atje. Në bazë të projekteve dhe planeve që kishin ata do të kalonin në nëndetëse që ishin si kapacitet i FLD-së. Ndërkohë që në fillim të viteve 60 vetëm 4 nëndetëse ishin marrë në dorëzim, por prishja me BS solli pasojat edhe tek zbatimi i marrëveshjes. Një panoramë artistike është filmi "Ballë për ballë". Ne kemi marrë 4

nëndetëse të cilat kishin efektivë shqiptarë të përgatitur, ndërkohë 4 nëndetëset që ishin me efektiv të përbashkët ruso-shqiptarë nuk u morën asnjëherë dhe u kthyen. Jo të gjitha vendet kanë pasur nëndetëse në atë periudhë, e theksoj këtë për të thënë se kjo tregon edhe potencën ushtarake nga ana strategjike si armë, p.sh. komandim-kontrolli në nëndetëse bërtamore, shkon deri edhe në nivel qeverie për sa i përket se kush i komandon. Efektet që ato japin në një kohë krize apo lufte nuk është taktik, por ato japin efekt strategjik ose të kontekstit që të bllokoi përdorimin e detit. Pra edhe efekti psikologjik kur ti ke nëndetësen të bën të mendohesh dyfish në përdorimin e aseteve të tua. Pra ndërsa ne kemi pasur 4 nëndetëse në këtë shtrirje bregdetare që kemi dhe Italia ka pasur 10 tregon që ne kemi qenë tepër të pajisur. Ato kanë kryer shumë operacione në det, dalje në Mesdhe. Qëndrimi me ditë të tëra në nëndetëse është vështirësi më vete. Nga pikëpamja teknike-administrative se si funksionon, nëndetësja është një trup që merr ujë dhe rëndohet e zhytet dhe e nxjerr ujin dhe del në sipërfaqe. Çdo gjë brenda saj është



e mbyllur e zhytur dhe çdo lloj aktiviteti zhvillohet atje në një cikël të mbyllur. Nëndetëset tona kanë pasur një autonomi 10 ditore në det, pra zhyteshin dhe dilnin jashtë pas 10 ditësh. Dhe autonominë 30 ditë që kishte rezerva ushqimore. Ky cikël i mbyllur i jetesës së nëndetës nuk ishte një ambient i shëndetshëm, pikërisht për këtë ata janë trajtuar ndryshe me normat, por edhe nga pikëpamja morale brenda flotës detare, ku në vetvete ka pasur një nivel ndarje dhe krenarie. Nëndetësja merrte detarët më të mirë, më elitare, fillonte ndarja që në Akademinë e Marinës, nëndetësja që mund të ishte aq e frikshme, kur e shihje, i lidhte njerëzit me njëri-tjetrin, i familjarizonte, sepse gabimi yt i kushtonte jetën një efektiv prej 50 vetash. Profesionalizmi dhe aftësia ka prevaluar. Ne jemi krenarë që i patëm në përdorim në një periudhë 40-vjeçare.

**Kolonel Razije  
Mehmeti, Shefe  
e Departamentit  
të Strategjisë  
dhe Studimeve  
të Avancuara në  
Kolegjin e Mbrojtjes  
dhe Sigurisë në FA**



## **Femrat janë një forcë e fuqishme, ato mund të ndryshojnë historinë, të mobilizojnë ushtritë dhe të fillojnë revolucionet**

**N**ë vitin 2013, ushtarake Razije Mehmeti do të vlerësohej edhe me një yll tjetër nga Komisioni i Karrierës, ku do t'i jepej grada “kolonel”. E çdo yll që shtohet në uniformë mbi supet e një ushtaraku do të thotë për të, një shkallë e ngjitur në karrierë, do të thotë më shumë përgjegjësi për të marrë, më shumë shembull për të dhënë. Një yll më tepër për një ushtarak do të thotë, një hap më tej

në shtegun e nisur, por që tashmë ai shteg është një rrugë e gjerë, e bukur, e përshkruar me bashkudhëtarët e vështirësive, sakrificave, bashkudhëtarët nën uniformë, pjesëtarë të një familje të madhe ashtu siç vetëm ushtarakët e Forcave të Armatosura dinë të ndërtojnë. E teksa ka ngjitur shkallët e karrierës në rrugëtimin e saj si ushtarake, kolonel Razije Mehmeti ka gëzuar respektin nga eprorët, kolegët, vartësit, por edhe nga komuniteti ku ajo banon.

Është dekoruar disa herë me medalje shërbimi e karriere nga ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe komandantët e Forcave. Bashkia Durrës i ka dhënë koloneles titullin “Nderi i Punës” me motivacionin “Për vlera të larta profesionale, intelektuale në shërbim të vendit dhe komunitetit, krahas kolegeve të tjera femra në fushën civile”.

Përveçse si një ushtarake, kolonel Razija është nënë, grua, bashkëshorte dhe aktiviste e respektuar në shoqëri, në kohën e lirë. Familja e saj ka qenë mbështetësja kryesore për arritjet e deritanishme. Por edhe bashkëshorti, Iliri, tashmë një ushtarak në rezervë, ka qenë në krah të saj në çdo hap si shok e koleg. Duke ndihmuar e këshilluar njëri-tjetrin në rrugën e përbashkët të profesionit, ata u bënë shembull i mirë për fëmijët e tyre Besa dhe Arbër. “Të dy kanë krijuar familjet e tyre dhe jam e lumtur për këtë. Kam dhe një nip, i cili më ka dhënë titullin ‘gjyshe’ dhe nuk ka fjalë që mund të përshkruajë gëzimin që më ka sjellë”, - na tregon kolonel Razija. “Së bashku me mua jeton dhe nëna e bashkëshortit, të cilën e kam pasur gjithmonë ndihmë. E respektojmë njëra-tjetrën dhe kemi një raport të shkëlqyer si nuse dhe vjehërr, herë si dy shoqe të mira dhe herë si nënë e vajzë”.

Kolonel Razije Mehmeti ka 37 vite si ushtarake aktive nën uniformë, me një jetë të mbushur me gëzime e shqetësime, me

pengesa dhe përpjekje për t’i kapërcyer ato, detyra funksionale nga më të ndryshmet, por të realizuara të gjitha me sukses.

### **“Në krye të të gjitha dëshirave qëndronte dëshira për t’u bërë ushtarake”**

Kolonel Razije Mehmeti, ka lindur në fshatin Ballaj në Kavajë, më 11 qershor 1967. Ballaj është një fshat me banorë të ardhur tërësisht kosovarë. Familja e Razijes ishte tradicionale atdhetare, babai i saj me prejardhje nga Godeni i Gjilanit të Kosovës e ndërsa nëna nga një familje ushtarake nga Përmeti.

Shkollën e mesme e ka kryer në vendlindjen e saj, ku si një nxënëse e dalluar në mësim kishte ëndrra të ndiqte studimet edhe më tej, shkollën e lartë. “Si çdo vajzë e asaj moshe kisha shumë dëshira për shkollën e lartë, - na tregon sot kolonel Razija, - por në krye të të gjithave qëndronte dëshira për të plotësuar ëndrrën e babait, që një nga fëmijët të bëhej ushtarak. Dhe unë isha fëmija e fundit e familjes, prandaj s’kisha si të mos plotësoja dëshirën e tij”, - thotë ajo dhe buzëqesh.

Ajo na tregon se në përfundim të vitit të maturës në Kavajë po zhvillohej stërvitja “Kavaja-86”, ku Razija si maturante ishte pjesë e kësaj stërvitjeje. Toga ku ajo merrte pjesë në këtë stërvitje dhe ku ajo ishte përgjegjëse, spikati me korrektësinë dhe angazhimin maksimal për realizimin me sukses të detyrës që iu ishte besuar.



Në përfundim të stërvitjes, Razija u dekorua nga Kuvendi Popullor i kohës për arritje të shkëlqyera. “Ky ishte pikërisht momenti që më bëri të vendosja përfundimisht për degën që do të nisja, duke realizuar edhe ëndrrën për të vazhduar Shkollën e Bashkuar të Oficerëve”.

Dhe në shtator të vitit 1986 Razija do ta gjente veten nën uniformë, në auditorët e shkollës ushtarake në Fakultetin Gjitharmësh, dega Këmbësori.

Studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve ishte një sfidë më vete. Përballja me rregullin dhe disiplinën, mbajtja e uniformës, largësia nga familja, zgjimet herët në mëngjes, alarmet ditën dhe natën, rreshtimet etj., si dhe çdo detaj tjetër i jetës studentore, ishin një sfidë e përditshme. Gjatë katër viteve të shkollës ushtarake, teksa hulumtojmë për të sjellë portretin e kolonel Razije Mehmetit në faqet e shtypit ushtarak, mësojmë se, krahas vajzave të tjera, Razija shpalosi vlerat më të mira të karakterit dhe personalitetit të një studenti ushtarak. Ajo ishte krah shoqeve të klasës, 1986-1990, të cilat ishin gjithmonë mbështetje për njëra-tjetrën, si Moza nga Gjirokastra, Violeta nga Fushë-Arri, Majlinda nga Kruja, Arta nga Shkodra, Leti nga Vlora, Majlinda nga Tirana, Bona nga Tropoja, Nora nga Rresheni dhe Shorja nga Bajza e Kastratit etj. Kolonelja kujton edhe pedagogun kujdestar Koco Babliku, “që gjithmonë i këshillonte si prind”, si dhe pedagogun e taktikës Kristo Rrapo, në stërvitjet e panumërta të vështira që ato zhvillonin ditën dhe natën.

### 37 vite si ushtarake aktive nën uniformë

“Në shtator të vitit 1990 diplomohem dhe emërohem Instruktorë në Shkollën e Lirë Ushtarake Kavajë”, - thotë kolonel Razija. “Më kujtohet dita e parë që u paraqita në punë, me sikletin se si do të prezantohesha...sapo futem në derën e repartit po me priste një oficerë në moshë (Kaliro Papa). Impresioni që pata nga takimi ishte shumë mbresëlënës, pasi që në fillimi nisi të më tregonte për punën, se si kishin arritur deri aty, vështirësitë që kishin patur dhe se në çdo moment do të më mbështetnin për çdo nevojë”. Dhe kështu filloi karriera ushtarake me vështirësitë e veta, duke njohur kolegët, eporët dhe vartësit, duke marrë përsipër detyrat dhe urdhrat e parë.

Ishte koha e ndryshimeve të mëdha të sistemit dhe zhvillimeve



demokratike në vend, ku dhe femrat ushtarake si pjesë e Forcave të Armatosura do të ndjenin ndryshimet rrënjësore me reforma dhe ristrukturime të reja. Reformimi i FA-së do të fillonte nga themelet dhe shumë shpejt do të jepte efektet e veta, duke e bërë vendin tonë vend partner PfP dhe më pas anëtare të NATO-s.

Gjatë kësaj periudhe filluan dhe trajnime e stërvitje të ndryshme, duke u bërë pjesë aktive e pandashme e këtyre zhvillimeve jetike me kontribute e suksese konkrete.

Pas plotësimit me sukses të detyrave funksionale të ndryshme, me përgjegjësi në rritje do të vazhdonte dhe avancimi në gradë dhe karrierë nga grada “togër” deri në gradën “kolonel”, gradë që Razija mban edhe sot. Arritjet e deritanishme nuk kanë qenë një rrugë e shtruar dhe pa vështirësi. Shpeshherë ushtarakeve femra u është dashur që të përballen me mentalitete e kultura të ndryshme në shumë drejtime. Por çdo gjë është realizuar me

mund dhe sakrificë, duke ndryshuar mentalitete, duke i ngjitur shkallët e karrierës një e nga një, duke konkurruar me vlerat dhe standardet që kërkonte koha, njëlloj si kolegët e tyre meshkuj.

37 vite si ushtarake aktive nën uniformë ( 33 vjet punë dhe 4 vjet Akademia ushtarake). “Nuk janë pak...një jetë e mbushur me gëzime e shqetësime, me pengesa dhe përpjekje për t’i kapërcyer ato”.

Detyra funksionale nga më të ndryshmet por të realizuara me sukses, duke filluar nga Instruktore e SHLU-së Kavajë, Komandant kompanie, Shefe e Sekretarisë Sekrete dhe Shifrance në BrK Kavajë dhe Shijak. Më pas për shkak të ndryshimeve dhe reformave në FA në vitin 2001, Razija filloi punën në Komandën e Forcës Detare si shefe Protokolli dhe Sekretarie, duke vijuar njëkohësisht trajnimet dhe kualifikimet për përparimet në gradë. Më pas vazhdoi detyrën si Shefe e Degës Zbulimit në komandën e FD dhe më pas Shefe e Sektorit të Organizimit në Forcën e Bashkuar, duke vijuar më pas Drejtore e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në MM, Shefe e Personel-Organizimit në FD, Atashe Ushtarak rezident në Turqi dhe jo rezident në Hungari, Rumani dhe Bullgari, Shefe e Departamentit të Strategjisë dhe Historisë në AM, Shefe e Arsimimit, Stërvitjes dhe Kurrikulave në KDS-së, Drejtore e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në SHPFA.

Në vitin 2021-2022 ka marrë pjesë një vit në misionin e NATO-s KFOR në Kosovë dhe pas përfundimit të misionit vazhdon detyrën si Shefe e Departamentit të Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në FA.

“Nga detyrat më mbresëlënëse dhe që ka lënë gjurmë në karrierën time është si Atashe Ushtarak dhe misioni në KFOR Kosovë”, - thotë kolonel Razija, teksa na tregon mbi përmbyshjen me sukses të detyrës së përfaqësimit të FA-së jashtë vendit.

#### **Atashe në katër shtete, e para atashe ushtarake femër e FA-së**

Në vitin 2014-2017, kolonel Razije Mehmeti u caktua me detyrë Atashe Ushtarak rezident në Turqi dhe jo rezident në Bullgari, Hungari dhe Rumani. “Jam ndërjer shumë e vlerësuar që për herë të parë, si një femër ushtarake e Forcave të Armatosura, mbajta titullin Atashe Ushtarak, duke përfaqësuar vendin tonë në katër shtete”, - thotë kolonel Razija. “Nuk ishte e lehtë të futeshe në rrugën e diplomacisë ushtarake. Diplomacia, që ndryshe quhet dhe ‘arti i marrëveshjes’, është mirëmbajtja e marrëdhënieve në mes shteteve, nëpërmjet marrëveshjeve si dhe metodave të zbatuara”, - specifikon ajo.

Një Atashe është një zyrtar nën autoritetin e një Ambasadori apo kreu tjetër të një misioni diplomatik, i cili shërben si diplomat apo si anëtar i personelit ndihmës. Atasheu Ushtarak vepron si një këshilltar ushtarak i sigurisë dhe mbrojtjes si dhe një koordinator në fushën e bashkëpunimit ushtarak për titullarin dhe stafin e përfaqësuesit të ambasadës. Gjatë kësaj periudhe shërbimi kolonel Mehmeti ka përcjellë vlerat më të mira kulturore artistike e ushtarake të vendit tonë, sidomos edhe ku në bashkëpunim

me studentët ushtarakë shqiptarë dhe stafin e Ambasadës kanë organizuar pritje dhe ceremoni të ndryshme si p.sh: Dita e Forcave të Armatosura, Festat e nëntorit, Festa e Vitit të Ri, duke ftuar përfaqësues të ndryshëm të ambasadave dhe korpusit të Atasheve Ushtarakë në Turqi (AMAC Group).

“Gjithmonë jam ndërjer krenare me studentët tanë ushtarakë që studiojnë në Turqi, pasi renditeshin gjithmonë të parët në rezultatet e arritura krahasuar me studentët e vendeve të tjera”, - thotë kolonelja.

#### **Nga DCOS SPT në HQ KFOR në Përfaqësues i Lartë Ushtarak Kombëtar (SNR) në KFOR**

Në nëntor 2021 - nëntor 2022, kolonel Razija ka marrë pjesë në misionin e NATO-s, KFOR, Kosovë, me detyrë si “Zëvendës Shef Shtabi për mbështetjen” DCOS SPT, në HQ KFOR Prishtinë. Misioni i saj ishte të planifikonte, koordinonte dhe ofronte mbështetje me personel, logjistikë, inxhinier, EOD, komunikim dhe mbështetje shëndetësore për komandën e KFOR-it dhe n/repartet e saj në vijim të përmbyshjes së misionit në Zonën e Operacionit.

Gjatë gjithë periudhës së misionit janë zbatuar në mënyrë rigoroze të gjitha detyrat e përcaktuara, ku kolonelja ka marrë dhe vlerësimet maksimale “Shkëlqyer” nga eprorët e saj të misionit si Komandanti i KFOR-it dhe Shefi i Shtabit i KFOR-it. Përveç detyrës DCOS SPT, kolonele Razija ka mbajtur dhe pozicionin e Përfaqësuesit të Lartë Ushtarak Kombëtar (SNR) në KFOR. Gjatë kësaj periudhe puna e të gjithë ushtarakëve shqiptarë në KFOR është vlerësuar me superlativë, duke marrë dhe medaljet përkatëse.

Pjesë e karrierës ushtarake kanë qenë dhe kualifikimet dhe trajnimet e ndryshme të kryera brenda dhe jashtë vendit: KTHOSH pranë AM “Spiro Moisiu” viti 2003; KKSHP viti 2007-2008; KLOviti 2010- 2011.

Në vitin 2012 ka mbrojtur Master shkencor Ekzekutiv me temë: “Roli dhe veprimtaria e Qendrës Ndërinstitucionale Detare” e në vitin 2021 ka zhvilluar Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në AM.

Po gjatë kësaj periudhe ka kryer dhe trajnime afatshkurtra jashtë vendit si RACVIAC, Kroaci, Bosnje-Hercegovinë, Turqi etj. Po kështu ka marrë pjesë në disa trajnime në bashkëpunim me UN për barazinë gjinore në FARSH “Gruaja Paqja dhe Siguria”.

Kudo ku ka shkuar si përfaqësuese e FARSH, në kurse, seminare, vizita familjarizuese apo takime zyrtare me ushtarakë dhe civilë të huaj, kolonel Razije Mehmeti ka marrë vlerësime pozitive, duke përcjellë mbrojtjen e vlerave tona në interes të mirëkuptimit dhe paqes.

Në vitin 2009 nga Kryetari i Bashkisë Durrës i është dhënë Titulli “Nderi i Punës”, me motivacionin “Për vlera të larta profesionale, intelektuale në shërbim të vendit dhe komunitetit, krahas kolegeve të tjera femra në fushën civile.

# Skënderbegasi Agim Gjini, vend nderi në fushën e shkencës

**D**oçent Agim Gjini ka lindur në Steblevë, Dibër, dhe banon në Tiranë. Ka kryer Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, Shkollën e Lartë, Akademia Ushtarake “Skënderbej”, kursin e Shtabit të armëve e shërbimeve në Akademinë e Mbrojtjes, kursin e Komandës së Shtabit Përgjithshëm, Akademia Mbrojtjes. Ka kryer studimet pasuniversitare me cikël të plotë studimi 2-vjeçarë në Akademinë e Mbrojtjes, kursin e avancuar të Shtabit për Operacionet paqeruajtëse, shkollën e NATO-s, Kilkis, Greqi, Kurs Didaktik AM, si pedagog, Akademia e Hamburgut-Gjermani, Kursi “Lufta kundër terrorizmit”, Shkolla NATO-s Oberamalgao-Gjermani, Kurs Didaktik AM. Ai zotëron gjuhët e huaja anglisht, rusisht dhe serbo-kroatisht. Ka “Master Shkencor” në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, titulli Akademik “Doçent” dhe gradën “nënkolonel”. Ka kryer detyra nga roli bazë deri në pedagog në Akademinë e Mbrojtjes. Është vlerësuar me medaljet: “Medalja e Shërbimit Ushtarak”, dhënë nga Presidenti i RSH, “Medalja e Karrierës”, “Medalje nderi për shërbimin ushtarak” dhe “Medalje për shërbim ushtarak”.

Ai ka një veprimtari të dendur shkencore, ku mund të përmendim tekstet dhe metodikat si, tekst mësimor Operacionet COIN bashkautor, fq. 200; rreth 100 leksione



**SKËNDERBEGASI AGIM GJINI KA KRYER DETYRA NGA ROLI BAZË DERI NË PEDAGOG NË AKADEMINË E MBROJTJES. ËSHTË VLERËSUAR ME MEDALJET: “MEDALJA E SHËRBIMIT USHTARAK”, DHËNË NGA PRESIDENTI I RSH, “MEDALJA E KARRIERËS”, “MEDALJE NDERI PËR SHËRBIMIN USHTARAK” DHE “MEDALJE PËR SHËRBIM USHTARAK”.**

e metodika shkencore për probleme të sigurisë, mbrojtjes dhe stërvitjes, është pjesëmarrës në materialet e mëposhtme, pjesëmarrës në grupin e punës për ripunimin e Doktrinë së Përbashkët të Forcave të Armatosura, në metodikat e stërvitjeve të zhvilluara nga SHPFA, në metodikën e stërvitjes “Gjallica 2001” nga Forcat Tokësore; në udhëheqje temash studimore dhe kursore me KKSHP, Kursin e Funksioneve në Shtab, në grupin e punës për hartimin e Rregullores QBO, në grupin e punës për hartimin e Dok-

trinës së Përbashkët të FARSH, në grupin e punës për hartimin e Doktrinë Logjistike të FARSH, në grupin e punës për hartimin Rregullores të Uniformës në FA, në grupin e punës për hartimin e Rregullores të Botimeve Doktrimore, në metodikat: “Batalioni i këmbësorisë në luftimin mbrojtës”, “Brigada e këmbësorisë në mbrojtje”, “Brigada e këmbësorisë në sulm”, “Forca e Bashkuar në operacion mbrojtës”, “Forca e Bashkuar në operacion në përgjigje të krizave”, stërvitje shtabi, “Brigada multinacionale në operacionet mbështetëse të paqes”,



stërvitje planëzimi. Pjesa e kursantit për metodikat stërvitje planëzimi me KKSHP në mbrojtje e mësimje për vitet 2008 dhe shumë të tjera...

Profesor Agimi, gjithashtu, është autor e bashkëpunëtor në shumë tekste mësimore ushtarake.

Tashmë është fakt i njohur që ushtarakët

me formim bazë në Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Skënderbej", jo vetëm kanë qenë dhe mbeten baza e Forcave tona të Armatosura, kanë shkëlqyer në sportin shqiptar, në diplomaci, në administratë deri në drejtimin e shtetit, në art e kulturë, në mjekësi etj., por kanë zënë dhe një vend nderi në fushën e shkencave.

Janë me dhjetëra e qindra doktorë, profesorë që kanë studiuar në bankat e shkollës "Skënderbej" dhe falë studimeve e kërkimeve dhe punën këmbëngulëse në shkencat ushtarake e fusha të tjera, kanë bërë emër jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj.

Referuar statistikave, numri i personaliteteve, nxënës të kësaj shkolle që falë studimeve dhe aplikimeve me interes të gjerë në dobi të shoqërisë e vendit, kanë fituar tituj e grada të larta shkencore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, është i konsiderueshëm. Dhe ajo çfarë është më e rëndësishme, pjesa më e madhe e studimeve apo botimeve të tyre nuk janë thjeshtë për të fituar një diplomë apo titull shkencor, por kanë shërbyer si mjete mësimi për shtresa të kualifikuara studentësh apo grupe të tjera të interesuara. Para vitit 1990, numri i ushtarakëve me tituj të lartë shkencor, ka qenë tejet minimal, ndërsa pas ndryshimit të sistemit, konstatohet një rritje e ndjeshme. Futja e ushtrisë shqiptare në NATO dhe qenia e saj prezente, jo vetëm në stërvitjet e përbashkëta (dhe të shumta në numër) të zhvilluara në përbërje e bashkëpunim me forcat e kësaj aleance ushtarake, si dhe pjesëmarrja e ushtarakëve shqiptarë në misione paqeje në disa vatra të nxehta, krijuan hapësira të tjera studimi e kualifikimi shkencor dhe për oficerët shqiptarë.

Një pjesë e mbrojtjes së titujve shkencorë të tyre janë bërë dhe para komisioneve ndërkombëtare dhe duke pasur si objekt studime të kualifikuara nga këto aktivitete të përbashkëta me aleatët.

Oficerë me bazë shkollën "Skënderbej" me grada shkencore, falë studimeve të tyre por dhe aftësive profesionale, janë thirrur në vende kyçe të forcave aleate në misionet e saj për paqen e sigurinë globale. Në debate profesionistësh në ballafaqime ndërkombëtare, ushtarakët shkencëtarë të vendit tonë, janë përfaqësuar me dinjitet dhe kanë marrë vlerësime nga kolegët e vendeve të tjera.

# "UNË ARRIJ NË PËRFUNDIMIN SE PJESA MË E MADHE E TË KËQIJAVE TË NJERËZIMIT KANË ARDHUR NGA VLERËSIMET E GABUARA QË IU JANË BËRË VLERAVE"

**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit  
të Botimeve



**Sa e rëndësishme është që në rrugëtimin tonë të jetës të mbartim vlera dhe moralin e një shoqërie europiane të civilizuar, por jo të degjeneruar, parimesh e normash?**

Njeriu, si qenie sociale, e ka të domosdoshme që t'i marrë parasysh vlerat, bindjet, qëndrimet dhe matricat e sjelljes sociale. Adaptimi ndaj jetës sociale është një proces që vazhdon përgjatë gjithë jetës. Ky proces e mundëson njeriun si qenie sociale dhe vazhdimësinë shoqërore. Vlerat janë parime që na mundësojnë menaxhimin e sjelljeve tona për të realizuar veten si individë në kontekste dhe mjedise të ndryshme. Ato janë bindje dhe kritere që na mundësojnë të preferojmë, të pranojmë dhe të zgjedhim një gjë karshi tjetrës, ose një sjellje karshi tjetrës, përgjatë gjithë fazave të jetës. Vlerat janë burime të sadsifaksionit dhe përplotësimit, të cilat drejtojnë sjelljet tona.

**A janë vlerat pjesë e identitetit tonë si njerëz që shfaqim kursin tonë të veprimit në shtëpi, punë, ose në ndonjë fushë tjetër të jetës, në çastet e kënaqësisë ose të krizës?**

Vlerat na tregojnë si të sillemi apo të mos sillemi kur ballafaqohemi me dëshira ose impulse, kur jemi vetë ose me të tjerë. Vlerat janë kompas që na ndihmon të sillemi në mënyrë konsistente, pa marrë parasysh situatën. Për shembull, kur e përdorim transportin urban, disa ia lëshojnë vendin një gruaje shtatzënë, e disa të tjerë jo. Të parët besojnë në vlerën e kortsizisë dhe në konsideratën ndaj të tjerëve, pa marrë parasysh në janë të huaj ose jo. Në mesin e atyre që nuk e lëshojnë ulësen e tyre janë fëmijët (të cilët ende nuk e kanë rrokur këtë vlerë), njerëzit më

të vjetër, që i japin përparësi komfortit të tyre, ose ata që i japin përparësi kënaqësisë së tyre.

**A është koncepti i vlerës përcaktues i peshës së një fenomeni, të një grupi dhe individit brenda shoqërisë?**

Një gjë mund të mos ketë rëndësinë e njëjtë në dy shoqëri të ndryshme. P.sh, në një shoqëri të robëruar, liria përbën vlerën më të lartë, kurse, në një tjetër, vlerë superiore mund të jetë diçka krejtësisht tjetër.

Vlerat materiale dhe ato shpirtërore shpeshherë janë të ngërthyera në njëra-tjetrën. Për shembull, një orë me qostek e mbetur nga gjyshi mund të ketë edhe vlerë materiale, edhe shpirtërore. Ngjashëm qëndron puna edhe me veprat historike. Një person që i vjen në ndihmë me para një të riu që s'ka mundësi të shkollohet, që ia paguan semestrat, në realitet ka bërë një veprim të vlefshëm në të dy aspektet. Vlerat përfaqësojnë idealet e një shoqërie, si vëllazëria, toleranca, barazia, familja, atdheu, respekti, sinqeriteti, etj.

Nganjëherë shoqëritë mund t'i shndërrojnë në vlera edhe gjëra që në fakt përbëjnë antipodin e tyre, si p.sh., racizmi (në periudhën e fashizmit), ksenofobia (në Europën e sotme), huliganizmi ("vlerë" rinore), "Big brother kultura", etj.

**Po mediat, çfarë roli po luajnë në lançimin e vlerave tek brezat e rinj?**

Mediat në Shqipëri, me agresivitetin e tyre të frikshëm, po vrasin moralin, po shkatërrojnë familjen, ekonominë, qetësinë sociale dhe po vetë-shkatërrohen e deformohen në misionin e tyre për triumfin e demokracisë.

Është koha të kujtojmë një thënie të Koletës, se: "Drejtësia i nevojitet një populli më tepër mbase edhe se qytetërimi". Situata kontraverse ku kanë arritur mediat në vendin tonë, mund të rregullohen vetëm po të ndëshkohen si një e keqe e madhe, që ka prekur shoqërinë tonë në tranzicionin e zgjatur e të rraskapitur, në çdo qelizë të jetës.

Media përmes programacionit ka provuar të edukojë apo pasurojë audiencën me modele të qëndrueshme dhe serioze në përputhje me moralin me qëllim që audienca t'i përqafojë, por fatkeqësisht ajo i ka braktisur.



Media duhet të luftojë përballë banalitetit dhe degjenerimit, duke dhënë një shembull për të rinjtë por a nuk duhet ta kishte bërë familja, shoqëria, edukimi apo politikat rimore, sociale dhe arsimore këtë proces, duke i përgatitur të rinjtë të zgjedhin çfarë u nevojitet, duke e shpëtuar këssoj dhe median nga dilemat, roli në meritokraci dhe dëmi në imazh.

Media duhet të zbatojë ligjin mbi përputhshmërinë e përmbajtjes së formateve të saj, por a janë bërë sondazhe/pyetësorë dhe studime, se çfarë dëshiron audienca, pasi në dijeninë time formatet, të “cilësuar banale”, kanë thyer rekorde shikueshmërie. Media duhet të prezantojë sa më shumë modele të qëndrueshme konform të gjitha parimeve dhe standardeve të shoqërisë për audiencën, por kultura dhe edukata fillon nga familja dhe shoqëria, forcohet nga shkollimi, përforcohet nga puna dhe del në pah nga suksesi i arritur në karrierë e promovimi përmes saj, proces në të cilin media ose është plotësuese ose jo prezente.

#### **Ku duhet ta kërkojmë gabimin për këtë pushtet antivlerash që na ka zaptuar si popull?**

Para se t'i kërkojmë llogari gjithkujt për atë që vetë ne e kemi në dorë, do të duhet të ngrihemi, kontribuojmë dhe punojmë të gjithë nga pak mbi çfarë është bërë gabim dhe mungon në shoqërinë tonë, që banaliteti jo vetëm ndiqet masivisht por edhe në plot raste është kthyer në stil jetese, sidomos në mungesë të vlerësimit sipas meritës apo zhvlerësimit të rëndësishëm të profesionalizmit, si i vetmi etalon referimi për sukses në karrierë. Vlerat janë veshja që i shkon gjithkujt, thjeshtë të duhet të dish ta mbash me dinjitet, duke investuar çdo ditë në rritjen e kapaciteteve të tua, për ta deleguar tek brezat e rinj, të cilëve duhet t'u tregojmë se asgjë banale nuk “ju bën më të rritur”, nuk ju bën të dukeni “të fortë”, përkundrazi ju zvogëlon dhe ju mpak në të ardhmen e afërt, e cila mund të kthehet në një rreth vicioz pa anë.



# BULLIZMI, “epidemia sociale” e shekullit XXI

**ANJEZA MUSOLLARI,**  
Shefe e Sektorit  
të Botimeve

**C**do fillim shtatori, në të gjitha familjet shqiptare dhe jo vetëm, fillojnë përgatitjet e fëmijëve për një rrugëtim të ri drejt dijes.

Emocione bashkuar me ankth pse jo dhe frikë, se si do shkojë ky labirint me shumë të panjohura. Shumë punë dhe përpjekje për të arritur të bëhen qytetarë të denjë të Europës duhet nga prindërit, aty ku fillon baza e themelit të formimit të fëmijës.

Familja, institucioni nga ku e tashmja sjell të nesërmen e sigurt të së ardhmes së ndritur të një kombi, duhet të ‘investojë’ cilësisht kohë fizike tek fëmijët e saj. Uluni me fëmijën tuaj 5 minuta, dhe shpjego-

jini se të qenit shumë i gjatë, i shkurtër, i dobët, i kuq apo ndonjë ngjyrë tjetër nuk kanë arsye për të qeshur. Apo nëse një nxënës mban syze apo të njëjtat këpucë çdo ditë.

Shpjegojini fëmijëve se, një çantë shpine e përdorur mbart të njëjtat ëndrra si një e re.

Mësojini fëmijët të mos përjashtojnë askënd, sepse janë të varfër apo të ndryshëm.

Shpjegojini se ngacmimi dhemb dhe se shkolla është për të mësuar, jo për të konkurruar.

**Të gjithë kemi të njëjtën vlerë.**

Bullizmi është një dhunë psikologjike ose fizike, e cila ndodh masivisht në të gjitha shtetet e botës, duke filluar me fëmijët që në bankat e para të shkollës. Dhuna në mjediset e shkollës, në të gjitha format e saj është një shkelje e të drejtave të fëmi-

jëve dhe adoleshentëve për arsim, shëndet dhe mirëqenie.

Asnjë shtet nuk mund të arrijë një edukim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë, nëse nxënësit përjetojnë dhunë apo bullizëm në shkollë.

Sipas mjekëve psikiatër bullizmi shton 6 deri në 9 herë idetë për suicid (vetëvrasje), ose në qoftë se rrethanat do të vijnë në favorin e viktimës ai mund të kthehet në një hakmarrës, duke u bërë nga i viktimizuar në viktimizues.

Fatkeqësisht bullizmi në përqindjen më të madhe kryhet në ambientet e shkollave në moshën feminare të nxënësve dhe adoleshentëve por nuk përjashtohen raste edhe te të rinjtë. Ky fenomen është një paradoks kulturor-social, sepse shkolla aspirohet të jetë si vendi i shenjtë, ku

mësohet dija kultura, emancipohen brezat, duke u bërë më të mirë se pasardhësit tanë të çliruar nga konfliktet fisnore, gjinore, klasore, që i përkasin primitivizmit social. Pavarësisht ndërgjegjësimit që po i bëhet këtij fenomeni nëpër shkolla me biseda, punës së diferencuar të psikologut, punonjësit social, ndërhyrjes prindërore, përsëri sipas statistikave në botë edhe në Shqipëri bullizmi po përhapet si një epidemi me shumë viktime.

Nga studimi i fundit në rang kombëtar nga studiues evropianë dhe shqiptarë në 141 shkolla, nga klasat e 5-ta deri në të mesmen, sipas pyetjeve, nxënës mësues dhe prindër u konstatua se 1 në 5 nxënës ose mbi 20% janë prekur nga simptoma e bullizmit nëpër shkolla, 10% janë viktime, 6% agresorë dhe 4% agresorë edhe viktime bashkë.

Si prind me fëmijë të kësaj moshe, ndihem e shqetësuar dhe mendoj se nuk duhet të rrimë indiferentë, duke thënë vetëm “larg shtëpisë time”, por secili sipas statusit dhe mundësisë duhet të japë kontributin që fenomeni të mos përparojë dhe të bëhet “epidemi sociale”, ashtu siç fatkeqësisht është kthyer në ‘trendin’ e këtij shekulli.

#### **Stilet e prindërimit**

Karakteristikat brenda familjes i kontribuojnë formimit të sjelljeve dhe qëndrimeve të fëmijëve, të cilat mund të ndikojnë në bullizmin në shkollë. Niveli i ulët i përfshirjes së prindërve në jetën shkollore të fëmijëve, niveli i ulët i përkrahjes prindërore, mungesa e mbikëqyrjes së sjelljes së fëmijëve nga ana e prindërve, niveli i ulët i komunikimit mes fëmijëve dhe prindërve, ekspozimi ndaj dhunës në familje dhe abuzimi i fëmijëve, janë të ndërlidhura me bullizmin në shkollë.

Stilet e prindërimit në marrëdhënie me fëmijët e tyre janë gjetur si indikatorë të bullizmit. Fëmijët e rritur nga prindër liberalë (stil që karakterizohet nga prindër jo kërkues dhe nivel të lartë të responsivitetit apo reagimeve ndaj kërkesave të fëmijëve), përbëjnë rrezik të bëhen bullistë, ndërsa

fëmijët e rritur nga prindër autoritarë (stil që karakterizohet nga prindër kërkues me nivel të ulët të responsivitetit apo reagimeve ndaj kërkesave të fëmijëve) janë në rrezik të bëhen viktime bullizmit. Kjo mund të sqarohet në dritën e të nxënës social, sjelljet e fëmijëve formohen nëpërmjet modelimit të sjelljeve të të rriturve. Dhe, nëse prindërit shfaqin sjellje të dhunshme për të arritur synimet e tyre, edhe fëmijët do të modelojnë po të njëjtat sjellje në raportet e tyre sociale. Në anën tjetër, viktimat e bullizmit janë më të rrezikuara të rriten nga prindër tejet mbrojtës, sidomos nënat. Fëmijëve të tej mbrojtur apo të monitoruar nga prindërit i jepen mesazhe të gabuara lidhur me kompetencën e tyre, çka do të thotë se ata nuk janë kompetentë në menaxhimin e situatave të ndryshme jetësore. Rrjedhimisht, një gjë e tillë ndikon në zhvillimin

e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit të ulët të fëmijëve. Në shtëpi fëmijët mësojnë si të bisedojnë dhe të zhvillojnë aftësitë gjuhësore, mësojnë vlerat, shprehitë sociale si dhe njohuri për shoqërinë.

Faktori edukativ, i cili edukimin e bën si të pazëvendësueshëm, është ndjenja e dashurisë, që lidh prindërit me fëmijët e tyre. Dashuria ndaj prindërve, që nga fillimi paraqet kusht për krijimin e ndjenjave sociale të fëmijës. Mirësia, dhembshuria, dëshira për të kuptuar dhe nderuar etj.

Gjithçka nis nga familja, dhe si e tillë, duhet pa u lodhur t’u qëndrojmë pranë fëmijëve, për t’i bërë të kuptojnë se ata janë unikë dhe të barabartë mes gjithë të tjerëve. Dhe vetëm kështu do kemi një rini më pak traumatike dhe me vetëbesimin se hapat e tyre janë po aq të fuqishëm sa të dhjetëra moshatarëve të tjerë që ecin përkrah tij.



# Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, NATO dhe OKB, dialog të gjerë përballë sfidave të sigurisë

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në hapjen e sesionit të 78-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (UNGA) në Nju Jork, më 19 shtator 2023. Asambleja e Përgjithshme e këtij viti është e teta që z. Stoltenberg merr pjesë në krye të Aleancës.

Sekretari i Përgjithshëm, më 18 shtator 2023, u takua me presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan, ku Stoltenberg vlerësoi përpjekjet e Turqisë, së bashku me OKB-në, për të ringjallur marrëveshjen e grurit të Detit të Zi. Ata diskutuan më tej shtimin e përpjekjeve të NATO-s në luftën kundër terrorizmit dhe rrugën e Suedisë drejt anëtarësimit në NATO.

Ndërsa në Nju Jork, Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me një numër liderësh të tjerë botërorë dhe zyrtarë të lartë, përfshirë edhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Antonio Guterres, kryeministrin grek Kyriakos Mitsotakis, kryeministrin irakian Mohammed Shia' Al Sudani, ministrin egjiptian të Punëve të Jashtme Sameh Shoukry, ministren e Punëve të Jashtme të Singaporit Vivian Balakrishnan dhe Jasem Al Budaiwi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkëpunimit të Gjirit.

Ndërsa më 21 shtator, z. Stoltenberg ishte i pranishëm në Këshillin për Marrëdhëniet me Jashtë mbi rëndësinë strategjike të lidhjes transatlantike dhe mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën.



## **NATO dhe OKB në bashkëpunim për ruajtjen e paqes dhe sigurisë**

NATO dhe Kombet e Bashkuara (OKB) ndajnë një angazhim për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Të dy organizatat kanë bashkëpunuar në këtë fushë që nga fillimi i viteve 1990, në mbështetje të operacioneve të mbështetjes së paqes dhe menaxhimit të krizave. Kompleksiteti i sfidave të sotme të sigurisë ka kërkuar një dialog më të gjerë midis NATO-s dhe OKB-së. Kjo ka çuar në përfundim të bashkëpunimit dhe marrëveshjeve të ndërlidhjes midis stafit të dy organizatave, si dhe

agjencive të specializuara të OKB-së.

NATO dhe Kombet e Bashkuara u themeluan të dyja në vitet 1940, pas Luftës së Dytë Botërore, për të ruajtur paqen dhe sigurinë. Traktati i Atlantikut të Veriut i NATO-s vepron brenda kornizës së Kartës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë nenin 51, i cili përcakton të drejtën e natyrshme të mbrojtjes individuale ose kolektive të të gjitha vendeve anëtare të OKB-së.

Në shtator 2008, duke u mbështetur në përvojën e më shumë se një dekade të punës së bashku, Sekretarët e Përgjithshëm të NATO-s dhe OKB-së ranë dakord

të krijonin një kornizë për konsultime dhe bashkëpunim të zgjeruar. Që nga nënshkrimi i kornizës së vitit 2008, bashkëpunimi ka vazhduar të zhvillohet në mënyrë praktike, duke marrë parasysh mandatin, ekspertizën, procedurat dhe aftësitë specifike të secilës organizatë. Shkëmbimet dhe dialogu i rregullt në nivele të larta dhe të punës për çështjet politike dhe operacionale janë bërë një tipar standard i marrëdhënieve ndërinstitucionale. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i raporton rregullisht Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për përparimin në operacionet e udhëhequra nga NATO të mandatuara nga OKB-ja dhe për vendimet e tjera kyçe të Këshillit të Atlantikut të Veriut, duke përfshirë në fushën e menaxhimit të krizave dhe në luftën kundër terrorizmit.

OKB-ja ftohet shpesh të marrë pjesë në takimet dhe samitet ministrore të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së dhe takimet e nivelit të stafit, që mbulojnë gamën e gjerë të bashkëpunimit dhe dialogut, zhvillohen çdo vit ndërmjet sekretariateve të NATO-s dhe OKB-së. Në vitin 2018, Sekretarët e Përgjithshëm ranë dakord të ripërtërijnë këtë angazhim për bashkëpunim dhe dialog të zgjeruar në fushat me interes të përbashkët, si përballimi i kërcënimit të paraqitur nga mjetet shpërthyes të improvizuara; ngritja e kapaciteteve dhe reforma e sektorit të mbrojtjes; mbrojtjen e civilëve; fëmijët dhe konfliktet e armatosura; Gratë, Paqja dhe Siguria; axhenda e Rinisë, Paqes dhe Sigurisë; dhe mbrojtja kibernetike. Në vitin 2010, NATO përforcoi marrëveshjet ekzistuese të ndërlidhjes, duke vendosur postin e Oficerit Ndërlidhës Civil të NATO-s në Kombet e Bashkuara, përveç atij të një Oficeri Ndërlidhës Ushtarak, i krijuar në 1999.

#### **Nga operacionet e paqes tek konsultimet dhe bashkëpunimi i zgjeruar**

Aftësitë dhe përvoja unike e NATO-s mund të jenë një burim i vlefshëm mbështetjeje për OKB-në, paqeruajtësit e së cilës veprojnë në mjedise gjithnjë e më sfiduese

dhe të rrezikshme. Stafi i NATO-s dhe OKB-së kanë punuar për të ndërtuar bashkëpunimin praktik në këtë fushë. Në Samitin e Udhëheqësve të 2015-ës për Ruajtjen e Paqes, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u zotua të rrisë mbështetjen për OKB-në, veçanërisht në fushat e luftimit të pajisjeve shpërthyes të improvizuara (IED), trajnimit dhe gatishmërisë, duke mbështetur përpjekjet e OKB-së për t'u vendosur më shpejt dhe për të punuar më shumë nga afër në ndërtimin e kapaciteteve në vendet në rrezik, si me OKB-në ashtu edhe me BE-në. Në vitin 2020, NATO nisi një iniciativë për ngritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, e cila ofron ekspertizë aleate për mbështetje për trajnimin e paqeruajtësve në fusha përfshirë luftimin e IED-ve, kujdesin mjekësor, TIK/komunikimet dhe vlerësimin e performancës. Paketa synon të forcojë aftësinë e OKB-së për të ngritur dhe mbështetur operacionet paqeruajtëse duke rritur performancën operacionale dhe sigurinë e paqeruajtësve të OKB-së. Ndërsa OKB-ja reformon qasjen e saj ndaj operacioneve të paqes, NATO do të vazhdojë të kërkojë se ku mbështetja e saj mund të sjellë ndryshim.

**Kundër-terrorizmi:** Strategjia globale e OKB-së kundër terrorizmit, konventat ndërkombëtare dhe protokollet kundër terrorizmit, së bashku me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ofrojnë kuadrin për përpjekjet e NATO-s për të luftuar terrorizmin. NATO punon ngushtë në nivele stafi dhe komiteti me Komitetin Kundër Terrorizmit të OKB-së (OKB CTC) dhe Drejtorinë e saj Ekzekutive, si dhe me Task Forcën e Zbatimit të Kundër Terrorizmit dhe shumë nga organizatat përbërëse të saj. Dega e Parandalimit të Terrorizmit e Organizatës së OKB-së për Drogën dhe Krimin është gjithashtu një partner i rëndësishëm për NATO-n.

**Mospërhapja:** NATO po punon ngushtë me OKB-në dhe organizata të tjera ndërkombëtare për të luftuar përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë (WMD) dhe për t'u mbrojtur kundër kërcëni-

meve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore. NATO kontribuon në punën e Komitetit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i krijuar pas miratimit të Rezolutës 1540 (2004) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila trajton kërcënimin ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare që vjen nga përhapja e armëve bërthamore, kimike dhe biologjike dhe mjetet e dorëzimit të tyre. Që nga viti 2004, Aleanca ka organizuar Konferencën Vjetore për Armët e Shkatërrimit në Masë (WMD), Kontrollin e Armëve, Çarmatimin dhe Mospërhapjen me pjesëmarrjen aktive të vendeve partnere dhe organizatave ndërkombëtare.

Ngjarja e fundit, e mbajtur në prill 2023 dhe e ndjekur nga Nënsekretari i Përgjithshëm dhe Përfaqësuesi i Lartë i OKB-së për Çështjet e Çarmatimit Izumi Nakamitsu, eksploroj se si aleatët dhe partnerët e NATO-s mund të forconin regjimet ekzistuese globale të kontrollit të armëve, kryesisht Traktatin e Mospërhapjes Bërthamore dhe Konventat e Armëve Kimike dhe Biologjike, gjatë një periudhe thellësisht sfiduese për kontrollin e armëve. Aleatët dhe partnerët e NATO-s përballen me kërcënime të vazhdueshme nga shkeljet dhe tërheqjet e vazhdueshme të Rusisë nga marrëveshjet ndërkombëtare të kontrollit të armëve, rritja e shpejtë e arsenalit të saj bërthamor nga Kina pa asnjë transparencë, sfidat nga programet bërthamore iraniane dhe koreano-veriore, si dhe teknologjitë e reja si inteligjenca artificiale. NATO ka trajtuar gjithashtu zbatimin e Rezolutës 1540 në nivel rajonal dhe nën-rajonal, duke përfshirë programin e saj "Shkencë për Paqe dhe Siguri", dhe do të vazhdojë të trajtojë nevojën për ndihmë të vendeve partnere sipas kërkesës.

**"Gratë, Paqja dhe Siguria":** NATO mbetet e përkushtuar ndaj zbatimit të plotë të Rezolutës 1325 për "Gratë, Paqen dhe Sigurinë" dhe Rezolutat përkatëse, të cilat synojnë të promovojnë të drejtat e grave, të rrisin pjesëmarrjen e grave në parandalimin dhe përfundimin e konfliktit dhe të mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna seksuale e lidhur me konfliktin. Në përputhje



me politikën e zhvilluar nga aleatët e NATO-s, së bashku me partnerët në Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC), është bërë përparim i rëndësishëm në zbatimin e qëllimeve të përcaktuara në këto Rezoluta. Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për “Gratë, Paqen dhe Sigurinë” i drejtohet rregullisht Këshillit të Sigurimit të OKB-së me rastin e Debateve të Hapura mbi “Gratë, Paqen dhe Sigurinë” dhe mbi dhunën seksuale të lidhur me konfliktin, duke theksuar punën e ndërmarrë nga NATO për zbatimin e rezolutës. Duke u bazuar në kuadrin e RKS KB 1325, NATO rishikoi politikën e saj për “Gratë, Paqen dhe Sigurinë” në vitin 2018, duke prezantuar parimet e politikave të integritetit, gjithëpërfshirjes dhe integritetit. NATO është angazhuar rregullisht me OKB-në për një sërë nismash, përfshirë Politikën e parë të NATO-s për “Parandalimin dhe Përgjigjen ndaj Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual”, e cila u miratua nga Udhëheqësit e NATO-s në Samitin e Brukselit 2021. Të dy organizatat kanë bashkuar gjithashtu përpjekjet për të hartuar Politikën e NATO-s për Luftimin e Dhunës

Seksuale të Lidhur me Konfliktet, për të mbështetur mësimet e nxjerra dhe praktikën e mira dhe për të promovuar zhvillimin e planeve kombëtare të veprimit për vendet anëtare të NATO-s.

**“Mbrotja e fëmijëve në konflikte të armatosura”:** NATO është e përkushtuar për zbatimin e Rezolutës 1612 të KS të OKB-së dhe rezolutat përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve të prekur nga konflikti i armatosur. Në Samitin e Vilniusit të vitit 2023, liderët e NATO-s miratuan Politikën e NATO-s për Fëmijët dhe Konfliktin e Armatosur për të siguruar që Aleanca është mjaft e përgatitur për të parandaluar, monitoruar, përgjigjur dhe raportuar për shkelje të rënda dhe shkelje të tjera serioze ose abuzime ndaj fëmijëve në të gjitha aspektet e Aleancës, operacionet, misionet dhe aktivitetet. Politika, e cila u bazua në ekspertizën e personelit të OKB-së në këtë fushë, kërkon të harmonizojë konsideratat politike dhe operacionale të NATO-s me përparimet në praktikën dhe udhëzimet më të mira ndërkombëtare, si dhe me përparimin në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në lidhje me fëmijët dhe konfliktet e armatosura. Ai

gjithashtu siguron që Aleanca të vazhdojë të angazhohet me OKB-në gjatë të gjitha fazave të operacioneve dhe misioneve të NATO-s për të identifikuar dhe analizuar kërcënimet e mundshme. Ndërsa politika e vitit 2023 merr në konsideratë mësimet e nxjerra dhe praktikën më të mira nga zbatimimi i dokumentit të NATO-s të vitit 2015 “Mbrotja e Fëmijëve në Konflikt të Armatosur - Rruga përpara”, i cili u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me OKB-në dhe partnerët të tjerë dhe i miratuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut në mars 2015.

**“Armët e vogla dhe të lehta”:** NATO mbështet zbatimin e Programit të Veprimit të OKB-së për Parandalimin, Luftimin dhe Çrënjosjen e Tregtisë së Paligjshme të Armëve të Vogla dhe të Lehta (SALW), miratuar në korrik 2001 nga afro 150 vende, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të NATO-s. Aleanca gjithashtu merr pjesë në takimet e ekspertëve të OKB-së dhe në konferencat e rishikimit. Grupi i Punës Ad Hoc i NATO/EAPC për AVL-të dhe Veprimin ndaj Minave ofron një forum kyç për shkëmbimin e informacionit me organizata të tilla si OKB-ja për të përmirësuar koor-

dinimin dhe për të shmangur dyfishimin e punës. Mekanizmi i Fondit të Mirëbesimit të NATO-s u krijua në vitin 1999 për të mbështetur vendet partnere në zbatimin e dispozitave të Konventës së Otavës (e njohur edhe si Konventa e Ndalimit të Minave kundër personelit) dhe tani shtrihet në fusha përfshirë asgjësimin e municioneve, armëve të vogla dhe reformën e mbrojtjes. Për më tepër, NATO mbështet vendet në zbatimin e Traktatit të Tregtisë së Armëve që hyri në fuqi në dhjetor 2014 përmes trajnimit dhe aplikimit të standardeve.

NATO ka punuar gjithashtu ngushtë me agjencitë e OKB-së për të zhvilluar standarde ndërkombëtare për menaxhimin e ciklit jetësor të municioneve, të tilla si Udhëzimet Teknike Ndërkombëtare të Municioneve. NATO ka publikuar udhëzime mbi integrimin gjinor në fushën e AVL-ve bazuar në standardet e zhvilluara nga OKB-ja sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontrollit të Armëve të Vogla dhe Rezolutës 1325. Aleanca gjithashtu përpaket të mbështesë përpjekjet rajonale dhe nën-rajonale me OKB-në dhe partnerët përtej EAPC fushë në menaxhimin e AVL-ve, municioneve dhe mbetjeve shpërthyes të luftës. Në këtë kontekst, NATO zhvilloi disa kapac-

itete përmes Programit të saj “Shkencë për Paqe dhe Siguri”.


**“Ndihamat në raste fatkeqësish”:** NATO gjithashtu bashkëpunon me OKB-në në mbështetje të operacioneve të ndihmës ndaj fatkeqësive. Nëpërmjet Qendrës Euro-Atlantike të Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC), NATO bashkërendon përpjekjet për menaxhimin e pasojave me OKB-në dhe organe të tjera dhe ndan informacione mbi ndihmën për fatkeqësitë. Të gjitha detyrat e EADRCC kryhen në

bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e OKB-së për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (UN OCHA), e cila ruan rolin parësor në koordinimin e operacioneve ndërkombëtare të ndihmës ndaj fatkeqësive. EADRCC është një mekanizëm koordinues rajonal, që mbështet dhe plotëson përpjekjet e OKB-së. Në rastin e një fatkeqësie që kërkon ndihmë ndërkombëtare, i takon vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s që të vendosin nëse do të ofrojnë ndihmë, bazuar në informacionin e marrë nga EADRCC.



**NATO DHE KOMBET E BASHKUARA U  
THEMELUAN TË DYJA NË VITET 1940, PAS  
LUFTËS SË DYTË BOTËRORE, PËR TË RUAJTUR  
PAQEN DHE SIGURINË. TRAKTATI I ATLANTIKUT  
TË VERIUT I NATO-S VEPRON BRENDË KORNIZËS  
SË KARTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA,  
PËRFSHIRË NENIN 51, I CILI PËRCAKTON  
TË DREJTËN E NATYRSHME TË MBROJTJES  
INDIVIDUALE OSE KOLEKTIVE TË TË GJITHA  
VENDEVE ANËTARE TË OKB-së.**





# Gruaja në politikë, roli dhe rëndësia e saj

## Rrugëtimi politik i grave në Shqipërinë e pas viteve '90

Shqipëria pas viteve '90 ndikoi edhe në pozitat e gruas në politikë. Megjithatë, çështjet e barazisë gjinore janë të hershme, së paku që nga rendi skllavopronar deri në ditët tona. Historia e njerëzimit është histori qytetërimesh të sunduara thuajse tërësisht nga burrat. Me fillimin e rendit modern, pushteti ekonomik e politik vazhdoi të ishte i përqendruar në duart e burrave, por me përfaqësim më të madh të vajzave dhe grave, kjo për shkak të rritjes së shkallës së mekanizimit dhe të automatizimit të proceseve të punës. Ndërkohë që roli i vajzave dhe grave është rritur shumë në jetën shoqërore, kulturore, ekonomike etj., roli i tyre në strukturat politike vendimmarrëse,

thuajse në të gjithë botën mbetet në nivel të ulët. Rritja e rolit aktiv të vajzave dhe grave në jetën politike të të gjitha niveleve ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga përparësitë kryesore të rrymave feministe, po ashtu të organizmave ndërkombëtarë që ndërveprojnë në shoqërinë moderne e postmoderne. Nëse çështjen e barazisë gjinore e vendosim në kontekstin e shoqërisë shqiptare, sfidat janë më të mprehta. Fillimi i viteve '90 në Shqipëri shërben si ndarje "epokash", rrëzimi i sistemit socialist totalitar dhe instalimi i atij demokratik. Rrugëtimi politik, institucional i vajzave dhe grave në këtë periudhë është ndeshur me pengesa të karakterit formal por edhe informal, siç janë mentaliteti patriarkal dhe paragjykimet. Çështja e shumë diskutuar e kuotave

të përfaqësimit për to, mbetet një kusht i vazhdueshëm nga organizmat ndërkombëtarë, për anëtarësimin e Shqipërisë në strukturat e Bashkimit Evropian.

### **Barazia gjinore në përfaqësimin politik**

Barazia gjinore në politikë, si edhe në fushat e tjera të veprimtarisë shoqërore, është një e drejtë themelore. Në arritjen dhe respektimin e barazisë gjinore qëndrojnë potencialet më të mëdha të shoqërisë, kjo arritje, numerikisht përkon edhe me gjysmën e popullsisë botërore. Studime të shumta me karakter social e vënë theksin te nevoja e ngutshme që barazia gjinore në politikë të bëhet një realitet i prekshëm. Në vendet ish-socialiste burrat kanë në duart e tyre majat e hierarkisë të shumicës dërrmuese të partive politike, e përgjithësisht përpiqen t'i reduktojnë problemet më të rëndësishme që shqetësojnë vajzat dhe gratë.

### **Paragjykimet, pengesë për angazhim politik**

Mjedisi përreth vajzave dhe grave karakterizohet nga një mjegull e dendur paragjykimesh. Etiketime të tilla si: "gra të pamoralshme"; "gra që shkatërrojnë familjen", "gra, që nëpërmjet favoreve seksuale përfitojnë pozita të larta në hierarkinë politike", shpeshherë bëhen pengesë për angazhimin politik të tyre. Në shoqërinë shqiptare është përhapur gjerësisht mendësia se femrat duhet të përgatiten për profesione rutinë, të cilat mund të ushtrohen pa shumë sforcim krijues. Në një klimë të tillë psikologjike, politika si një profesion që kërkon shumë energji krijuese konsiderohet e papërshtatshme.

### **Fuqizimi politik i grave, tregues i zhvillimit demokratik**

Studiuesit kanë propozuar shpjegime që përqendrohen në qëndrimet tradicionale të qytetarëve kundrejt roleve gjinore dhe klimës së përgjithshme ndaj barazisë gjinore në një vend të caktuar. Mungesa e grave në poste partiake është pa diskutim problematike për nocionin e demokracisë. Konkretisht, koncepti i demokracisë përfaqësuese specifikon se një "organ përfaqësues duhet të pasqyrojë/reflektojë diversitetin e elektoratit dhe deputetët zgjidhen nga "zgjedhësit e tyre dhe janë përgjegjës ndaj tyre". Kështu, një legjislaturë e dominuar nga meshkujt natyrisht nuk pasqyron përbërjen gjinore të shoqërisë në përgjithësi.

Arsyet kryesore pse gjithmonë vendoset theksi mbi pjesëmarrjen e femrave në politikë, e mbi të gjitha në parlament, janë të shumta. Së pari, mundësia e barabartë për pjesëmarrje është e drejtë e gjithsecilit. Përveç kësaj, studimet tregojnë se shtetet ku më pak se 30% të vendeve në parlament mbahen nga

femrat janë më pak demokratike dhe më shumë diskriminuese. Shqipëria përfaqësimin më të lartë të grave në parlament e ka arritur në zgjedhjet e 2009, Presion të vazhdueshëm kanë bërë edhe organizmat ndërkombëtarë që ndërveprojnë në vend, si një kusht për anëtarësim në strukturat e Bashkimit Evropian.

Edhe pse ka një progres të ngritjes femërore në shoqëri, gjithnjë e më shumë vajzat dhe gratë janë të suksesshme në karrierë, fusha politike mbetet e vështirë dhe me risk të madh. Zhvillimi demokratik në Shqipëri është i brishtë, grupe të ndryshme të shoqërisë civile llobojnë që nuk ka demokraci të mirëfilltë. Tranzicioni i stërzgatur po i lodh qytetarët dhe duket sikur s'do përfundojë kurrë, besimi tek institucionet gjithnjë në rënie, mbetet si alternativë fuqizimi i të rinjve dhe grave.

Ekziston një lidhje e dobët ndërmjet shtetit dhe shoqërisë civile, duke e bërë zbatimin e ligjeve në praktikë më të vështirë. Duhet theksuar se faktori bazë për ngritjen e infrastrukturës ligjore dhe asaj praktike mbetet vullneti politik.

Për të arritur ëndrrën e kahershme të shqiptarëve, anëtarësimin në Bashkimin Evropian, krahas luftës për korrupsionin dhe krimin e organizuar, duhet t'i jepet rëndësi edhe politikave konkrete për fuqizimin e vajzave dhe grave. Në këtë mënyrë diferencat e mëdha gjinore do të zbuteshin, marrëdhëniet familjare do të ishin më të qëndrueshme, rrjedhimisht marrëdhëniet shoqërore do të ishin më të stabilizuara.





**NORA E KELMENDIT,**  
**gruaja e fuqishme**  
**shndërruar në legjendë**

**H**istoria e shek. XVII për Norën e Kelmendit tashmë është shndërruar në legjendë për bukurinë dhe trimërinë e saj. E cilësuar si Helena e Shqipërisë për bukurinë si dhe për faktin që shkaktoi një luftë të madhe mes fisit Kelmendi dhe Perandorisë Osmane, konflikt që zgjati mbi një dekadë.

Nora e Kelmendit, e refuzuar nga babai i saj, për faktin që kishte lindur vajzë, dhe për të nuk ishte e dobishme në luftën kundër pushuesit, atë e mori dhe e rriti e halla e saj, si një djalë të adoptuar.

I ati i Norës nga dëshira për ta trajnuar e për ta bërë luftëtar dhe duke menduar që ky ishte djali i adoptuar i të motrës, vendosi ta trajnojë si luftëtar, pa e ditur që po trajnonte të bijën e vet.

Kur Nora u rrit, ajo u bë vajza më e bukur e Malësisë. Thuhej se ajo ishte aq e bukur sa një Zanë e vërtetë mali. Fama e bukurisë së saj u përhap nëpër tërë vendin. Një pasha që banonte në Rozafat të Shkodrës, dëgjoi për të.

Një ditë, Nora zbriti në qytet me prindërit e saj. E pashai doli nga kalaja dhe ra në dashuri me Norën sapo ia vuri sytë. Duke qenë nga Bosnja, e cila ka tradita të ngjashme me ato të Shqipërisë, pashai donte të martohej me ligjet shqiptare të Kanunit, që do të thoshte se ai do të dërgonte një njeri të besuar te shtëpia e Norës e të kërkonte dorën e saj.

Megjithatë, familja e Norës u përgjigj se Kanuni shqiptar nuk i lejon martesat e vajzave me jo-shqiptarë. E pashai nuk ishte e mësuar me të tilla refuzime dhe ndërkaq mbante një harem të madh. Ai turfulloi: “Ose Nora do të bëhet gruaja ime, ose unë do ta djeg gjithë Malësinë e do e bëj shkumb e hi.”

Pashai pastaj udhëhoqi ushtrinë e tij dhe e rrethoi Malësinë. Nora kishte provuar të ishte luftëtare, por tani ajo kishte për detyrë të provonte se ishte edhe e mençur, dhe për këtë duhet të kursente Malësinë nga shkatërrimi. Kështu që ajo hartoi një plan për të vrarë pashain boshnjak.

#### **Ka dy versione të ngjarjes**

Në versionin e parë, Nora pretendon se do të martohet me pashain pa lejen e familjes së saj. E veshur me xhubletë, ajo shkon në çadrën e pashait. Pashai, sapo sheh Norën, bie në gjunjë dhe filloi të lutet, duke besuar se Nora ishte një dhuratë e vërtetë nga Allahu i Plotfuqishëm për shërbimet e tij për Atë.

Pashai urdhëron trupat e tij të pushojnë dhe të përgatiten për t’u kthyer në Shkodër. Kur çdo gjë ishte e qetë rreth tendës së pashait, Nora nxjerr kamën që babai i saj i kishte dhënë me vete, kamë që ishte e përcjellë nëpër shumë breza të familjes, dhe ia ngul atë pashait, e shkelmon në pjesën e pasme të kokës, dhe ia zë frymën, kështu që ai nuk mund të bërtiste. Pasi bie pashai përtokë, Nora nuk e godet më pashain, pasi që për shqiptarin është turp ta godasë dikë që nuk është në këmbë, dhe për këtë pashai i shpëton plagëve të marra.

#### **Në një version të dytë të legjendës...**

Nora nuk shkon në tendë. Kur ushtritë luftojnë, disa nga Osmanët shpëputen nga trupi i ushtrisë për të sulmuar fshatrat. Nora udhëheq një ushtri prej 300 grash kundër Osmanëve që ishin duke djegur, plaçkitur e dhunuar, i del përpara pashait

dhe e vret në një duel. Mbi luftën heroike të burrave dhe grave të Kelmendit hedh dritë jo vetëm tradita e pasur popullore por dhe mjaft autorë të huaj dhe vendas, të cilët flasin me admirim për trimërinë dhe vetëmohimin e rrallë të bijve të Kelmendit në këto beteja të pabarabarta. Nora me shoqet e saj të fshehura në shkrepat e thepisura malore, duke përdorur drurët e pishave si leva, rrokullisin gurë e shkëmbinj mbi kokat e turqve, duke u mbyllur rrugët e kalimit.

Por megjithatë hordhitë e shumta turke të Vuce pashës edhe pse përgjysmoheshin, ishin aq të shumta sa sikur mbinin nga dheu. Të shumë ishin burrat dhe gratë e Kelmendit që dolën vullnetarë për vrasjen e Vuce pashës, po Nora kërkoi me këmbëngulje që t’i besohej asaj kjo detyrë. Mbas shumë diskutimesh, kuvendi pranoi t’ia plotësojë këtë dëshirë Norës. Dhe rasti erdhi. Kuvendi i kelmendasve, në përgjigje të kërkesës së Vuce pashës, pranoi propozimin e turqve për të arritur në marrëveshje në qoftë se Vuce pasha do të pranonte disa kushte. Si ndërmjetëse për bashkëbisedim kelmendasit dërguan në shtabin e tyre, Norën. Ata e porositën Norën të tregohej shumë e zgjuar, se kishte të bënte me një pasha dinak, aq shumë i përmendur për kurthe dhe intriga, që nuk di çfarë është besa, fjala e dhënë e shqiptarit. Këta trima i kujtuan Norës vrasjen e pabesë, mbas shpine të përfaqësuesve të Kelmendit para një viti nga Vuce pasha, i cili jo vetëm nuk i qëndroi fjalës së dhënë për bashkëbisedim me këta malësorë, por me të arritur këta trima në shtabin e tij, urdhëroi menjëherë masakrimin e tyre.

Trimëresha e zgjuar, Nora, e shoqëruar dhe me dy nga trimat më të rinj të kësaj krahine, u nis kaluar drejt shtabit të armikut.

Vuce pasha i priti në çadrën e tij. Ky komandant dinak i sulltanit, gjatë bisedës me këtë përfaqësuese të Kelmendit mbeti gojëhapur nga bukuria mahnitëse e Norës. Ai i pranoi të gjitha kushtet e kryengritësve, mjaftonte që kjo shqiponjë mali të bëhej gruaja e tij dhe u ngrit në këmbë e iu afrua Norës. Ajo me shpejtësi si rrufeja nxori kurqelin (një lloj thike që e mbajnë vajzat për të ruajtur nderin) dhe ia nguli përnjëherësh në zemër pashait të madh osmanli, duke i drejtuar këto fjalë:

“Po të martoj, o pashë më parë me vdekjen” dhe së bashku me shoqëruesit e saj u largua drejt maleve, duke e lënë të shtrirë të mbytur në gjak këtë tiran dinak.

Vdekja e pashait osmanli u përhap si rrufe anembanë vendit. Shtabi i armikut i tmerruar nga kjo ngjarje e papritur dhe nga humbjet që pësonte vazhdimisht urdhëroi tërheqjen sa më parë të forcave osmane nga Kelmendi, ndërsa malësorët i ndoqën ato këmba-këmbës.

Sipas gojëdhënave: në këtë betejë malore të pabarabartë, forcat kelmendase kishin gjithsej 900 luftëtarë. Ata me trimërinë, me zgjuarsinë dhe me taktikën e tyre luftarake mundën të shfarosin gjashtë mijë ushtarë turq.

Beteja e Kelmendit kundër osmanlinjve gjatë vitit 1638 përfundoi me fitoren e shqiptarëve. Një pjesë e mirë e kësaj fitoreje erdhi edhe nga lufta e denjë e grave dhe e vajzave të Kelmendit me në krye sokoleshën Nora.

## TE JESH GRUA

# ‘Teutat’ shqiptare, entiteti i një kombi

“Familja, atdheu i vogël, ku hedh rrënjë kombi, ndërtohet nga të dy gjinitë, ...kur burri dhe gruaja do të dinë ta vlerësojnë njëri-tjetrin për atë që është në gjendje të bëjë e të arrijë secili segment i shoqërisë, do të kemi një familje të bukur, një shoqëri kompakte e pa smirë, një shtet më të konsoliduar dhe një komb të integruar...”, Vivra. Shoqërinë njerëzore e bëjnë dy segmente: burra dhe gra, ku kjo e dyta sipas statistikave, zë vendin e parë, me më se 51% të numrit të të gjithë popullsisë së globit tokësor.

Ky segment vital, qeliza e njerëzimit, nga i cili lind e bukura “JETA”, ka dhënë, jep dhe do të japë vlera në shoqëri. Është gruaja që ka dhënë burra të aftë që kanë drejtuar dhe drejtojnë perandori, shtete, organizma kombëtare dhe ndërkombëtare në të gjitha fushat si në organet e larta presidenciale, legjislative, juridike, ekzekutive, si dhe në shkencë, ekonomi, drejtësi, arsim, kulturë, shëndetësi, ushtri etj.... Edhe pse të pavlerësuara si e sa duhet, si dhe në kushte pabarazie gjinore, megjithatë janë në një numër të konsiderueshëm gratë që janë ndërtuese të shoqërisë, me të njëjtat vlera si dhe meshkujt.

Kurrë s’duhet harruar se gjatë historisë ka pasur shumë vajza të reja, bashkëshorte, nëna, që me punën e tyre, bazuar në intelekt, arsim, profesion, kurajë, guxim e vetëmohim, janë bërë shembuj virtyti që kanë dhënë vlera të njëjta apo dhe më të avancuara sesa meshkujt. Në këtë mënyrë ato kanë krijuar modele që duhen ndjekur nga bashkëkohësit apo të merren si nxitje për të thyer konceptet patriarkale të shoqërisë njerëzore.

Në kërkim të modeleve të grave që patën guxim për të sfiduar kohën dhe mentalitetin, për gjetjen e atyre zonjave që thyen tabu dhe korniza shumë të ngurta, të vendosura padrejtësisht ndaj tyre nga politikat e mbrapshta, ka pasur në çdo kohë.



Një fjalë e urtë thotë: “Po të kërkosh, gjen.” Në Shqipëri ka shumë modele grash që me guxim, kanë thyer rregullat strikte dhe patriarkale të mesjetës. Ato dolën kundër kohëve të egra që mohonin ekzistencën e saj si një segment vlerash. Them me bindje se Elitat dolën nga kornizat e rregullave të ngurta

të shoqërisë, duke sfiduar kohën dhe pushtetet despotike. Me vlerat e tyre të pamohueshme, jo vetëm kanë luftuar gjatë shekujve për të çliruar vendin, por hodhën themele të reja për një shoqëri të re dhe hapën rrugën e qytetërimit. Këto zonja jetuan e punuan në periudha të ndryshme historike, që me guxim e mençuri u ngritën kundër çdo lloj shtypjeje, dhune dhe tutele, që ishin tregues të lënies së tyre në injorancë, varfëri mendore dhe vartësi ekonomike. Një gjendje e tillë e gruas, me mungesë të theksuar lirie, që ishte për të dëshiruar, përherë ka karakterizuar ndërgjegjen tonë kombëtare në nivele tejet të ulëta. Dua të veçoj e të vë në dukje ato gra intelektuale që u ngritën me forcë kundër shtypjes, dhunës, indiferentizmit gjinor, mohimit dhe hapën rrugën për një të ardhme ndryshe, ku femra të mos ndihet inferiore. Këto zonja vitale me shembullin e tyre ia rritën famën dhe vlerat vendit që i lindi e i rriti, duke e vënë kombin mbi gjithçka tjetër, shumë syresh rritën prestigjin e këtij segmenti të bukur dhe të pazëvendësueshëm. Synimi i zonjave që kanë dalë nismëtare, ka qenë luftë kundër zakoneve e mentalitetit patriarkal të Mesjetës, nëpërmjet arsimit të tyre, rritjes së nivelit kulturor, pjesëmarrjes së gruas me të drejta të barabarta dhe në kushte të njëjta me burrat në çdo fushë të jetës, pse jo edhe në drejtim. Elitat gra janë vlera që duhen nxitur apo inkurajuar nga shteti me institucionet e tij. Familja, atdheu i vogël, ku hedh rrënjë kombi,

ndërtohet nga të dy gjinitë, nga burri dhe gruaja, por emrin e mbajtjes së familjes, namin e mirë apo famën tek ne, e merr burri. Pse? Ata paskan të drejtë të ndihen të përkushtuar?! Jo. Këtë pseudo sakrificë e bëjnë vetëm për ego, për mentalitet dhe për të treguar se “pa burrat nuk rritet fëmija, nuk mbahet familja, madje edhe kombet nuk zhvillohen pa pasur në krye burra shteti”. Arti gojor i popullit tonë të lashtë u transmeton brezave: “Njëra dorë lanë tjetrën, të dyja lajnë fytyrën!”, kjo thënie është më se e duhura dhe tejet e spikatur për këtë rast. Sepse kur të dy gjinitë do të dinë ta vlerësojnë njëri-tjetrin për atë që është në gjendje të bëjë e të arrijë secili segment, do të kemi një familje të bukur, një shoqëri kompakte e pa smirë, një shtet më të konsoliduar dhe një komb të integruar. Natyrisht këto gra që i ka nxjerrë koha, me vrazhdësinë e saj, të cilat qëndrojnë më lart se të tjerat, pavarësisht nga bindjet politike që ka secila, kanë nevojë për mbështetjen e institucioneve të larta shtetërore, duke nisur që nga Kryeministri, Qeveria, gjithë pushteti qendror dhe ai që do t'i spikat i pari këto vlera, duhet të jetë pushteti lokal. Gra të tilla, që meritojnë të quhen “ELITA” i treguan botës se, ekzistenca e shoqërisë njerëzore nuk mund të jetë e njëanshme, as vetëm mashkullore dhe as vetëm femërore, por mundësohet nga dy segmente, femra dhe meshkuj. Pyes: “Si mund ta mohojnë atë të vërtetë të madhe se, nga gruaja lindën burrat e shteteve, në




duart e të cilëve është luajtur e luhet politika, diplomacia botërore, drejtësia dhe fatet e kombeve të mëdhenj apo të vegjël?” Gra të tilla, veç të qenit bija të denja, bashkëshorte besnike dhe nëna apo gjyshe shembullore, por duke sjellë progres në shoqëri në fusha të ndryshme të jetës, kanë fituar disi lirinë vetjake. Si individ, unë jam kundër lirisë pa kufi që shtrembëron e përdhos nocionin e kësaj fjale të bukur, fisnike, të vyer dhe të pazëvendësueshme. Jam për atë liri që individit, në rastin tonë, gruas i jep mundësinë për të qenë vetvetja dhe si e tillë, është vlerë kombëtare. “Tribuna Shqiptare”, 7 mars 2014, - Vivra, “Gruaja shqiptare në shekuj”: Historia e kombeve është zhvilluar sipas epokave historike, politike, ekonomike dhe sociale që, në tërësi bëjnë historinë e një kombi. Historinë e vërtetë e bënë njerëzimi me bëmat e tij, vetëm atëherë kur të dalin në pah vlerat e rralla të njerëzve të shquar. Meqë gratë dhe burrat bashkëudhëtojnë, duhen pasur parasysht vlerat reale që ka dhënë çdo segment i shoqërisë në historinë e kombit. Zakonisht politikat e politikanët më tepër i kanë prishur dhe i prishin punë, se sa i japin vlerat e duhura gruas, këtij segmenti të rëndësishëm e të pamohueshëm në jetën politiko-social-ekonomiko-kulturore të kombit. Njëanshmëria e këtij mentaliteti do të ekzistojë për sa kohë të ketë pabarazi gjinore. Madje ky qëndrim do të jetë edhe pasi të mënjanohet mentaliteti patriarkal dhe të pranohet se femra ka të njëjtin potencial intelektual e profesional, si burrat. Pikërisht për këtë diferencim gjinor, duhet të vlerësohen veprimtaria, arritjet dhe sfidat e gruas në çdo epokë historike. Çdo epokë ka përfaqësuesit e shquar të shoqërisë. Ashtu si shumë meshkuj që janë shembuj virtyti e trimërie, si mbretërit ilirë, si: Bato, Pleurati, Monuni, Mytili, Pirro i Epirit, Genti, Agroni. Aleksandri i Madh, më vonë Gjergj Arianiti, Skënderbeu dhe Ismail Qemali, ka edhe mjaft gra të shquara. Theksoj se qysh në lashtësi, gruaja ka mbajtur peshën e familjes e të të gjithë shoqërisë. Gratë ilire merrnin pjesë në kuvende dhe herë-herë u dëgjohej fjala më shumë se sa burrave. Një vlerësim të tillë për femrën e përmban edhe Kanuni i Lek Dukagjinit. Si heroizmat e pashoqe të burrave trima, të tilla drithëruese dhe vetëmohuese, janë legjendat edhe për gratë trimëresha. Shembuj të tillë ka plot. Pas vdekjes së Agronit, drejtimin e shtetit Ardian e mori mbretëresha Teuta, e cila diti t’i udhëheqë ilirët nga beteja në betejë, në luftën e drejtë dhe çlirimtare ndaj romakëve. Teuta u shqua si një stratege e zonja që e nxori popullin e vet nga situata të vështira ndërluftuese, jo shaka por me një Perandori që ishte sundimtare e botës. Kjo u tregoi ilirëve dhe botës se edhe një grua është e aftë të drejtojë si çdo burrë. Shembuj vitaliteti e besnikërie ishin gratë ilire që luftonin përkrahë burrave. Në kohën që ata ishin në luftë, gratë jo vetëm drejtonin familjen, ekonominë, rrisnin dhe edukonin fëmijët për t’u bërë luftëtarë të zotë, por drejtonin e mbronin edhe pronën e tyre. Pra rrjedhat e kohës nxorën, jo vetëm burra por edhe gra

të famshme. Sa e sa gra atdhetare ia kanë rritur emrin Shqipërisë iliro-pellazge. Ato, në çaste vendimtare për atdheun e tyre, i dhanë emër vetes, kanë mbijetuar me armë në dorë ose kanë vdekur me nder. Shembuj të tillë, janë 6000 gra dhe vasha që dolën malit për çlirimin e Shqipërisë, e cila u përfshi në Luftën e Dytë Botërore. Veç tyre ka dhe nga ato zonja me kuptimin e vërtetë të fjalës, që me bëmat e tyre janë shndërruar në legjenda, si: Doruntina e Vranajve, të cilën e thirri zëri i tokës mëmë. Legjendat e Gjergj Elez Alisë dhe të Mujës e Halilit, që veç trimërisë së pashoqe tregojnë besën e shqiptarit. Rozafa e flijuar, që muret e kështjellës së Shkodrës të mos binin, duke lënë jetim fëmijën në gji. Argjiroja, e cila për të mos rënë në duart e pushtuesve, u hodh nga muret e kalasë së Gjirokastrës. Mbretëresha Teutë, gratë e Sopotit, gratë e Pargës, apo suljetet në vallen e vdekjes, përjetësuar nga piktori Ari Shefer, në pikturën “Gratë e Sulit”.

### Maro Konda

Kujt mund t’ia merrte mendja se nusja e re nga bregu i pruar i Jonit do të bënte epokë, që u vetëflijua, duke u hedhur nga shkëmbi dhe tërhoqi në greminë pas vetes, turqit e lidhur me litar njëri pas-tjetrit. Pas njohjes së vitalitetit dhe karakterit të gruas shqiptare, i kanë përjetësuar në vepra letrare, kurse Akademikja



franceze, Margaret Jursenar në tregimin “Qumështi i vdekjes” u bazua në legjendën e murosjes së Rozafës, nënës së re që u flijua nën gurët e kalasë. Ka vënë në gojë e një personazhi të entuziazmuar nga legjenda e Rozafës, i cili u shpreh: “Ama për nënë do të doja të kisha një vashë si ajo e legjendës shqiptare”. Kujtojmë dy princeshat e Kaninës:

### **Rugjina Balsha**

Rugjina Balsha, e cila në shek. e XIV bëri epokë, duke luftuar dhe udhëhequr luftëtarët si burrë. Pasi aleatët ia mohuan ndihmën, nuk fitoi, por as nuk iu dorëzua pushtuesve osmanë. Ajo me trimat e saj migroi në Korfuz, ku vdiq me sytë nga brigjet shqiptare.

### **Donika Arianit Kastrioti**

Donika Arianit Kastrioti, e cila ishte e denjë për t’u kurorëzuar Mbretëreshë e Arbërisë, titull që e mbajti me nder edhe pas vdekjes së Skënderbeut. Si Donika dhe e motra, Shën Angelina, dy vajzat e Princit të Kaninës, Gjergj Arianiti rritën emrin e tyre, të të atit dhe të Arbërisë. Donika Kastrioti jetoi jo pak po 32-33 vite në oborret e Napolit, Venedikut me dinjitet mbretëreshë. Deri në vdekjen e saj, në fillim të shek. XVI ajo nuk reshti së ndihmuari shqiptarët nga mërgimi ku jetonte.

### **Elena Lukrecia Peshkopia**

Elena Peshkopia, e para grua në botë që mori doktoraturën në Filozofi. Programin e doktoraturës e ndoqi në Universitetin e Padovës (Itali). Ajo për doktoraturë mbrojti teoritë e saj, sipas babait të Filozofisë, Aristotelit, më 25 qershor 1678 para profesorëve të filozofisë, astronomisë, logjikës, mjekësisë dhe teologjisë, në Universitetin “Vassar” të Nju Jorkut në SHBA.



Aty para katedrës, Elena është portretizuar, duke mbrojtur tezat e saj mbi Aristotelin. Portreti i saj është në dritaren e qelqit rreth 7m i lartë, në bibliotekën “Frederick Ferris Thomson”, në Universitetin “Vassar”. Gjithashtu ky portret që ngre në pedestal gruan shqiptare, gjendet edhe në shumë universitete të Europës.



# DATA DHE NGJARJE


## 66 vjet Shërbimi Hidrografik Shqiptar...

Më 25 shtator 2023, kujtuam me respekt dhe përulje personelin e parë të Shërbimit Hidrografik Shqiptar, si ndër më të kualifikuarit e arsimuarit të Flotës-Luftarake Detare të asaj kohe, të cilët më 25 shtator të vitit 1957, plot 66 vjet më parë, krijuan Shërbimin Hidrografik Shqiptar, si një domosdoshmëri për sigurimin hidrolundrimor të anijeve brenda ujërave tona territoriale:

- Komandantin, Kapiten i Rangut II, Arqile PAPADHIMITRI,
- Kapiten i Rangut III, Kiço LATI, zëvendëskomandant,
- Shefin e Seksionit të Hidrografisë, Kapiten i Rangut III Mersin SHQYPI
- Shefin e sinjalistikës detare (fenerëve), Kapiten Teufik DIGLI
- Shefin e Sinoptikës, Kapiten Seit BERISHA.

Natyrisht gjurmë të këtij shërbimi gjejmë dhe më parë, që në vitet 1878-1890, kur specialistë të Perandorisë Austro-Hungareze përpunuan hartat e para të vendit, të cilat u përmirësuan nga specialistë italianë në vitet 1938-1941. Gjithashtu ata vendosën disa faro-fenerë në pozicionet kryesore të bregdetit shqiptar.

Në këtë ditë përulemi me respekt para ish-komandantëve, hidrografëve, gjeodetëve, kartografëve, specialistëve të sigurisë hidro-lundrimore dhe efektivave të mjeteve lundruese, Atyre që kanë shërbyer dhe atyre që vazhdojnë të shërbejnë:



duhet të ndjeheni krenarë për punën dhe veprën tuaj në vite për realizimin e misionit dhe detyrave dhe gjithçka tjetër e ndërtuar nga profesionalizmi në funksion të sigurisë për jetën e lundërtarëve dhe sigurisë hidrolundrimore në bregdetin Shqiptar.

Gjatë kësaj periudhe, specialistët Hidrografë të SHHSH, bazuar nga të dhënat e matjeve batimerike të bëra me partnerët tanë ndërkombëtarë, në bashkëpunim me specialistë të IGJIU-së, u prodhuan hartat e para "Paper charts", për qëllime



lundrimore. Për herë të parë në procesin e prodhimit të këtyre hartave u aplikuan standardet ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare Hidrografike (IHO-s). Kjo është dëshmi e rritjes së vetëdijes për rëndësinë që ka vetë Hidrografia dhe hartografimi detar, kontributin e saj në menaxhimin e duhur të “ekonomisë blu” si dhe varësisë njerëzore ndaj këtij ambienti që është vazhdimisht çdo ditë e në rritje.

Hidrografia dhe hartografimi detar, tashmë konsiderohen nga ne, si elementë thelbësorë në zhvillimin e infrastrukturës kombëtare për detin, kjo infrastrukturë përfshin, jo vetëm portet e transportin detar, por edhe shfrytëzimin e resurseve (pasurive mbi/nën detare) si dhe mbrojtjen e jetës njerëzore, mjedisit e ekologjisë detare.

Projekti i përbashkët me Shërbimin Hidrografik Norvegjez (ALNO-HIP), i cili u realizua me sukses sipas një plani të mirë-detajuar, ku në themel të tij kishte zhvillimin e një politike kombëtare detare për Hidrografinë dhe Hartografimin, kërkoi që krahas njohurive esenciale të karakter-

istikave gjeografike, gjeologjike, gjeofizike të shtratit të detit, të bregdetit, grumbullimin e të dhënave të mjaftueshme për rrymat detare, baticë-zbaticat e fenomenet e tjera detare, deri në përpunimin përfundimtar të këtyre të dhënave, të realizonte edhe përshtatjen e teknologjisë ekzistuese me teknologjinë moderne bashkëkohore, apo përzgjedhjen e personelit të duhur për specialitetin e hidrografisë.

Mbështetja e pakursyer e Komandës dhe Shtabit të Forcës Detare, bëri të mundur implementimin e këtij projekti, duke u prezantuar si partnerë seriozë në marrëdhënie dypalëshe me Shërbimin Hidrografik Norvegjez.

#### **Disa realizime gjatë vitit 2023**

Viti 2023, mund të quhet edhe viti i Shërbimit Hidrografik Shqiptar.

Pas anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë (IHO), dhe në Organizatën Ndërkombëtare të Ndihmës në Lundrim (IALA), Shqipëria bëhet anëtare me të drejta të plota në Komisionin e detit Mesdhe dhe Detin e Zi (Mediterranean and Black Seas Hydrographic Commission - MBSHC). Tashmë jemi pjesë e ven-

dimmarrjeve në rajonin tonë.

Të qenit pjesë si anëtarë me të drejta të plota në këto Organizata Ndërkombëtare dhe Komisione, i sjell vendit tonë një sërë përfitimesh si:

Anëtarësimi i Shqipërisë në IHO, e rreshton vendin tonë në krah të vendeve me standarde të larta në fushën e hidrografisë. Një shtet detar pa kapacitete hidrografike nuk ka një pozicion të favorshëm për të përfituar nga asetet dhe burimet e saj detare. Nëpërmjet anëtarësimit në IHO, vendi ynë krijon mundësinë e një zhvillimi të qëndrueshëm në fushën e hidrografisë, e cila ka ndikim në ekonominë e vendit.

Nëpërmjet anëtarësimit, personel nga Shërbimi Hidrografik, ka përfituar shkollim (trajnim) falas për kryerjen e operacioneve të rilevimit, përdorimin e pajisjeve teknike. Organizata ofron shkollim falas edhe në drejtim të njohurive të veçanta siç është kartografia në funksion të prodhimit të hartave detare apo të delimitimit të kufijve detarë në kuadrin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit. IHO ndihmon shtetet

që të rrisin aftësitë e tyre hidrografike ose të vendosin një aftësi të tillë aty ku nuk ekziston. Shqipëria duhet të marrë një rol aktiv në këto organizata, për të qenë dhe përfutuese e projekteve, trajnimeve dhe financimeve të rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve hidrografike.

Shërbimi Hidrografik Shqiptar dhe Forca Detare, në tërësi kanë një rol parësor në sigurimin e tregtisë detare. Produktet dhe shërbimet hidrografike si hartat, udhëzuesit e lundrimit, vjetarët dhe lista e fenerëve, janë të domosdoshëm për njohjen e mjedisit detar, kryerjen e lundrimeve të sigurta dhe zvogëlimin e mundësisë për fatkeqësi detare.

Anëtarësimi në një Organizatë Ndërkombëtare, i jep Shqipërisë mundësinë për të marrë pjesë në një forum tjetër ndërkombëtar. Megjithatë teknik, pjesëmarrja në

të përcaktuara dhe pranuar ndërkombëtarisht.

Komisioni Hidrografik i Detit Mesdhe dhe Detit të Zi, kryen një funksion mjaft të rëndësishëm, pasi aty diskutohen dhe merren vendime, që kanë të bëjnë me çështjet hidrografike në rajonin ku vendi ynë bën pjesë. Puna e këtij komisioni konsiston gjithashtu në nxitjen e gjetjes së zgjidhjeve në rastet e mosmarrëveshjeve mes vendeve anëtare në lidhje me kufijtë detarë dhe pasqyrimin e tyre në hartat detare (në nivel teknik), duke shmangur mbivendosjet dhe përcaktuar saktë zonat e përgjegjësisë. Puna e komisionit ndër të tjera konsiston në koordinimin rajonal mes vendeve anëtare për fushatat e matjeve batimetrike, prodhimin e hartave detare, trajnimin dhe projektet e ngritjes së kapaciteteve.



këtë forum dhe bashkëpunimi teknik dy apo shumë-palësh, mund të shërbejë si një kanal komunikimi për thellimin e një bashkëpunimi politik.

Anëtarësimi në IALA, do të bëjë të mundur që Shqipëria të operojë në fushën e sigurisë lundimore në bazë të standardeve

Sigurimi i lundrimit efektiv dhe të pa rrezikshëm në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet mbajtjes të hartografuar të hapësirës detare dhe efikasitetit të sistemit faro-fener, mbeten sfidat tona për të ardhmen. Prioritetet specifike të dedikuara të punës

tonë në vazhdim do të jenë gjithashtu: Përpilimi dhe publikimi i hartave të reja detare (paper charts & elektronike) të bregdetit Shqiptar; Pajisja e bregdetit Shqiptar, me mjete dhe pajisje bashkëkohore të sigurisë hidro-lundimore si dhe instalimi i fenerëve të rinj detarë, duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e atyre ekzistuese; Ndjekja e konferencave dhe seminareve të organizuara nga Organizata Hidrografike Ndërkombëtare (International Hydrographic Organization (IHO), Organizata Ndërkombëtare e Ndihmës në Lundrim (International Hydrographic Organization (IALA) dhe nga Komisionet Hidrografike të Detit të Zi dhe Detit Mesdhe (Mediterranean and Black Seas Hydrographic Commission (MBSHC), nga ku Shërbimi Hidrografik Shqiptar mund të përfitojë asistencë tekniko-operative dhe trajnime; Sigurimi i koordinimit të vazhdueshëm me IHO, IALA, pas anëtarësimit të vendit tonë me të drejta të plota në këto organizata si dhe me Komisionin për Detin Mesdhe dhe Detin e Zi, (Mediterranean and Black Seas Hydrographic Commission - MBSHC); Përcaktimi i qartë i bazës ligjore mbi të cilën funksionon Shërbimi Hidrografik Shqiptar, nisur pas anëtarësimit në IHO dhe IALA. Riformulimi i akteve ligjore për mënyrën e pagesës të taksës së sinjalistikës detare në favor të Shërbimit Hidrografik/Forca Detare, si institucioni ligjor dhe përgjegjës për krijimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sinjalistikës detare si dhe krijimi i bazës ligjore dhe përcaktimi i një liste çmimesh për shërbimet dhe punimet që ofrohen nga Shërbimi Hidrografik Shqiptar për palët e interesuara.

Në mënyrë të vazhdueshme nga ana jonë, përgatiten publikime dhe njoftime për lundëtarët, në bashkëpunim me IGJIU-në publikojmë harta detare, rrugëkalimet detare si dhe listat e faro-fenerëve me qëllim përmirësimin e nevojave për një lundrim të sigurt.

**Komandanti i Shërbimit  
Hidrografik Shqiptar,  
kapiten i Rangut II Artan Malo  
Për gazetën 'Ushtria',  
Shefqet Kercelli**



# MBI HISTORIKUN E SPITALIT USHTARAK QENDROR NË SHQIPËRI



DR. ASLLAN ZEMANI

**K**ur Shqipëria ishte nën pushtimin e Perandorisë Osmane, shqiptarët nuk kishin shtet e si pasojë as Forca të Armatosura e për më tepër nuk diskutohej të kishin shërbim shëndetësor, spitalor dhe ushtarak të mëvetësuar.

Megjithatë në hapësirën mbarë shqiptare ishin bërë të njohur emrat e disa mjekëve ushtarakë, që shërbenin në forcat e

armatosura osmane. Midis tyre ishte i përmendur doktor Ibrahim Temo nga Struga, e shumë mjekë të tjerë, të cilët nuk mundën të shërbenin në ushtrinë shqiptare, ushtri e cila u formua pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, në nëntor të vitit 1912.

Shërbimi Shëndetësor është një dukuri shumë e re në skemën organizative të

Ushtrisë Shqiptare të pas vitit 1912. Lidhur me këtë shërbim mjaft të domosdoshëm e jetik, në një nga dokumentet më të rëndësishme të vitit 1913, me titullin: “Rregullore e Përkohshme e Ministrisë së Luftës”, Vlorë, më 22 prill 1913, jepej përbërja e kësaj Ministrie dhe e Shtabit Madhor (Shtabi Madhner) të saj, ku përfshihej edhe “Shërbimi Shëndetësor”.

Kjo strukturë, mes shumë të tjerave, nuk pati kohë të përvijohet e të vihej në jetë e plotësuar nga ana e Ministrisë së Luftës e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, për vetë mënyrën dhe shpejtësinë me të cilat u zhvilluan ngjarjet.

Në vitet njëzet-tridhjetë të Shekullit XX, me organizimet dhe zhvillimet që pati Ushtria dhe Fuqitë (Forcat) e Armatosura Shqiptare, ky shërbim erdhi duke u fuqizuar dhe përmirësuar cilësisht.

Pikërisht në përbërje të këtij shërbimi tashmë shfaqet edhe një “institutcion” me vlera të veçanta, siç është “Spitali Ushtarak”.

Njoftimet e para për ngritjen dhe ekzistencën e një spitali ushtarak i përkasin pikërisht këtyre viteve. Kështu e dhëna e parë, që bën fjalë dhe dëshmon ekzistencën e një spitali ushtarak, vjen nga gjysma e dytë e vitit 1924, më 17 qershor, ku në skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare të Qeverisë së F. S. Nolit, për herë të parë përmendet krijimi i një “... Spitali Ushtarak me qendër në Tiranë”. Kurse në vitin 1926, në organikën e përgjithshme të oficerëve të Ushtrisë, ku në mes të 151 oficerëve e aspirantëve dhe 23 intendentëve, bënin pjesë edhe 5 mjekë ushtarakë.

Bazat e mirëfillta të mjekësisë ushtarake dhe të shërbimit spitalor ushtarak shqiptar, u hodhën në periudhën e viteve 1928-1938, kur u ndërmorën disa reformime për riorganizimin dhe përmirësimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Plot katër vite më vonë, më 24 qershor 1928 miratohet dhe hyn në fuqi “Ligji i parë organik i Ushtrisë dhe i Gjandarmërisë”, sipas të cilit, duhej të ngriheshin “...nga një spital ushtarak në Tiranë dhe në garnizone të mëdhaja ...”.

Garnizonet e mëdha nënkuptonin qendrat e grupeve ushtarake, që përfaqësonin njësitë më të mëdha për Ushtrinë Shqiptare të asaj kohe, të barabarta me një regjiment. Me anën e këtij ligji organik përcaktohej edhe varësia e spitalit nga Komanda e Fuqive Armate, siç quhej atë kohë.

Pikërisht në qendrën e njërit prej këtyre grupeve, në Spitalin e Elbasanit shërbente mjeku ushtarak i njohur në atë kohë, major Petraq Popa, që kishte hyrë në Ushtrinë Shqiptare që më 30 prill 1921. Ky mjek i përkushtuar punoi e shërbeu në këtë spital, me një personel të kufizuar, që nga 5 shkurti i vitit 1930.

Në të vërtetë “datëlindja” e Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak Shqiptar daton më 26 shtator 1929, kur në Tiranë, ai u ngrit dhe nisi veprimtarinë në një godinë të re dykatëshe, pranë rrugës së Dibrës, tek blloku i sotëm i Spitalit Civil: “Nënë Tereza”.

Ky fakt haset në shumë dokumente dhe botime të kohës, si edhe në shumë fotografi. Ky spital ishte pronë shtetërore

dhe për ndërtimin e tij u harxhuan 548.894.88 franga ari. Kjo vërtetohet edhe përmes faqeve të “Ligjit për organizimin e Fuqive Armate”, të vitit 1929, sipas të cilit, tek kreu mbi “Fuqitë Tokësore”, pika “Instituta, Stabilimenta e Reparte të ndryshme (Artikulli 23), bënin pjesë 4 spitale ushtarakë, një prej të cilëve i “Përgjithshëm”, me qendër në Tiranë.

Ende pa kaluar dy vite, në qershor të vitit 1931, pason një ligj për rregullimin e Ushtrisë Kombëtare, i cili konfirmonte gjithashtu, qenien e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak, në Tiranë. Dy ligje të tilla dolën njëri pas tjetrit në vitin 1934 e 1937 dhe në përbërje të Forcave Tokësore të Ushtrisë Shqiptare, afirmohej prania e një Spitali të Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë. Ky spital bënte madje “shërbimin shëndetësi” nën drejtimin e një mjeku, i cili ishte më i vjetri i garnizonit të kryeqytetit. Spitali varej drejtpërdrejt nga Komanda e Fuqive Armate.

Ekzistenca dhe funksionimi i këtij spitali në shërbim të Ushtrisë Shqiptare është i lidhur pazgjidhshmërisht edhe me veprimtarinë e disa mjekëve ushtarakë, të njohur tashmë për botën mjekësore dhe gjithë popullin shqiptar, që punuan me përkushtim. Një prej tyre, si përfaqësues ndër më të njohurit ka qenë edhe doktor Sinan Imami, i cili figuron në organikën e këtij spitali me gradën “togër”, që në vitin 1933. Krahës tij shërbyen edhe të tjerë si kapiten i klasit të dytë, Dr. Selaudin Mborja (që prej vitit 1930); kapiten i klasit të dytë, Dr. Pavli Flloko, (që prej vitit 1933); kapiten i klasit të dytë, Dr. Shan Nush Gjoka (që prej vitit 1932); togër Abdul Nazmi Skënduli, (që prej vitit 1933); togër Spiro Prokop Prosi, (që prej 1933); togër Luigj Benusi, (që prej 1932); togër Kiço Karajani, (që nga 1934); nëntogër, togër Tare Quku, (që nga 1938); Dr. Shyqyri Basha, (që prej vitit 1938); nëntogër, Dr. Petraq Progri, (që prej vitit 1938); nëntogër, Dr. Bahri Kopliku (që prej vitit 1938) e të tjerë. Drejtor i parë i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak ka qenë nënkolonel Dr. Ismet Gega, patolog, që u pasua nga Dr. Selaudin Mborja. Fakti që në këtë spital shërbyen disa mjekë të shquar dhe shumë mjekë të tjerë e personel ndihmës, si dhe tema që lidhen me kapacitetin kurues, llojet e shërbimeve, me kualifikimet e personelit, me rregullat e trajtimit e të mjekimit, e të tjera, përbën pa diskutim një objekt me interes për studim të plotë nga historianë ushtarakë dhe pse jo, edhe nga specialistë të mjekësisë ushtarake shqiptare. Kaq e vërtetë është ekzistenca e këtij spitali të përgjithshëm sa vetë drejtori i tij në vitin 1945, tashmë koloneli Sinan Imami, kishte shërbyer si mjek pikërisht në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak të Tiranës, që nga 1 korriku 1933. Këtë gjë e vërteton më së miri “Lista e përshkallëzimit të oficerëve të përhershëm”, që botohej nga Komanda e Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare pothuajse çdo vit deri më 1939.

Pas agresionit fashist kundër Shqipërisë dhe pas pushtimit të saj, më 7 prill 1939, fati i Spitalit të Përgjithshëm Ushtarak Shqiptar ndoqi atë të vet Ushtrisë Shqiptare. Ai u bashkua me strukturat e gjithë Forcave të Armatosura të të dy palëve.



Gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare pranë Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare u ngritën e funksionuan disa “spitale partizane”, që kishin një natyrë organizimi dhe veprimi të veçantë, që është e shpjegueshme për kushtet e luftës partizane dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Vullnetare Shqiptare. Kurse pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj fashistë e nazistë, më 2 shkurt 1945, u ngrit në Tiranë, Spitali i Përgjithshëm (sot Qendror) i Ushtrisë me drejtues (drejtor) të parë që ishte pikërisht një nga mjekët e ish-Spitalit të Përgjithshëm, Usharak i viteve njëzet-tridhjetë të shek. XX. Ky ishte mjeku ushtarak, kolonel Sinan Imami, që tani vinte nga radhët e mjekëve të Ushtrisë NÇ Shqiptare dhe qëndroi si drejtues i këtij institucioni deri në shtator 1973. Më pas, mjekë të shquar kanë qenë drejtues si Dr. Veli Toto, (1973-1989); Dr. Perlat Hodo, (1989-1991); nënkolonel Dr. Ilir Kajo; nënkolonel Dr. Mihal Kërçi; kolonel Dr. Esat Duraku; kolonel Dr. Engjëll Mastori; nënkolonel Dr. Hajri Gërbi; kolonel Dr. Luan Nikollari.

Pas vitit 1945 e deri në ditët tona shërbimi spitalor ushtarak shqiptar, natyrisht ka njohur përmasa dhe nivele të reja zhvillimi, që përpiqeshin ta mbanin edhe këtë shërbim tepër të rëndësishëm për mbarëvajtjen e Forcave të Armatosura Shqiptare, në një hap me to. Kështu që, mund të thuhet se vënia në punë e Spitalit Usharak, në atë ditë shkurti 1945, në të vërtetë, mund të quhet ringritje, në kushte të reja, i ish-Spitalit të Përgjithshëm Usharak të viteve '20-'30 të shekullit të shkuar. Ky argument është më pranë të vërtetës historike

**“BAZAT E MIRËFILLTA TË MJEKËSISË  
USHTARAKE DHE TË SHËRBIMIT SPITALOR  
USHTARAK SHQIPTAR, U HODHËN NË  
PERIUDHËN E VITEVE 1928-1938, KUR  
U NDËRMORËN DISA REFORMIME PËR  
RIORGANIZIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E  
FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË.  
PLOT KATËR VITE MË VONË, MË 24 QERSHOR  
1928 MIRATOHET DHE HYN NË FUQI  
“LIGJI I PARË ORGANIK I USHTRISË DHE I  
GJANDARMËRISË”, SIPAS TË CILIT, DUHEJ TË  
NGRIHESHIN “..NGA NJË SPITAL USHTARAK NË  
TIRANË DHE NË GARNIZONE TË MËDHAJA ...”.**

ushtarake shqiptare.

Të përpiqesh të shkruash dhe të përkujtosh me shumë realizëm këto ngjarje, figura apo institucione për të ndriçuar dhe për t'i bërë të njohura, është një mënyrë veprimi dhe gjest respekti për veprën e paraardhësve. Në të njëjtën kohë ai përbën edhe një mesazh vlerësimi dhe njohjeje për ta dhe vetë historinë ushtarake shqiptare, larg skemave shabllone dhe tabuve, që i bëjnë ato të paragjyqeshme. Madje, meritë do të ishte zbardhja dhe rindërtimi i plotë në pikëpamje historike i strukturave të tyre dhe përshkrimi dhe evidentimi i vlerave të personaliteteve të tyre drejtuese.

# Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile, BMEC e 'Heronjve të Heshtur' të FA-së

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC) në Komandën Mbështetëse, është struktura që siguron kapacitetet e nevojshme operationale për kryerjen e operationeve luftarake, të emergjencave civile, të kërkim - shpëtimit, operationeve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit.

Kjo strukturë kryen detyra të rëndësishme në tërësinë e zhvillimit të aktivitetit të Komandës Mbështetëse. Baza e Mbështetjes të Emergjencave Civile (BMEC) përgatit dhe stërvit personelin në interes të detyrimeve që kërkon misioni i BMEC. Ajo ka për detyrë aftësimin e personelit për tu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit.

Kryerja e operationeve të kërkim - shpëtimit në kohë paqe, krize dhe lufte për njerëzit dhe mjetet në rrezik është një detyrë tjetër e BMEC-së. Bashkëveprimi me strukturat e OJQ-ve Kombëtare dhe ndërkombëtare në raste krizash dhe emergjencash civile, eliminimi i pasojave të shkaktuara nga tërmetet, zjarret, përmytjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore e të veprimit njerëzor, janë detyra gjithashtu të Bazës të Mbështetjes të Emergjencave Civile, përgatitja e forcave për ndërhyrje në vatrat e dëmtuara dhe lehtësimi i pasojave të shkaktuara në këto fatkeqësi, si dhe dhënia e ndihmës, vendeve të rajonit në rast EC, në kuadrin e NATO-s.

Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile në Komandën Mbështetëse është struktura që operon ngushtësisht me Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile, struktura të tjera të FA-së dhe gjendet pranë popullatës në çdo rast fatkeqësie.

Fusha e Mbrojtjes Civile në Shqipëri është relativisht e re dhe në të shkuarën kryesisht ka shërbyer si një strukturë ushtarake. Megjithatë edhe më herët ka pasur problematika të ndryshme dhe personel që merreshin me mbrojtjen civile, por mbështetja mbi baza ligjore, e këtij shërbimi për herë të parë është formalizuar me dekretin e Kuvendit Popullor Nr. 3924, dt. 07.12.1964, i cili e vendoste Shërbimin e Mbrojtjes Civile, në varësi të Ministrisë së Brendshme. Më vonë, drejtimi në nivel qendror i këtij shërbimi kaloi në Këshillin e Ministrave e më pas në Ministrinë e Mbrojtjes, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në Ministrinë e Brendshme dhe në vitet e fundit,



Mbrojtja Civile në Shqipëri është rinovuar në koncept, strukturë dhe detyra, duke u përafuar me strukturat e vendeve të tjera në funksion të planifikimit, koordinimit dhe menaxhimit sa më të mirë të emergjencave civile. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është pjesë përbërëse e strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Baza e Mbështetjes të Emergjencave Civile (BMEC) në Komandën Mbështetëse është struktura që siguron kapacitetet e nevojshme operationale.

Kriza e vitit 1998-1999, e luftës në Kosovë shërbeu si një shembull, ku u ndërthurën shumë faktorë, përfshirë edhe planifikimin e emergjencave, mbrojtjen civile dhe menaxhimin e krizës. Siguria e qytetarëve, e pronës, e mjedisit dhe e vlerave kulturore merr rëndësi të veçantë edhe për shkak të kërcënimeve të rreziqeve, që janë rezultat i prodhimit, përdorimit dhe ruajtjes së materialeve të rrezikshme, si dhe aktiviteteve kriminale e terroriste, që mund të kërcënojnë jetën e komunitetit. Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1, 170 dhe 174 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit



të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat Civile”. Ky është ligji i parë në historinë e legjislacionit shqiptar, i përmbledhur dhe i pavarur në këtë fushë. Gjatë viteve të fundit janë bërë përparime në kompletimin e bazës ligjore, planifikimit në të gjitha nivelet, ngritjes së strukturave si dhe ngritjes tekniko-profesionale të personelit të Shërbimit të Emergjencave.

#### **Përballja me sukses e çdo situatë, angazhim në EC për shuarjen e zjarreve**

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit në Shqipëri zjarret, sidomos në pyje, janë shtuar si numër por gjithashtu është rritur edhe përmasa e sipërfaqeve të prekura. Të dy treguesit janë mbi karakteristikat mesatare të vendeve mesdhetare. Që nga viti 1992 në Shqipëri është rritur ndjeshëm rreziku i zjarreve në pyje, duke arritur kulmin në vitin 2000. Vetëm dhjetëvjeçarin 1990-2000, raporti ndërmjet sipërfaqes pyjore të djegur dhe sipërfaqes së vendit ishte rreth 2.19. Zjarret në pyje dhe kullota shpesh janë ngjarje që shkaktojnë shkatërrim në një zonë të gjerë. Shkaqet kryesore të zjarreve janë pakujdesia e njerëzve, aksidentet dhe vëniet e qëllimshme të zjarrit, djegia për kullota, si dhe shkaqet natyrore, rufetë. Zjarret e pakontrolluara, të shkaktuara aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllim pastrim kullotash, vijnë në ndodhin çdo vit në vendin tonë, duke qenë më të dendur në

pyje dhe gjeografikisht më tepër në jug të vendit. Rreziku më i madh i zjarreve në pyje është evident në fund të pranverës dhe gjatë periudhave të thata të verës. Një rol të rëndësishëm në menaxhimin e zjarreve, parandalimin apo shuarjen e tyre, ka bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës midis institucioneve shtetërore në nivel qendror, rajonal dhe lokal dhe i aktorëve të tjerë si përdorues, pronarë dhe subjekte private, duke bërë që këto situata të mundshme gjatë stinës së verës të përballohen me sukses.

Vetëm para pak ditësh, kur informoi publikun për situatën e zjarreve dhe reshjeve në vend, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi se Mekanizmi Kombëtar i Mbrojtjes Civile ka funksionuar këtë vit më mirë se çdo herë tjetër, ku deri më tani, tha ministri, janë mundur të menaxhohen me shumë sukses 465 vatra zjarri, duke ruajtur jetën e njerëzve, pa patur asnjë jetë të humbur dhe as të rrezikuar, si dhe duke ruajtur gjithashtu pasurinë e qytetarëve si në qytet ashtu edhe në fshat. Forcat e Armatosura të BMEC-së kanë qenë në luftë më flakët për të ruajtur dhe shmangur zjarret në shumë zona pyjore e pemëtari.

#### **Parandalimi i zjarreve në pyje zvogëlon koston e përballimit të përhapjes dhe shuarjen e tyre**

Në radhë të parë, si shkak i zjarreve evidentohen faktorët

klimatikë, konkretisht thatësira e jashtëzakonshme, e cilësuar si më e madhja e 50 viteve të fundit. Por edhe këtu, “faktori njeri” cilësohet po aq i dëmshëm dhe me efekte direkt në shkaktimin dhe favorizimin e zjarreve. Sipas një tradite të vjetër bujqësore tokës i vihet flaka për ta përgatitur për sezonin e ardhshëm. Por në shumë raste, si pasojë e erërave të forta, afërsisë me pyjet, thatësirës dhe ajrit të nxehtë, zjarret avancojnë me shpejtësi dhe shkaktajnë djegie masive të pyjeve. Një shkak tjetër është dhe logjika krejtësisht tregtare që përdorin pronarët apo përdoruesit e pyjeve, të cilët djegin drurët tradicionale pa ndonjë vlerë të madhe në treg për t’i zëvendësuar ato më vonë me drurë të tjerë me “vlerë tregtare” si eukaliptet, palmat, etj. Sipas disa vlerësimeve, gjatë periudhës 2000-2003, zjarret në Azinë Juglindore shkaktuan një dëm prej 16-18 miliardë dollarësh. Por Mesdheu është një nga zonat më problematike të planetit. Në vendet mesdhetare numërohen mbi 60 000 zjarre në vit, bile në disa vende të evidentuara si më të vështirat në këtë aspekt, regjistrohen 20 000 deri 25 000 vatra zjarri në vit. Sipas Komisionit Europian “këto zjarre shkatërrojnë çdo vit, kryesisht në sezonin e verës, mbi 700 000 hektarë pyje me një tendencë që vjen në zgjerim”, duke u bërë kështu faktori kryesor i rrezikut ekologjik për këtë rajon.

Spanja, Portugalia, Greqia dhe Shqipëria, kanë njohur vitet e fundit thatësirën më të madhe të tyre, të paktën për shekullin e fundit. Tashmë temperaturat 38, 40, madje edhe 45 gradë janë bërë normale në vendet e Mesdheut Verior e Jugor, por sipas Këshillit të Europës, “më shumë se sa thatësira, shkaku kryesor i zjarreve është neglizhenca humane, piromanët si dhe barinjtë apo fermerët që praktikojnë zjarret për të përfituar kullota apo përmirësuar cilësitë e tokës, vetëm 10-15 e zjarreve ndodhin për shkaqe natyrale e klimatike, ndërsa 85 % e tyre janë rezultat i veprimtarisë së njeriut”. Kjo sipas statistikave dhe vlerësimeve të ekspertëve, në ndryshim nga shumë rajone të tjera të botës



ku faktorët me origjinë natyrale janë më prezentë se sa në rajonin e Mesdheut. Vendet europiane shpenzojnë çdo vit me miliarda euro në luftën kundër zjarreve të pyjeve dhe miliarda euro të tjera si subvencione e programe speciale pyllëzimi. Tashmë në shumicën e vendeve mesdhetare është ndërtuar linja kryesore e politikave, ku të investosh masivisht dhe me koncepte e praktika të qarta në parandalimin e zjarreve në pyje, do të thotë jo vetëm të eliminosh zjarret, por dhe të zvogëlosh shumë koston e përballimit të përhapjes dhe shuarjes së tyre.

#### **Angazhimi i forcave dhe mjeteve në situata të shkaktuara nga përmbytjet, tërmetet dhe emergjenca të tjera**

Kushtet e këqija atmosferike, nga reshjet e dendura të shiut nuk i kanë ndalur efektivët e Bazës së Mbështetjes të Emergjencave Civile të Komandës Mbështetëse të realizojnë me sukses misionet e tyre të kërkim-shpëtimit në ndihmë





të komunitetit. Si ditën ashtu edhe në orët e vona të natës, i kemi parë ata mbi gomone dhe pranë motor-pompave, duke ndihmuar dhe transportuar banorë, kur shirat e dendur kanë përmytur shtëpi banimi e biznese të ndryshme, duke bllokuar qindra persona në ambiente të ndryshme. Me ndihmën e grupit të palombarëve shpesh është bërë i mundur kërkimi në brendësi të objekteve të përmytura si dhe shkëputja e energjisë elektrike me qëllim evitimin e ndonjë incidenti të mundshëm. Të veshur me kostumin e tyre të palombarit, ky grup i mirë trajnuar shpesh ka evakuuar banorët nga zonat e përmytura drejt zonave më të sigurta. Madje situata të tilla i kanë mbajtur ata jo rrallë herë të angazhuar përgjatë gjithë natës deri në orët e para të mëngjesit. Qindra persona, bagëti e orëdi të ndryshme kanë shpëtuar falë profesionalizmit dhe përkushtimit të këtyre heronjve të heshtur në këto operacione EC.

As uji, zjarri apo tërmeti nuk i ka ndalur efektivët e Bazës së Mbështetjes të Emergjencave Civile të Komandës Mbështetëse, në përballjen me situatat kritike për banorët e zonave në rrezik, siç ishte edhe rasti i tërmetit në Shqipëri i 26 nëntorit 2019. Mjetet e Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC) të Komandës Mbështetëse iu janë bashkëngjitur gjithashtu edhe nismave të bashkive në vend për pastrimin e ambienteve në zonat turistike si në Velipojë dhe Shirokë, në verën e këtij viti, etj., ku puna e trupave të FA-së në këtë operacion konsiston në grumbullim e transportim mbetjesh e inertesh të ndryshme. Ose më herët kur pas emergjencës të shpallur për pastrimin e

Liqenit të Fierzës në Qarkun e Kukësit, më 2014, kur u kërkua bashkëpunimi me Brigadën e Mbështetjes Rajonale, (paraardhës i BMEC në atë kohë), ku u pastruan rreth 2300 m<sup>2</sup> sipërfaqe në breg të liqenit dhe u grumbulluan dhe transportuan rreth 90 metër kub mbetje plastike.





# Njerëzimi duhet të kujtojë se paqja nuk është dhuratë e zotit për krijesat e tij, paqja është dhurata jonë për njëri-tjetrin

**A**sambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) e ka shpallur 21 shtatorin si Ditën Ndërkombëtare të Paqes, si dedikim për forcimin e idealeve të paqes, mes vendeve dhe popujve të botës.

Dita Ndërkombëtare e Paqes është një ngjarje e posaçme dhe këtë herë shënon 69-vjetorin e Kambanës së Paqes, e cila çdo vit bie në këtë ditë.

Në vitin 1954, fëmijë nga 60 shtete i dhuruan OKB-së, monedha, të cilat shërbyen për të farkuar kambanën, e cila

bie çdo vit, në nder të Ditës Ndërkombëtare të Paqes.

Për të folur në detaje për simbolin e Paqes, fillimisht duhet të bëjmë të njohur etimologjinë e kësaj fjale, e cila në dukje është shumë e thjeshtë, por ka një konotacion dhe kuptim të madh. Njeriu është në kërkim të vazhdueshëm të paqes në të gjitha fushat, në shoqëri, në shtëpi, për Kombin e tij etj.

Fjala “paqe” është një nga më të evokuarat në çdo gjuhë, flitet për paqen e brendshme, për paqen e punës, përdoret si sinonim i qetësisë. E megjithëse gjithmonë është shpallur se dëshira më e madhe e njeriut është të ketë paqe në botë,

faktet dhe veprimet e tij tregojnë të kundërtën, duke shkaktuar luftë dhe dhunë. Ka shumë psikologë që vërtetojnë këtë fakt se njeriu gjithmonë ka kërkuar vetë-shkatërrimin e tij. Gjithashtu, luftërat janë kthyer në një biznes që lë përfitime të mëdha për të përfshirët. Fjala “Paqe” po përdoret gjithashtu si emër femëror.

### **E vërteta e simbolit të paqes?**

Figurat e kafshëve dhe shpendëve, njerëzit shpesh i përdorin për të simbolizuar një diçka të veçantë dhe tani është bërë e zakonshme. Në kultura të ndryshme, macja e zezë simbolizon fat të keq vetëm se ka ngjyrë të zezë, bufi konsiderohet si shpend që ka inteligjencë vetëm pse ka sytë e mëdhenj dhe sheh natën dhe pëllumbi i bardhë simbolizon paqe, për shkak të ngjyrës?

Por, secila nga këto ka një shpjegim dhe histori të veçantë dhe nuk është çështje ngjyrash. Në përgjithësi zogjtë janë të privilegjuar pasi kanë një lidhje ndërmjet qiellit dhe tokës. Shpesh kemi parë se pas çdo gjesti human lirohen pëllumba të bardhë që të fluturojnë të lirë.

### **A e dini pse pikërisht ky shpend simbolizon paqen?**

Pëllumbi si simbol i paqes ka mbetur që nga periudhat e hershme të krishterimit dhe paganizmit.

Sipas librit të shenjtë të krishterimit, Biblës, thuhet se toka ka kaluar në një sfidë të përmbysjes nga uji, kështu Noa, dërgoi pas përmbytjes një pëllumb të bardhë me synimin për të gjetur tokë të thatë. Pëllumbi u kthye pas pak kohe duke mbajtur në sqepin e tij një degë të njomë ulliri, shenjë që tregon se ujërat ishin tërhequr dhe se qetësia dhe paqja ishin kthyer në tokë.

### **Cili është kuptimi i pemës së ullirit?**

Dega e ullirit ishte simboli i paqes dhe ky simbol përdorej si ofertë paqeje për ushtritë armike dhe ata që u mundën dhe kërkonin paqe, mbanin degë ulliri në duar....

### **Rrethi dhe tre vijat brenda tij**

Ky lloj simboli i paqes u bë shumë i njohur për t'u përdorur si një zbulim kozmetik në byzylykë, gjerdan, pikturuar në çanta, këmbisha etj. Përdorimi i tij në përgjithësi bëhet nga njerëz që identifikohen me lëvizjet mjedisore, kulturistët, lëvizjet e paqes, ndër të tjera.

Fillimisht lidhej me kryqin e përmbysur, duke i dhënë atij një konotacion satanik, derisa u lidh më shumë drejt një kuptimi të paqes. Disa të dhëna për origjinën e saj, thonë se është krijuar në Londër, në vitet 1958, nga Gerald Holton, veçanërisht për t'u përdorur gjatë marshimit të parë për çarmatimin bërthamor.

Më vonë, lëvizjet kulturore dhe të paqes, si dhe të ashtuquajturit hipitë e viteve 1960, filluan ta përdorin atë

si simbol në protestat paqësore. Në ditët e sotme, ajo ka adoptuar një kuptim të paqartë të paqes dhe dashurisë.

### **Flamuri i bardhë**

Përdorimi i flamurit të bardhë si simbol i paqes u bë modë në filmat e luftës, ku në mes të aksionit dilte dikush duke valëvitur një flamur të bardhë, duke kërkuar rivendosjen e paqes.

Megjithatë, kuptimi i paqes që përmban flamuri i bardhë, vjen nga koha e Luftërave Punike, e cila i referohet luftës së dytë publike, e cila ndodhi midis viteve 218 dhe 201 p.e.s., ku shprehin dorëzimin e tyre dhe kërkojnë ndërprerjen e sulmet, një anije kartagjenase ngriti disa pëlhura të bardha dhe degë ulliri.

Që nga ai moment dhe deri më sot, përdorimi i flamurit të bardhë ka shërbyer si shenjë dorëzimi nga një prej grupeve pjesëmarrëse në konflikt. Përveç kësaj, përdorimi i tij mbart në thelb dëshirën për të rivendosur paqen. Ndër përdorimet e tjera të flamurit të bardhë është armëpushimi për të negociuar me armikun dhe kërkesa për leje për të mund të udhëtojë lirshëm nëpër territorin e armikut.

### **Ylberi i paqes**

Përdorimi i ylberit si simbol i paqes u popullarizua në vitin 1961, kur u mbajt brenda një flamuri në një marshim paqeje nga Aldo Capitini, një personazh ilustrues nga vendi Lombard. Flamuri ylber i paqes përmban shtatë ngjyrat e kundërta, domethënë vjollcën ose vjollcën sipër dhe të kuqen poshtë.

### **Duat e bardha**

Duat e shtrira, të lyera me ngjyrë të bardhë, duke treguar pjesën e pëllëmbës, u bënë simbol i paqes dhe një protestë në kundërshtim me dhunën që u ngrit veçanërisht kundër akteve





# 11 Shtatori, dita e terrorit që ndryshoi botën

Mëngjesin e 11 shtatorit të vitit 2001, 19 terroristë Islamikë të Al Qaeda-s, morën peng 4 avionë pasagjerësh të nisur nga Boston, New York dhe Uashington dhe i përdorën ato si raketa gjigante për të sulmuar godina simbolike në SHBA.

2 kullat ikonë të Nju-Jorkut u rrëzuan, Pentagoni u dëmtua rëndë, gati 3 mijë njerëz humbën jetën dhe shumë të tjerë u plagosën, ose pësuan probleme afatgjatë shëndetësore. Sulmi më i rëndë terrorist në tokën amerikane ndryshoi Shtetet e Bashkuara dhe të gjithë botën në mënyrë të pakthyeshme.

## **08:45, sulmohet Kulla Veriore e 'World Trade Center'**

Shënjestra e parë ishte Kulla Veriore e 'World Trade Center' në New York. Një 'Boeing 767' i ngarkuar me mbi 75 mijë litra karburant u përplas me Kullën Veriore, duke lënë një vrimë në katin e 80-të

të godinës 110-katëshe. Qindra veta në katet e sipërme mbetën të vrarë në vend, e shumë të tjerë u bllokuan. Ndërsa evakuimi i kullës nisi menjëherë, kamerat transmetonin live imazhet e atij që fillimisht ngjau një aksident i frikshëm.

## **09:03, sulmohet Kulla Jugore e 'World Trade Center'**

18 minuta më vonë, një tjetër 'Boeing 767' i United Airlines, u shfaq në qiell, duke devijuar në mënyrë të beftë drejt 'World Trade Center', për të goditur Kullën Jugore pranë katit të 60-të. E ndërsa u bë e qartë se Amerika po sulmohej, një shpërthim masiv derdhi shi mbetjesh të djegura në godinat e rrugët rreth e rrotull.

## **9:45, sulmohet Pentagoni**

Ndërsa miliona njerëz shihnin të tmerruar ngjarjet dramatike në New York, një avion i 'American Airlines', me numër fluturimi 77,

u pa të vërtetë mbi Uashington para se të përplasej me pjesën perëndimore të Pentagonit, selia gjigante e ushtrisë amerikane. Karburanti i 'Boeing 757' shkaktoi një zjarr shkatërrues që çoi në shembjen e strukturës së një pjese të murit gjigant prej betoni.

#### **10:10, rrëzohet avioni në Shenksvil të Pensilvanisë**

Avioni i 4 u rrëzua në një fushë të Pensilvanisë në 10:03 minuta, pasi pasagjerët, të cilët ishin në dijeni të ngjarjeve në New York, iu kundërvunë terroristëve, duke parandaluar një sulm të mundshëm në godinën e Kapitolit. Mjeti fluturues i nisur nga aeroporti i New Xhersit me destinacion Kaliforninë, humbi kontrollin dhe ra me shpejtësi drejt tokës, duke u përplasur pranë një fushe në Shenksvil në Pennsilvaninë perëndimore.

#### **Shemben Kullat Binjake**

Më pak se 15 minuta pasi terroristët goditën në zemër ushtrinë amerikane, tmerri në New York mori dimension të ri, pasi kulla jugore u shemb duke lënë pas re masive tymi dhe pluhuri. Në 10:30, të njëjtin fat pati edhe kulla veriore.

#### **Sa njerëz vdiqën?**

Në total 2977 njerëz, pa përfshirë 19 pengmarrësit, humbën jetën në sulme, shumica e të cilëve në New York. 246 pasagjerët dhe pjesëtarët e ekuipazhit në 4 avionët u vranë. Në kullat binjake, u shënuan 2606 viktimë, që humbën jetën në vend ose më vonë nga plagët e marra. Në Pentagon, u vranë 125 persona.

Viktima më e re ishte 2-vjeçarja Christine Lee Hanson, e cila vdiq në një prej avionëve bashkë me prindërit Peter dhe Sue. Viktima më e moshuar ishte 82-vjeçari Robert Norton, i cili gjendej në një tjetër avion me bashkëshorten Zhakline, teksa ishin nisur për një dasmë. Kur avioni i parë sulmoi kullat, rreth 17 400 persona gjendeshin atje. Askush nuk mbijetoi mbi zonën e impaktit në kullën veriore, por 18 vetë arritën të largoheshin nga katet mbi zonën e impaktit në Kullën Jugore. Qytetarë nga 78 vende të ndryshme ishin mes viktimave. Nju Jorku humbi 441 punonjës të ndërhyrjes së shpejtë. Mbi 10 mijë njerëz u plagosën ose zhvilluan më pas sëmundje që kishin lidhje me sulmet, përfshirë zjarrfikësit që ishin përfshirë në operacione mes mbetjeve toksike.

#### **Kush ishin agresorët?**

Rrjeti ekstremist Islamik, Al Qaeda planifikoi sulmet nga Afganistani, i udhëhequr nga Osama Bin Laden, Al Qaeda fajësonte SHBA-të dhe aleatët e saj për konfliktet në botën Myslimane. 19 pjesëtarë të grupit terrorist morën peng avionët, duke u koordinuar në 3 ekipe prej 5 personash dhe një me 4 të tillë, në avionin e rrëzuar në Pensilvani. Secili grup përfshinte dikë që ishte trajnuar si pilot në shkollë amerikane fluturimi. 15 nga pengmarrësit ishin sauditë, ashtu si vetë Bin Laden, dy ishin nga Emiratet e Bashkuara Arabe, një nga Egjipti, dhe një nga Libani.

#### **Si reagues SHBA-të?**

Më pak se një muaj pas sulmeve, presidenti amerikan George

W. Bush me mbështetjen e një koalicioni ndërkombëtar, udhëhoqi pushtimin e Afganistanit, me qëllim shkatërrimin e Al Qaeda-s dhe kapjen e Osama Bin Laden. Megjithatë u desh të pritej deri në 2011, që trupat amerikane më në fund të lokalizonin dhe të vrisnin terroristin më të kërkuar në botë. Arkitekti i pretenduar i sulmeve të 11 shtatorit, Khalid Sheikh Mohammad, u arrestua në Pakistan në vitin 2003. Ai mbahet në burgun e Guantanamo-s që prej atëherë dhe është pritje të procesit gjyqësor. Al Qaeda vazhdon të ekzistojë, është më e fortë në Afrikën subsaharaine, por edhe tani ka pjesëtarë brenda Afganistanit. Trupat amerikane u larguan nga Afganistani pas gati 20 vitesh, duke nxitur frikën se shumë prej grupeve Islamike mund të rikthehen.

#### **Trashëgimia e 11 Shtatorit**

Masat e sigurisë lidhur me udhëtimet ajrore u ashpërsuan ndjeshëm pas sulmeve të 11 shtatorit. Në SHBA, Administrata për Sigurinë në Transport u krijua për të forcuar sigurinë në aeroporte dhe avionë. U deshën më shumë se 8 muaj për të pastruar 'Ground Zero', siç u quajt zona ku dikur ishin kullat



binjake. Një memorial dhe muze gjenden tani atje. Emrat e të gjithë viktimave u skalitën në panele të bronzta, të grupuara sipas vendit ku individët gjendeshin në ditën e sulmit, në mënyrë që kolegë dhe njerëz në të njëjtin fluturim të përjetësoheshin së bashku. Gjithashtu kullat binjake u ringritën në një formë tjetër, në një projekt që u inaugurua në nëntor të viti 2014. Struktura e pagëzuar si, 'One World Trade Center' ose Kulla e Lirisë, është 541 metra e lartë, më shumë se sa kulla origjinale veriore. Për rindërtimin e Pentagonit u deshën më pak se një vit, me stafin që u rikthye në zyra, në gusht të 2002-shit.

# “Është koha për të rregulluar Inteligjencën Artificiale si makinat dhe drogat”

Presidenti i Microsoft Brad Smith miratoi idenë e një regjimi federal licencimi dhe një agjencie të re për të rregulluar platformat e fuqishme të AI-së, një pozicion që e vë atë në kundërshtim me ‘Google’ dhe disa gjigantë të tjerë të teknologjisë, të cilët më mirë do të shihnin udhëzime vullnetare me ndëshkime të kufizuara për krijuesit e teknologjisë së inteligjencës artificiale. Në një stuhë dëgjimesh mbi AI-në, Smith është ndër udhëheqësit e teknologjisë që priten në një seancë me dyer të mbyllura me udhëheqësin e shumicës së Senatit Chuck Schumer, së bashku me Elon Musk të Tesla-s, Mark Zuckerberg nga Meta, Sam Altman nga OpenAI dhe Satya Nadella, gjithashtu nga Microsoft.

“Një regjim licencimi ka të bëjë kryesisht me sigurimin e një baze të caktuar sigurie, aftësie”, - tha Smith. “Ne duhet të dëshmojmë se mund të vozisim para se të marrim patentë. Nëse ne vozisim pa kujdes, mund ta humbasim atë. Ju mund të aplikoni të njëjtat koncepte, veçanërisht për përdorimet e AI-së që do të implikojnë sigurinë.”

Smith dëshmoi të martën në Senat në mbështetje të një kuadri rregullator të propozuar nga Sens. Richard Blumenthal (D-Conn.) dhe Josh Hawley (R-Mo.), që do të krijonte një entitet licencues për modelet e sofistikuar ose potencialisht të rrezikshme të AI-së. Korniza gjithashtu kërkon që kompanitë të mbahen përgjegjëse kur modelet e tyre të AI-së “shkelin privatësinë, shkelin të drejtat civile ose shkaktojnë dëme të njohura”.

Ekzekutivi i Microsoft tha për ‘POLITICO Tech’ se vetëm sistemet e rrezikshme të AI-së duhet të kërkojnë licenca dhe se marrja e një licence nuk duhet të jetë tepër e komplikuar, kërkon kohë ose kosto të lartë. Por ai pret që Microsoft dhe OpenAI, në të cilat Microsoft është një investitor kryesor, t’i nënshtrohen rregullave të licencimit dhe kompania është “e përgatitur për të praktikuar atë që predikojmë”.

Ai i tha ‘POLITICO Tech’ se është një “qasje e arsyeshme” që Kongresi duhet të ndërmarrë si “hapin e parë” dhe më pas “të vazhdojë ta shtojë atë shpejt”.

“Ne jemi një industri që ka qenë e ngadaltë për të kuptuar se ligji dhe rregullorja mund ta bëjnë një treg më të mirë, nëse ndiqet në një mënyrë praktike dhe të ekuilibruar”, - tha Smith. “Por sot, kur flas me njerëz në sektorin e teknologjisë, ata po mendojnë, me ndoshta pak më shumë përvojë dhe shpresoj edhe pak më shumë mençuri sesa kishim një dekadë më parë.”

Smith pranoi se Kongresi nuk kishte gjasa të miratonte ndonjë legjislacion të madh të AI-së këtë vit, por tha se ai ishte optimist që rregullimi do të vinte përfundimisht, ndoshta vitin e ardhshëm ose “përtej”.

Smith pretendon se produkte të tjera që paraqesin një rrezik të mundshëm sigurie janë rregulluar prej kohësh: automjetet



motorike, barnat me recetë dhe ushqimi, për të përmendur disa, dhe ai beson se më shumë drejtues të teknologjisë kanë pranuar idenë se inteligjenca artificiale do të duhet t’i përmbahet niveleve të ngjashme të mbikëqyrjes.

Në rastin e rregullimit të AI-së, Smith bëri që industria të luante një rol të madh në shkrimin e rregullave.

Në fillim të këtij viti, Microsoft ishte një nga shtatë kompanitë që nënshkruan udhëzimet vullnetare të sigurisë të lëshuara nga Shtëpia e Bardhë. Tetë kompani të tjera të teknologjisë nënshkruan premtimin të martën, duke përfshirë Adobe, IBM dhe Palantir. Smith sugjeroi që procesi ofron një model për entitetet e tjera qeveritare për t’iu qasur rregullimit të AI-së.

Shtëpia e Bardhë i dha Microsoft, Google, Anthropic dhe OpenAI një muaj pas një takimi në maj për të sugjeruar udhëzimet e tyre, tha Smith. Zyrtarët e administratës më pas rishikuan fushat e tyre dhe u thanë se ku duhej të bënin më shumë. Udhëzimet përfundimtare u nënshkruan në korrik.

“Përdor industrinë për të ofruar një pamje fillestare të asaj që është e mundur në mënyrë që të jetë praktike. Por mos e merrni fjalën tonë të parë si fjalën e fundit”, - tha Smith.

“Mendoj se është e drejtë që njerëzit në qeveri të na shtypin të shkojmë më larg. Kështu ndodhi në Shtëpinë e Bardhë. Mendoj se do të shohim diçka të ngjashme në Kongres dhe në kryeqytete të tjera anembanë botës.”

# Ata që punojnë nga shtëpia do të jenë të parët që do të humbasin punën për shkak të AI-së

## *Ritmi i shpejtë i përparimit në zhvillimin gjenerues të AI-së vë në rrezik më shumë vende pune*

Njerëzit që punojnë nga shtëpia janë më të rrezikuar nga humbja e punës për shkak të inteligjencës artificiale (AI), kanë paralajmëruar akademikët e Oksfordit.

Profesorët Carl-Benedikt Frey dhe Michael Osborne, të dy nga Universiteti i Oksfordit, paralajmëruan në një draft dokument se detyrat “në distancë” që mund të kryeshin jashtë zyrës ishin më të lehtë për t'u automatizuar.

Prof Frey tha: “Tani duket se AI-ja mund të jetë në gjendje të zëvendësojë punën njerëzore në shumë mjedise virtuale, që do të thotë se nëse një detyrë mund të kryhet nga distanca, ajo gjithashtu mund të automatizohet potencialisht”.

Punonjësit me bazë në zyrë janë më të vështirë për t'u zëvendësuar sepse AI-ja përpiket të përsërisë vlerën e një bisede ose takimi në jetën reale, tha ai.

Ai tha: “Ndërveprimet personale mbeten të vlefshme dhe ndërveprime të tilla në jetën reale nuk mund të zëvendësohen lehtësisht”.

Gjetjet mund t'i nxisin punëtorët që po luftojnë kthimin në zyrë ta rimendojnë këtë. Kompanitë, duke filluar nga ‘Disney’ dhe ‘Facebook’ tek ‘Lloyds’ dhe ‘Goldman Sachs’, kanë kërkuar kthimin e stafit në zyrë, por kanë hasur në rezistencë në disa raste. Profesorët Frey dhe Osborne kanë studiuar AI-në për më shumë se një dekadë dhe parashikuan në vitin 2013 se automatizimi do të çonte në humbjen e qindra miliona vendeve të punës, duke vënë në rrezik deri në 47 për qind të të gjitha roleve në SHBA.

Kërcënimi i AI-së tashmë ka shkaktuar përçarje të konsiderueshme në vendet e punës në mbarë botën. Mijëra aktorë dhe shkrimtarë kanë hyrë në grevë në ‘Hollywood’, mes frikës se rolet e tyre mund të zëvendësohen nga robotët ose avatarët dixhitalë.

Shfaqja e mjeteve të reja të fuqishme si ChatGPT i OpenAI-së ka çuar në pretendimet se humbjet e vendeve të punës në një shkallë të gjerë janë të pashmangshme.

Mjetet e reja mund të përmbledhin e-maillet, të shkruajnë ese dhe të bisedojnë në një mënyrë të frikshme njerëzore, si dhe të bëjnë rekomandime dhe të përpilojnë kërkime.

Në punimin e ri, profesorët Frey dhe Osborne thanë se chatbot-et e reja mund të kryejnë detyra që më parë nuk mendoheshin të mundshme për makinat, ato që “më parë kërkonin inteligjencë sociale njerëzore”.

Tani robotët janë në gjendje të negociojnë, bindin dhe analizojnë



gjuhën.

Punë që nuk rrezikohen nga AI-ja dhe që paguajnë pagat më të larta

Onkolog, ortodont, pediatër, gjyqtar, politikan, operator i pajisjeve të asfaltimit, CEO, inxhinier, kirurg, mami, punonjësi i linjës ajrore, konsulent biznesi, punëtor ndërtimi, drejtues vinçi, shtrues tubash, mekanik, konik, operator, terapist, marangoz, trajner personal, operatorë, gurgdhendës, hidraulik, suvatues, etj., janë disa nga profesionet që AI-ja nuk do të mund t'i zëvendësojë në të ardhmen.

Një numër rolesh që akademikët e Oksfordit më parë nuk mendonin se mund të automatizoheshin tani janë në rrezik.

“Fusha e mundshme e automatizimit është zgjeruar në atë që shumë ndërveprime sociale virtuale tani mund të automatizohen”, - tha raporti, që do të botohet në “Brown Journal of World Affairs”. Prof Frey tha se ndërsa prodhimi aktual i makinerive të AI-së ishte mbresëlënëse, ata ishin ende të prirur të krijonin gjërat në atë që njihet si “halucinacione”.

Në afat të shkurtër, Prof Frey dhe Osborne thanë se ChatGPT dhe robotët e tjerë gjenerues kishin më shumë gjasa të përmirësonin produktivitetin në punët krijuese, në vend që të zëvendësonin punëtorët me shumicë.

Ata shtuan se përhapja e robotëve të AI-së në vendin e punës do të vuante nga “kthimet në rënie”, duke pasur parasysh koston e funksionimit të fuqisë kompjuterike të nevojshme për mirëmbajtjen e këtyre modeleve.



## Si po e shkatërrojmë shtëpinë tonë: Njerëzit kanë tejkaluar gjashtë nga nëntë kufijtë për ta mbajtur Tokën të banueshme

Shoqëritë e përparuara njerëzore u shfaqën gjatë një periudhe të paprecedentë stabiliteti në Tokë. Gjatë 12 000 viteve para Revolucionit Industrial, temperatura e sipërfaqes së planetit tonë varioi me më pak se 1 ° Celsius mbi ose nën mesataren për të gjithë atë periudhë. Si rezultat, jeta, si njerëzore ashtu edhe e egër, lulëzoi.

Por gjatë dy shekujve të fundit, njerëzimi ka rritur në mënyrë dramatike përqendrimin e gazit serrë në atmosferë, duke na shtyrë jashtë kësaj zone klimatike “të sigurt”; jashtë kushteve për të cilat është projektuar qytetërimi.

Fatkeqësisht për ne, ndryshimi i klimës përfaqëson vetëm një nga nëntë kufijtë kritikë planetarë, të cilët veprimet e pakujdesshme të specieve tona rrezikojnë t'i destabilizojnë dhe tejkalojnë në mënyrë të rrezikshme.

Kjo është ajo me të cilën ne njerëzit përballemi si sfida e madhe për të ardhmen tonë të përbashkët: Nëse e mbajmë Tokën brenda

hapësirës së sigurt të funksionimit të kufijve planetarë dhe punojmë dhe integrohemi brenda kufijve të peizazheve të saj, njerëzimi dhe bota mund të lulëzojnë. Por nëse i shkelim këto kufij të përcaktuar shkencërisht, do ta vendosim veten në një zonë rreziku, ku edhe veprimet e vogla mund të shkaktojnë rezultate katastrofike.

Aktivitetet njerëzore kanë bërë që Toka të tejkalojë gjashtë nga nëntë kufijtë e nevojshëm për mbajtjen e planetit të shëndetshëm, duke e shtyrë mjedisin “jashtë hapësirës së sigurt të funksionimit për njerëzimin”, - paralajmërojnë shkencëtarët në një studim të ri të botuar javën e kaluar në “Science Advances”.

Aftësia e Tokës për të mbështetur shoqërinë njerëzore varet nga nëntë “kufijtë planetarë” kryesorë, ose sistemet globale që janë tregues kryesorë të shëndetit të saj.

Në vitin 2009, u publikua Korniza e Kufijve Planetarë, e cila përvijoi nëntë procese kyçe, të ndikuar nga njerëzimi, që kërcënojnë stabilitetin e të gjithë Sistemit të Tokës.

## **Nëntë kufijtë planetarë që njerëzimi duhet t'i respektojë për ta mbajtur planetin të banueshëm**

Korniza e Kufijve Planetarë (përditësuar së fundi në 2015) përcakton nëntë procese kryesore të Sistemit të Tokës dhe vendos kufij të sigurt për aktivitetet njerëzore. Ata janë:

**Ndryshimet klimatike:** Rritja e përqendrimeve të gazeve serrë në atmosferë po çon në rritjen e temperaturave globale. Ne kaluam kufirin e sigurt prej 350 pjesë për milion të CO<sub>2</sub> në 1988. Deri në vitin 2020, nivelet ishin 417 ppm.

**Entitete të reja:** Një nga kufijtë planetarë më të pakapshëm, entitetet e reja i referohen kimikateve, materialeve dhe substancave të tjera të reja të dëmshme (siç është plastika), si dhe substancave që ndodhin natyrshëm si metalet e rënda dhe materialet radioaktive të çliruara nga aktivitetet njerëzore. Ne çlirojmë dhjetëra mijëra substanca sintetike në mjedis çdo ditë, shpesh me efekte të panjohura. Këto rreziqe janë ilustruar nga rreziku që paraqet CFC-të për shtresën e ozonit, ose nga DDT për biodiversitetin.

**Hollimi i ozonit stratosferik:** Hollimi i O<sub>3</sub> në stratosferë si rezultat i ndotësve kimikë u zbulua për herë të parë në vitet 1980 dhe çoi në Protokollin e Montrealit të vitit 1987 mbi Substancat që Hollojnë Shtresën e Ozonit. Shtresa e ozonit tani po tregon shenja rikuperimi.

**Aerosolet atmosferike:** Ndotja nga aerosolet atmosferike është një fatkeqësi për shëndetin e njeriut dhe gjithashtu mund të ndikojë në sistemet e qarkullimit të ajrit dhe oqeanit që ndikojnë në klimën. Për shembull, ndotja e rëndë me aerosol mbi nënkontinentin Indian mund të bëjë që sistemi i musonit të kalojë papritur në një gjendje më të thatë.

**Acidifikimi i oqeanit:** Rritja e niveleve të CO<sub>2</sub> atmosferike po rrit aciditetin e oqeanëve të botës, duke paraqitur një rrezik të madh për biodiversitetin detar dhe veçanërisht për jovetëbrorët, predha e të cilëve treten në ujërat acidike.

**Rrjedhat biogjeokimike:** Ne kemi ndryshuar thellësisht ciklet natyrore të azotit dhe fosforit të planetit duke aplikuar këto lëndë ushqyese jetike në sasi të mëdha në tokën bujqësore, duke çuar në rrjedhje në ekosistemet fqinje.

**Përdorimi i ujërave të ëmbla:** Bujqësia, industria dhe një popullsi globale në rritje po ngarkojnë gjithnjë e më shumë ciklin e ujërave të ëmbla, ndërsa ndryshimet klimatike po ndryshojnë modelet e motit, duke shkaktuar thatësirë në disa rajone dhe përmbytje në të tjera.

**Ndryshimi i sistemit të tokës:** Ndryshimet në përdorimin e tokës, veçanërisht shndërrimi i pyjeve tropikale në tokë bujqësore, kanë një efekt të madh në klimë për shkak të ndikimit në përqendrimet e dioksidit të karbonit në atmosferë, në biodiversitetin, ujërat e ëmbla dhe reflektimin e sipërfaqes së Tokës.

**Integriteti i biosferës:** Integriteti funksional i ekosistemeve është një kufi planetar thelbësor për shkak të shumë ekoserviseve që ato ofrojnë, nga pjalmimi te ajri dhe uji i pastër. Shkencëtarët janë të shqetësuar për rënien e shpejtë të popullatave të bimëve dhe kafshëve, degradimin e ekosistemeve dhe humbjen e diversitetit gjenetik që mund të prishë shërbimet thelbësore të biosferës.

Së bashku, stabiliteti i këtyre nëntë proceseve është thelbësor për ruajtjen e atmosferës së Tokës, oqeanëve dhe ekosistemeve në ekuilibrin delikat që ka lejuar qytetërimet njerëzore të lulëzojnë. Megjithatë, këto janë gjithashtu proceset që aktivitetet njerëzore kanë ndikuar më thellë.



Ajo që ne nuk mund të shohim mund të na dëmtojë: Mikroplastika si këto janë një shembull i entiteteve të reja - materiale, kimikate, grimca nanoteknike, madje edhe forma të reja jete, të krijuara nga njerëzit dhe të lëshuara në mjedis, shpesh me efekte të panjohura. Njësitë e reja mund të përfaqësojnë një kufi të tretë bërthamor, përveç klimës dhe biodiversitetit, për shkak të potencialit për një fatkeqësi globale që rezulton nga një substancë e krijuar nga njeriu që, për shembull, ndikoi në fertilitetin e kafshëve dhe njerëzve.

Nga këto nëntë kufij, njerëzit i kanë kaluar gjashtë: ndryshimi i klimës, integriteti i biosferës (i cili përfshin biodiversitetin), disponueshmërinë e ujërave të ëmbla, përdorimin e tokës, ndotjen e lëndëve ushqyese dhe entitete të reja (që do të thotë ndotje e krijuar nga njeriu, si mikroplastika dhe mbetjet radioaktive). Vetëm kategoritë e acidifikimit të oqeanit, ndotjes së ajrit dhe varfërimit të ozonit mbeten brenda kufizimeve.

Këta kufij nuk janë “pika kthese” nga të cilat është e pamundur të ktheheni. Në vend të kësaj, ata sinjalizojnë ndikimin e njerëzve në mjedis, thonë shkencëtarët.

“Kalimi i gjashtë prej nëntë kufijve nuk është një garanci e fatkeqësisë”, - thotë Elizabeth Claire Alberts nga Mongabay. “Është një thirrje zgjimi; është si presioni juaj i gjakut. Nëse presioni juaj i gjakut është 120 mbi 80, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se do të keni një atak në zemër. Por ju tregon se rreziku është shumë i lartë dhe ju duhet të përpiqeni ta ulni atë poshtë.”

Grupi ndërkombëtar i shkencëtarëve që kreu hulumtimin, i cili bazohet në 2000 studime, e quan atë “kontrollin e parë shkencor shëndetësor për të gjithë planetin”. Ata thonë se gjetja më shqetësuese është se të katër kufijtë biologjikë, të cilët mbulojnë gjallesat, janë tashmë në ose afër niveleve më të rrezikshme.

Vlen të përmendet ashpërsia e ndotjes me lëndë ushqyese, përkatësisht teprica e fosforit dhe azotit në ujërat e Tokës. Këta dy elementë përdoren gjerësisht si plehra të korrave dhe shkaktojnë probleme si lulëzimi i algave dhe zonat e vdekura të oqeanit kur ato lëshohen në mënyrë të rastësishme në ekosisteme.

Studimi thekson se këta nëntë faktorë janë të gjithë të ndërthurur thellë. Në simulime, minimi i një faktori, si klima, minoi të tjerët, siç është biodiversiteti. Megjithatë, forcimi i njërit ndihmoi të tjerët, nga ana tjetër. Për shembull, pastrimi i tokës dhe kthimi i pyjeve në nivelet e fundit të shekullit të 20-të do të ruante më shumë dioksid karboni që ngroh planetin në lëndën bimore, duke ndihmuar në adresimin e ndryshimeve klimatike.

“Unë mendoj se është një sfidë t'u shpjegosh njerëzve se si ndërveprojnë këto gjëra”, - thotë Victor Galaz nga Qendra e Qëndrimit të Stokholmit, i cili fokusohet në qeverisjen e klimës dhe nuk ishte i përfshirë në studim.

Korniza e kufijve planetarë vendos çdo prag bazuar në atë që do t'i mbante kushtet e planetit të ngjashme me atë se si ishin gjatë epokës para-industriale - periudhës 10 000-vjeçare të historisë njerëzore, përpara se shoqëria të fillonte djegien e sasive masive të lëndëve djegëse fosile.

Megjithatë, shumica e matjeve aktuale të përdorura në studim janë pak më të larta se nivelet para-industriale për të pasqyruar aftësinë e natyrshme të Tokës për t'u përshtatur me faktorët stresues. Për shembull, nivelet e dioksidit të karbonit para Revolucionit Industrial matën 280 pjesë për milion, por numri i përdorur si kufi planetar është 350 pjesë për milion. Mesatarja globale e dioksidit të karbonit ka arritur në më shumë se 419

pjesë për milion.

“Ne e dimë me siguri se njerëzimi mund të lulëzojë në kushtet që kanë qenë këtu për 10 000 vjet”, - tha Richardson për “The Guardian”. “Ne nuk e dimë se mund të lulëzojmë nën ndryshime të mëdha, dramatike, dhe ndikimet e njerëzve në sistemin e Tokës në tërësi po rriten ndërsa flasim.”

Shkencëtarët përcaktuan për herë të parë kufijtë planetarë në vitin 2009, kur ata raportuan se tre prej tyre tashmë ishin tejkaluar, dhe përditësuan kornizën në 2015.

Përditësimi më i fundit i këtij viti është i pari që vendos kufizime numerike për të gjithë kufijtë, pasi më parë ishin të papërcaktuara. Për shembull, dokumenti përfshin detaje të reja se si të vlerësohet “integriteti funksional”, ose produktiviteti i bimëve, i cili është një nga faktorët në kufirin e integritetit të biosferës. Ata parashtojnë se për të qëndruar në një nivel të shëndetshëm, njerëzit duhet të përdorin jo më shumë se 10 për qind të biomasës bimore, por aktualisht, ne përdorim rreth 30 për qind, për ushqim dhe karburant. Para Revolucionit Industrial, kjo shifër ishte 2 për qind, raporton “Scientific American”.

Fatkeqësisht, kjo përbën një problem për ata që shpresojnë të adresojnë ndryshimin e klimës, duke ripërdorur sasi të mëdha biomasash për karburant. Përdorimi i më shumë lëndëve bimore për energji do të rezultonte në shtimin e shpyllëzimit dhe humbje të mëtejshme të biodiversitetit.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se njerëzimi ka humbur të gjitha zgjidhjet e mundshme për të luftuar trajektoren e tmerrshme të Tokës. Në fakt, ai që përmirëson kufirin, kufiri i ozonit, po rimëkëmbet falë përpjekjeve të kombinuara globale të iniciuara nga Protokollin i Montrealit në 1987, sipas studiuesve, të cilët



thonë se kjo shkallë ndryshimi të koordinuar është e nevojshme për të adresuar kategoritë e tjera.

“Nga pikëpamja e politikës, ne nuk kemi nevojë për më shumë informacion për të vepruar”, - i thotë Galaz Scientific American.

Ndryshimi i klimës, më i njohuri nga nëntë kufijtë planetarë në të cilët po shkelim, ofron një shembull të mirë se si funksionon ky proces ekuilibri.

Sot, “ne jemi në rrezik për të shkaktuar kthesën e elementeve në Sistemin e Tokës drejt një ‘Toke të nxehtë’ nga e cila do të ishte shumë e vështirë të rikuperohej në klimën para-industriale”, - shpjegoi Steven Lade, një studiues i Qendrës së Rezistencës së Stokholmit.

Megjithatë, “me dekarbonizimin e shpejtë ne mund të arrijmë një ‘Tokë të Stabilizuar’”, - shtoi ai, duke ruajtur klimën tonë brenda dritares së sigurt të kushteve në të cilat njerëzimi është përshtatur gjatë 12 000 viteve të fundit.

Periudha e stabilitetit të klimës së Tokës në të cilën shoqëritë tona kanë lulëzuar njihet si epoka e Holocenit. Duke filluar rreth 12 000 vjet më parë, ajo shënoi fundin e më shumë se 100 000 viteve të periudhave të alternuara akullnajore dhe ndërglaciaie që panë temperaturën e planetit të luhatet deri në 6°C.

Në fakt, shkeljet tona të nëntë kufijve planetarë kanë qenë aq të rënda sa gjeologët besojnë se ne kemi hyrë në një epokë të re në historinë e Tokës. Fillimi i Antropocenit - një periudhë e ndikuar nga njeriu që shkencëtarët thonë se filloi diku midis 10 000 dhe 70 vjet më parë - është shënuar nga rritje të shpejta, të shkaktuara nga njeriu në emetimet e gazrave serrë, ndryshim në shkallë të gjerë të përdorimit të tokës, humbje ekstreme të biodiversitetit, dhe konsumi masiv global dhe ndotja e shkaktuar nga teknologjia



me avancim të shpejtë dhe një popullsi në rritje e Homo sapiens.

### **Paralajmërimet e hershme**

Shkencëtarët tani po zbulojnë dritat e para paralajmëruese që ndezin në panelin e sistemit të Tokës, duke na thënë se njerëzimi tashmë po shtyn përtej hapësirës së sigurt të funksionimit të botës sonë për kufij të shumtë planetar dhe po i afrohet pikave të kthesës.

**Një shembull:** shkrirja e shtresave të akullit të Grenlandës dhe Antarktidës Perëndimore është përshpejtuar që nga fillimi i viteve 1990, duke sugjeruar se këto depozita kolosale akulli mund të kenë hyrë tani në një gjendje të re tërheqjeje të qëndrueshme dhe në përshkallëzim, pas shumë shekujsh stabiliteti. Në këto shtresa akulli tani të cenueshme, ka ujë të mjaftueshëm për të ngritur nivelin global të detit me më shumë se 65 metra.

Në mënyrë të ngjashme, akulli i detit Arktik po tërhiqet dhe shkencëtarët parashikojnë se rajoni mund të jetë kryesisht pa akull në verën e vitit 2035 - pa siguri se çfarë ndryshimesh ekstreme mund të sjellë kjo.

Shenja të tjera paralajmëruese të hershme që po i afrohem një pike kthese të ndryshimeve klimatike përfshijnë thatësitat gjithnjë e më të shpeshta dhe të rënda, valët e të nxehtit, stuhitë dhe ciklonet tropikale.

“Numri i fatkeqësive natyrore të lidhura me klimën po rritet me një ritëm alarmues, me ndikime të rëndësishme ekonomike dhe shëndetësore, veçanërisht për më të cenuarit”, - thotë Ana María Loboguerrero Rodríguez, kreu i Kërkimit të Politikave Globale për Programin Kërkimor CGIAR mbi Ndryshimet Klimatike.

### **Ka edhe shpresë**

Ekspertët po bëjnë thirrje për një qasje transformuese, gjithpërfshirëse për të shmangur pikat e rrezikshme, duke e parë të gjithë Sistemin e Tokës si një pjesë të përbashkët globale, me njerëzit si kujdestarë. Natyra e ndërthurur e këtij kuadri kërkon zhvillimin e një qasjeje të re të qeverisjes në shkallë globale, rajonale dhe lokale.

Një kuadër i tillë është aleanca “Global Commons”, e cila bashkon më shumë se 50 OJQ ndërkombëtare, korporata shumëkombëshe dhe politikëbërës, për të promovuar miratimin e objektivave të bazuara në shkencë për të vepruar brenda kufijve planetarë.

Ky është një qëllim i frikshëm global. Por ka një kufi planetar, i pari që kuptuam se ishim në rrezik kalimi, që ofron shpresë: shterimi i shtresës së ozonit. Në vitin 1987, kombet e botës njohën urgjencën dhe vlefshmërinë e shkencës dhe përqaftuan kërkesat politikisht detyruese të Protokollit të Montrealit. Ne u larguam nga buza, duke tkurrur vrimën e ozonit, e cila tani mund të shërohet deri në vitin 2050. Nëse kombet mund të bashkohen për të trajtuar ndryshimet klimatike, humbjen e biodiversitetit dhe ndotjen, siç bënë për të adresuar kërcënimin ndaj shtresës së ozonit, atëherë ekziston mundësia që ne të mund të kthejmë tendencat aktuale dhe të kthejmë trajektoren e Tokës drejt një gjendjeje të qëndrueshme holocenike. Kjo mundësi po zbehet, por është një përpjekje që duhet të bëjmë absolutisht.



# ***Historia e krijimit të qyteteve shqiptare***

**P**rejardhja e përkatësisë së zonave urbane të Shqipërisë është e larmishme. Ajo kalon përmes një përshkimi historik që nga kohët e hershme, deri tek të vonat, tek qytezat industriale.

Emri dhe origjina e këtyre qyteteve është një lëm i pasur me trajtesa dhe përkatësi toponimesh, disa prej të cilave të huazuara nga ndikimet e huaja, të përftuara nga rrethana historike dhe gjeografike.

## **TIRANË**

Origjina e emrit: (Katër variantet)

“Tirana” mendohet se vjen nga fjala “Theranda”, e përmendur në burimet e lashta greke dhe latine, që vendasit e quanin “Te Ranat”, meqë fusha ishte formuar si rezultat i materialeve të ngurta që sillnin ujërat nga malet përreth.

“Tirana” vjen nga “Tirkan”. Tirkan ka qenë një kështjellë në shpat





të Malit të Dajtit. Edhe sot e kësaj dite ekzistojnë rrënojat e kësaj kështjelle të lashtë që daton në fillimin e shekullit I para Krishtit. Kjo mendohet të ketë qenë kështjella që historiani bizantin Prokop, (shek.VI), e quan Kështjella e Tirkanit.

“Tirana” vjen nga greqishtja e vjetër, “Tyros” që do të thotë bulmet. Mendohet se ky variant ka mbetur ngaqë në fushën e Tiranës bëhej tregtimi i bulmetrave nga barinjtë e zonave përreth. Tiranë vjen nga Teheran, kryeqytet i Iranit, në kujtim të një fitoreje të korrur nga Sulejman Pasha, (themeluesi i qytetit) në krye të ushtrisë turke gjatë fushatës në Persi.

Me siguri dihet që për herë të parë emri i Tiranës përmendet në vitin 1418 në një dokument të Venedikut.

Themeluar: më 1614 nga Sulejman Pashë Bargjini.

Gjurmët më të vjetra: Tirana u themelua si qytet më 1614, por toka mbi të cilën u ndërtua ka gjurmë më të hershme banimi. Nga faktet e gjetura në rrënojat e një kështjelle ka mundësi të bëhet fjalë mbi një kështjellë të cilën Prokopi von Caesarea në shekullin e gjashtë e ka quajtur “Tirkan”.

Shpallet kryeqytet: më 20 shkurt 1920.

Objektet kryesore: Të gjitha institucionet shtetërore më të rëndësishme të shtetit, kështjella e Petrelës, Kalaja e Pezës, Xhamia e Et’hem Beut në qendër të Tiranës, Muzeu Kombëtar, Muzeu Arkeologjik, Galeria e Arteve.



## DURRËS

Origjina e emrit: Durrahium.

Emra të mëparshëm: Epidamus.

Themeluar: në vitin 627 para Lindjes së Krishtit.

Pushtuar: në 314 B.C. nga Aleksandri i Maqedonisë dhe në vitin 229 B.C. ai u pushtua nga romakët, më pas nga otomanët, serbët dhe italianët.

Objekte kryesore: Amfiteatri, Forumi bizantin, Muzeu Arkeologjik, ku janë të paraqitura periudhat greke dhe romake, Torra Veneciane, Xhamia e Fatihut, Monumenti i Rezistencës, Muzeu Etnografik etj. Karakteristika:

Durrësi mund të krahasohet me qytetet më të mëdha të Mesdheut të lashtë dhe mesjetar. Qyteti Dyrrah u ndërtua nga ilirët, taulantë, dallëndyshasit në shekujt XIII-XI p. K. Banorët e parë të Dyrrahut, para ilirëve të quajtur protoilir, pellazgë, ngritën në rrethinat e këtij qyteti, vendbanimet e para parahistorike.

Në afërsi të Shkëmbit të Kavajës është zhvilluar beteja e famshme mes Çezarit dhe Pompeut. Në vitin 1200, pas një cunami, qyteti nuk është banuar për 6 vjet.

Ka qenë kryeqytet.

Ka portin më të madh në Shqipëri.





## LEZHË

Origjina e emrit: Lissus.

Themeluar: 669 para Lindjes së Krishtit.

Në vitin 1300, ndërtohet kalaja e qytetit.

Deri në vitin 1398 qyteti ishte në dorë të familjes feudale të Dukagjinaseve, të cilët më pas ia lëshuan Venedikut.

Ngjarje kombëtare: 2 mars 1444, u mbledh “Kuvendi i Lezhës” nën drejtimin e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Kuvendi formoi një lidhje politike-ushtarake të princërve shqiptar, duke formuar një ushtri shqiptare prej 10 mijë trupash kundër rezikut osman.



## KORÇË

Origjina e emrit: Gjoriçë, Goriçë. (Por edhe sot asnjë studiues nuk ka një ide të qartë se nga vjen emri i qytetit të Korçës).

Gjurmët e vjetra: Zona e Korçës e ndodhur në kufi me Mbretërinë Ilire dhe Epirin është banuar që nga mijëvjeçari i katërt p.e.s.

Themelimi: Qyteti modern i Korçës u formua në shekullin XV, kur Iljaz Bej Mirahorie zhvilloi Korçën sipas urdhrat të Sulltan Mehmetit II. Nën pushtimin osman Korça me emrin “Göricë” ishte sanxhak i vilajetit të Manastirit.

Data me rëndësi kombëtare: Është hapur shkolla e parë shqipe në këtë qytet që daton në vitin 1887, shkolla e parë në Shqipëri për vajza, si dhe liceu Francez i ndërtuar në vitin 1917.





## VLORË

Origjina e emrit: Aulona

Gjurmët më të hershme: Shekulli i 6-të para lindjes së Krishtit. Duke qenë një nyje e rrugëve tokësore e detare, i njohur për verën, ulla, ullinjtë e kripën, u bë porti kryesor i Ilirisë pas rënies së Apolonisë e Orikumit.

Data me rëndësi kombëtare: Më 28 Nëntor 1912, u shpall Pavarësia e Shqipërisë, Lufta e Vlorës, 1920.

Pushtuar: Nga normanët më 1081, 1205 nga Venediku, më pas nën sundimin e Hohenshtaufëve gjermanë dhe më 1272 në mbretërinë e Arbërisë. U pushtua nga osmanët më 1417, italianët, gjermanët.

Objektet kryesore: Kalaja, porti, etj.

Aktualisht ka 124 mijë banorë.



## ELBASAN

Origjina e emrit: Në shekullin e 2-të para Krishtit njihej me emrin Skampa dhe më vonë Skampini. Elbasani u themelua nga Sulltan Mehmeti II në shekullin XV. Lu vu ky emër sepse ishte një ndër trevat e para të pushtuara nga osmanët, ELI-BASAM (vura dorë). Themelimi: nga osmanët në shekullin 15.

Ndërtimi i kalasë së qytetit: më 1466 për 25 ditë dhe për të punuan 150 mijë njerëz.

Gjurmët më të hershme: Historia e trevave të Elbasanit e ka zanafillën e saj në shekullin II p.e.s. me vendbanimet e hershme ilire. Të dhënat arkeologjike besohet se emri i parë i Elbasanit ka qenë mansius që do të thotë vend-qëndrim.

Data me rëndësi kombëtare: Më 2-9 shtator 1909 u thirr Kongresi i Elbasanit, ndër vendimet më kryesore të të cilit qe hapja e Shkollës Normale.

Pushtuar: Romakët, turqit, italianët e gjermanët.

Objektet kryesore: Kalaja, banjat turke, stadiumin "Elbasan Arena".





### **GJIROKASTËR**

Origjina e emrit: Qyteti e ka marrë emrin sipas fjalës greke argjend, Argyrókastron, që lidhet me ngjyrën e përhime të mureve, rrugëve dhe çative prej guri, të cilat vezullojnë si argjend kur lagen nga shiu. Një shpjegim tjetër lidhet me emrin e një fisi vendas që jetonte pranë Gjirokastrës: Argjirët. Për herë të parë emri i Gjirokastrës përmendet në shekullin XIII. Kështjella e Gjirokastrës mendohet të jetë filluar nga prijësi shqiptar Gjin Bue Shpata, i cili i dha dhe emrin qytetit, Gjirokastrë. Zgjerimet e kështjellës janë bërë nga Ali Pashë Tepelena, dhe nga qeveria e Zogut, e cila më pas e konvertoi pjesën veriore të kalasë në burg.

Objektet kryesore: Në Gjirokastrë gjendet kalaja më e madhe e Shqipërisë. Aty mund të vizitoni Muzeun e Armëve, i cili gjendet brenda në kala, Muzeun Etnografik, i cili gjendet në shtëpinë ku ka lindur ish-diktatori komunist Enver Hoxha si dhe muzeun e ri në shtëpinë e shkrimtarit me famë botërore, Ismail Kadare.

Në vitin 1963 shpallet Qytet-Muze.

Në vitin 2005, shpallet Pasuri Botërore nga UNESCO.



### **BERAT**

Origjina: Berati u përket qyteteve të rrallë, ku jeta fillon qysh në lashtësinë e thellë dhe vazhdon pa u ndërprerë deri më sot. Dy çekanë guri e datojnë fillimin e jetës në të para Periudhës së Bronzit (2600-1800 P.Kr.). Dëshmitë arkeologjike tregojnë se në shek. VII-VI P.Kr. këtu është zhvilluar një vendbanim paraqytetar, me punishtet e tij të qeramikës dhe me një jetë shoqërore të diferencuar. Në kufijtë e legjendës dhe të historisë, ky vendbanim thuhet të ketë qenë Orestida e lashtë, i quajtur kështu ngaqë aty banonin një fis i pellazgëve, orestët, i pari i të cilëve ishte Oresti, i biri i Agamemnonit.

Themelimi: 313-310 Para Krishtit si qytet-kështjellë i Dasaretisë, i quajtur Antipatrea.

Emrat që ka përdorur: Antipatrea, Albanorum Oppidum, Pulheriopolis.

Gjurmët e para: 2600 para Krishtit.

Pushtuar nga grekët, maqedonasit, bullgarët, osmanët.

Në vitin 1961 shpallet Qytet Muze.

Në vitin 2008 shpallet Pasuri Botërore nga UNESCO.

Objektet kryesore: I gjithë qyteti, Kalaja, Ura e Goricës, etj.



## SHKODËR

“Një njeriu të zakonshëm, të ardhur nga qyteti ortodoks i Manastirit, Shkodra i duket fillimi i Europës” – Ismail Kadare.

Orgjina e emrit: Skodrin, ose vendi ku shkon Drini, Skutari.

Themelimi: Mes shekullit të 5-të dhe 6-të para Krishtit.

Gjurmët e vjetra: Paleoliti (guri i vjetër), Neoliti.

Ka qenë kryeqytet i mbretërisë ilire në 181 Para Krishtit.

Pushtuar: Në vitin 168 nga Roma, sllavët, bullgarët, Venediku, turqit, serbët, malazezët, italianët, gjermanët.

Objektet kryesore: Kalaja e Rozafës, Muzeu Historik, Fototeka Marubi, etj.



## KAMZA

Deri në vitin 1990: Një qendër e banuar e Ndërmarrjes Bujqësore të Tiranës.

Pas vitit 1990: Popullohet me të ardhur nga qytete dhe fshatra të ndryshëm.

Sot: Një nga bashkitë dhe qytetet me dendësinë më të madhe në vend.

Karakteristikë: Një zonë periferike e Tiranës që pret të sistemohet falë një plani urbanistik.



## KONISPOL

Qytet i ndërtuar si fillim për të rinjtë aksionistë që hapën tarraca për agrume.

Fillimet: Në vitet '70.

Karakteristikë: Kultivimi i agrumeve dhe zonë plazhi.



## KSAMIL

U ngrit si qytezë bregdetare gjatë periudhës komuniste. Në nëntor 1966, Enver Hoxha porositi që në këtë vend të bukur dhe të virgjër të ngrihej një qendër e prodhimit të agrumeve dhe ullirit. Kështu “lindi” Ksamili, vetëm 5 km larg Butrintit, përballë ishujve piktoreskë, në gadishullin e Heksamilit, (gjashtë miljeve nga Butrinti). Peizazhit të bukur të detit dhe kodrave i shtohen dy ngjyrat jetësore, e kaltra dhe e blerta, që e hijeshojnë edhe më tepër gjirin e Ksamilit, i cili ndodhet pothuaj përballë ishullit më të madh të Jonit, Korfuzit.



### KRASTA

Qytet i ri minatorësh në rrethin e Matit. Ka qenë pjesë e fshatit Gjon të Martaneshit. Ndërtimi filloi më 1970 me ngritjen e minierës së Kromit në Batër. Më 1974 u vendosën banorët e parë. Më 1979 u shpall qytet.

### MALIQ

Themelimi: Pas Luftës së Dytë Botërore, pas tharjes së kënetës.

Gjurmët e vjetra: Në Maliq janë zbuluar gjurmët më të vjetra në Shqipëri që i përkasin kohës së Neolitit.

### LESKOVIK

Administrimi: Ish-pjesë e rrethit të Kolonjës, sot në qarkun e Korçës.

Origjina e emrit: Nuk gjenden të dhëna.

Themelimi: Vend pushimi për bejlerë në kohën osmane.

Gjurmët e vjetra: Në lashtësi.

Karakteristikë kryesore: Ujërat termale, muzika popullore, sazet Aktualisht ka ereth 4 mijë banorë.

### SHIJAK

Origjina e emrit: Me këtë emër që ka sot, Shijaku njihet që para Mesjetës. Toponimi gjeografik i Shijakut është me prejardhje fetare nga Shën Jaku, ku fillimisht është quajtur Shen Jak, Shenjak, Shejak, Shinjak e më pas Shijak.

Themelimi: I lidhur gjithnjë me qytetërimin e Durrësit.

Gjurmët e vjetra: Gjurmët më të vjetra të jetës njerëzore i përkasin kohës së Gurit të Ri, gjë që vërtetohet nga objekte të gjetura si: çekanë, sëpata prej



guri të lëmuar etj. Në zonën e Shijakut janë gjetur prefëse të po kësaj periudhe.

### BILISHT

Origjina e emrit: Nga maqedonishtja, Bilišta-Bilisht.

Themeluar: Si qendër e banuar, Bilishti është rreth 3000-vjeçar dhe kjo dëshmohet nga mbeturinat e një kalaje ilire në një nga kodrat mbi qytet. Gjurmët e saj të fundit u zhdukën në fillim të viteve '70 të shekullit XX, kur gurët u përdorën për ndërtimin e objekteve publike ose private.

Karakteristika: Shkolla e parë që u hap në këtë qytet daton në vitin 1917.

Aktualisht ka: 12 mijë banorë.

### CËRRIK

Themeluar: Në vitin 1947 me krijim e Ndërmarrjes Bujqësore Ushtarake.

1956-1957 është ndërtuar Uzina e Përpunimit të Naftës.

Objektet kryesore: Radiostacioni, Instituti i Duhanit, Sektori Pyjor i Përpunimit, i Tregtisë, TELEKOMIT, ELEKTRIKUT, i Shërbimit Komunal (janë mbyllur pas viti 1990).

### MEMALIAJ

Themeluar: në vitin 1946 si qendër industriale për prodhimin dhe shfrytëzimin e mineralit qymyrguri.



Objektet kryesore: Miniera e Memaliajit.

Karakteristika: Në vitin 1990 arriti kapacitetin e prodhimit të qymyrgurit 500.000 tonë në vit. Qymyret e Memaliajit radhiteshin në qymyret e para për fuqinë kalorifike me vleftë 4500-4700.

### ORIKUM

Themeluar: Është themeluar si koloni mbi ndonjë vendbanim ilir më parë se shekulli VI p.e.s.



U krijua si qendër bashkie në vitin 1960 dhe u emërtua si një qytezë ushtarake. Ndërsa si qendër e banuar, lagjja më e vjetër e këtij qyteti njihet me emrin “Lagjja e Fermës”, është formuar në vitin 1949.

Tradicionalisht mbahet si qendër e themeluar nga kolonialistët Eubeas, që u kthyen nga lufta e Trojës, por në të vërtetë duhet të jetë themeluar nga Apolonia për të kontrolluar guroret e Akrokerauneve.

Emrat e mëparshëm: Erihoi.

Objektet kryesore: Monumenti më i njohur është teatri, i cili është hapur gjatë gërmimeve arkeologjike të vitit 1958.

Aty përveç shfaqjeve teatrale zhvilloheshin dhe ndeshje me gladiatorë.

Karakteristika: Qyteti luajti një rol të rëndësishëm në betejën e romakëve kundër Filipit të V të Maqedonisë si dhe në betejat e Cezarit kundër Pompeit në Orikum që janë dokumentuar në luftërat civile të Cezarit.

Është një nga vendet më turistike shqiptare.

Është qyteti antik më i mbrojtur, sepse është në hapësirën e paprekur të Pashalimanit.

Në 1989 gërmimet nxorën në dritë një varrezë, e cila mendohet të jetë helenistike.

Orikumi është shpallur park arkeologjik kombëtar.

#### **BALLSH**

Themeluar: Në shekullin e 4-t para lindjes së Krishtit.

Objektet kryesore: Kompania e Naftës “Armo”

Karakteristika: Është një qytet shumë i vjetër ilir, janë akoma rrënojat e Bylisit të vjetër.



Është cilësuar si një qytet arkeologjik afër Bylisit.

Është një nga qytet kryesore në Shqipëri për nxjerrjen e naftës.

Aktualisht ka: 39 mijë banorë.



#### **FIER**

Origjina e emrit: Ekzistojnë dy hipoteza:

E para, paraqet variantin e emrit Fier që vjen nga italishtja FIERA, d.m.th treg ose panair.

E dyta, bazohet tek toponimi i rajonit. Duke qenë se shumica e tyre janë me origjinë bimore, ajo thekson se emri i qytetit të Fierit rrjedh nga bima e fierit që rritej me shumicë në këtë vend.

Themeluar: Në vitin 558 p.e.s., në një kodër pranë detit dhe afër grykëderdhjes së lumit Aoos ( Vjosa) nga kolonë të ardhur nga Korinti e Korfuzi.

Objektet kryesore: Qyteti antik i Apolonisë, Muri rrethues, Biblioteka, Odeoni, Portiku dhe Kisha Bizantine e shekullit XIII.

Karakteristika: Ndodhet në rrënojat e qytetit antik të Apolonisë.

Në periudhën ‘45-‘90, Fieri kthehet në një nga qendrat më të rëndësishme industriale të vendit.

#### **ÇOROVODË**

Origjina e emrit: (nga sllavishtja) Çornnaja Voda (Uji i Zi)

Themeluar: në vitin 1912.

Objektet kryesore: Kanionet e Osumit, Teqeja e Kulmakut, Tyrbeja e Abaz Aliut, etj.

Karakteristikë: Dallohet për rakinë e famshme të rrushit.





“Ne kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet”

26 shtatori është Dita Evropiane e Gjuhëve e përcaktuar nga Komiteti Evropian.

Historia e promovimit të gjuhës shqipe krahas gjuhëve të tjera evropiane i ka fillesat shumë herët. Ja disa nga shembujt e shtypit shqiptar që kanë promovuar kulturën, traditën e mbi të gjitha gjuhën shqipe:

“Flamuri i Arbërit”, gazetë e botuar në gjuhën shqipe dhe italiane më 1883 dhe me një jetëgjatësi deri në vitin 1887, nën kujdesin e Jeronim De Radës, do të shënonte fillesat e shtypit shqiptar.

“Sqipëtari”, gazetë e botuar nga shoqëria e Bukureshtit “Drita”. Numri i parë i gazetës doli më 7 gusht 1888, me një format dygjuhësh, shqip dhe rumanisht, drejtuesi i saj ishte Nikolla Naço.

“L’ Albania - Albania”, ishte revistë dygjuhëshe (shqipe dhe frënge) e drejtuar nga Faik Konica që ishte edhe kryeredaktor i revistës me pseudonimin Trhank Spirobeg. Numri parë i saj u botua më 25 mars të vitit 1897. Ishte e përmuajshme politike, kulturore e letrare, që u bë tribunë e mendimit të atdhetarëve përparimtarë shqiptarë jashtë Shqipërisë (Filip Shiroka, Luigj Gurakuqi, Andon Zako, Çajupi, Hilë Mosi, Fan Noli). Kjo revistë deri në vitin 1901 u botua në Bruksel dhe nga viti 1902 e më pas në Londër.

“Lajmëtari i Shqipërisë”, gazetë e përjavshme në gjuhën shqipe dhe italiane. Kjo gazetë e pa dritën e botimit në Romë, në vitin 1904 nën drejtimin e Gasper Jakova Mërturi.

#### **Sa i rëndësishëm është komunikimi shumëgjuhësh?**

Më shumë se kurrë gjuha dhe komunikimi përfaqësojnë aspekte qendrore të shoqërisë sonë. Mësimi i gjuhës ofron

një mënyrë për të hapur mendjet tona ndaj perspektivave dhe kulturave të reja. Dita Evropiane e Gjuhëve është një mundësi për të festuar pasurinë gjuhësore që përfaqësohet nga 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo është një kujtesë për përfitimet e shumta nga të mësuarit e gjuhëve, për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave njohëse e rrëzimin e barrierave kulturore. Kjo festë u hap derën miqësive të reja dhe mundësive profesionale.

Një nga objektivat e përgjithshme të Ditës Evropiane të Gjuhëve është të inkurajojë të nxënit gjatë gjithë jetës, brenda dhe jashtë shkollës, për studime, nevoja profesionale, udhëtime për kënaqësi, shkëmbime miqësish etj. Ne duhet të jemi të hapur me të tjerët, ta ushqejmë tolerancën dhe ta refuzojmë gjuhën e urrejtjes. Rruga drejt vlerave nënkupton edhe njohjen e më shumë se dy gjuhëve të huaja (së paku gjysma e popullsisë botërore janë dygjuhësh ose shumëgjuhësh). Çdo zë, pa marrë parasysh se në ç’ gjuhë thuhet, duhet të respektohet. Dygjuhësia dhe shumëgjuhësia sjellin avantazhe ekonomike si për shembull punët gjenden më lehtësisht nga ata që flasin gjuhë të huaja, kompanitë shumëgjuhëshe janë faktor konkurrues më të mirë se ato njëgjuhëshe.

Gjuhët janë të lidhura me njëra-tjetrën si anëtarët e një familjeje. Si rezultat i fluksit të emigrantëve dhe refugjatëve, Evropa është bërë gjerësisht shumëgjuhëshe. Vetëm në Londër fliten rreth 300 gjuhë. Aktualisht në botë ka rreth 7000 gjuhë të folura nga 7.7 miliardë njerëz. Në Evropë, ndërkaq, ka 225 gjuhë, afërsisht 3% e totalit botëror.

*Kujdes me gjuhët e huaja pa mësuar bukur gjuhën amtare!*



# FIÀMURI ARBËRIT

La Bandiera dell' Albania

PUBBLICAZIONE PERIODICA MENSILE  
PER CURA D' UN COMITATO DI SIGNORI D' ALBANIA E DELLE SUE COLONIE

Lettere pùblici ed altre invianti, franco di  
porto, all'incaricato della Direzione signor  
**Girolamo de Rada**, in MAKI, vicino  
di S. DEMETRIO-CORONE.



ABBONAMENTO ANNUO  
Per l'Italia - - - - - L. 5,00  
Per l'Estero - - - - - 6,50  
Non si restituiscono i manoscritti.

Filip Shiroka ka thënë: “Ne kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet”. “Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij”- Eqerem Çabej. Ne duhet të jemi të lumtur sepse gjuha shqipe ka pasuri fjalësh, plot jetë e gjallëri, thotë Fishta, e nëpërmjet saj mund të

përkthehen veprat e çdo kombi dhe të çdo kohe.

“Komunikimi duhet të jetë në themelin e arsimit gjuhësor.”

“Të dish dhe të zotërosh një gjuhë të huaj është një pasuri e vërtetë.” Gjuha është e lidhur me komunikimin, ajo nuk është thjesht një ushtrim gramatikor, fjalor ose fjalim, por një grumbull mjeshtëri të njeriut, dëshira dhe motivacioni për të biseduar.





# Ushtria, aty ky nisi rruga për shumë nga yjet e Hollivudit

**Y**jet që kanë shërbyer në ushtri janë njësoj si më shumë se 17 milionë veteranë amerikanë: Në një moment të jetës së tyre, ata ose u rekrutuan ose dolën vullnetarë për t'i shërbyer vendit të tyre. Madje, disa prej këtyre personazheve publike i kanë çuar aftësitë që kanë mësuar në stërvitje apo luftime në karrierën e tyre si aktorë, këngëtarë dhe humoristë. Chuck Norris ishte në gjendje të interpretonte marifetet e tij në filma për shkak të kohës së tij në ushtri - dhe madje ndihmonte në përgatitjen e aktorëve të tjerë për aksion në film. Ylli i Star Wars, Adam Driver, pa lidhjet midis dy profesioneve aq fort sa që filloi një organizatë jofitimprurëse që i kombinonte ato. Por edhe më tej se trajnimi fizik, disa aktorë kanë aplikuar rritjen e tyre emocionale që nga koha e tyre në shërbim deri në kohën e tyre në ekran.

Nga Norris dhe Presley deri te Morgan Freeman, këtu janë disa nga yjet e Hollivudit që kanë shërbyer në ushtri.

## Clint Eastwood

Pas shkollës së mesme dhe 'Depresionit të Madh', Eastwood u dërgua në ushtri gjatë Luftës së Koresë. Vitet e shërbimit të tij i kaloi si roje shpëtimi ndërsa ishte i stacionuar në Kaliforni. Falë G.I. Bill, ai ishte në gjendje të ndiqte shkollën e dramës në Kolegjin L.A. Ai tërhoqi vëmendjen e "Universal Studios" dhe nënshkroi një kontratë që nisi karrierën e tij në filmat perëndimor. Duke filluar me "Francis in the Navy" (1955) dhe "Revenge of the Creature" (1955), ai më vonë u bë një ikonë e Hollivudit, e njohur për "Sudden Impact" dhe "Unforgiven", për të cilat fitoi një 'Oscar'. Ai gjithashtu u bë një potencial i trefishtë i Hollivudit si regjisor, aktor dhe producent, duke fituar Oscar për të gjitha ato role.



Clint Eastwood



Vitet e shërbimit: 1951-53



Betty White

#### Betty White

Ylli i ndjerë i “Golden Girls”, Betty White, u njoh nga ushtria amerikane për shërbimin e saj pas vdekjes së saj, më 31 dhjetor 2021.

“Ajo jo vetëm që ishte një aktore e mrekullueshme, ajo gjithashtu shërbeu gjatë Luftës së Dytë Botërore si anëtare e Shërbimeve Vullnetare të Grave Amerikane. Një legjendë e vërtetë brenda dhe jashtë ekranit”, - shprehen ata. Instituti Detar i SHBA-së sqaroi më tej se ajo “ngiste një kamion furnizimi” gjatë kohës së saj në ushtri.



Adam Driver


Para ditëve të tij të aktrimit, 17-vjeçari Adam Driver iu bashkua marinsave menjëherë pas sulmeve të 11 shtatorit 2001.

“Unë u bashkova ... duke u ndjerë sikur shumica e njerëzve në vend bënë në atë kohë, të mbushur me një ndjenjë patriotizmi dhe ndëshkimi dhe dëshirën për të bërë diçka. Kjo, së bashku me atë faktin se nuk po bëja asgjë”, shprehej ai.

Aktorit të “Star Wars” i pëlqente të ishte me Marinsat, por u lirua nga mjekësia pas dy vitesh shërbim.




Clint Eastwood



**Morgan Freeman**

Para karrierës së tij si fitues çmimesh, Freeman u regjistrua në Forcat Ajrore Amerikane dhe u trajnuar për të qenë pilot luftarak. Megjithatë, ajo aspiratë për aviacionin arriti në një ulje aksidentale. Ai është shprehur për “AARP Magazine” se ishte “vetëm i dashuruar me idenë e fluturimit” dhe kishte këtë “ndjenjë të veçantë se ai ishte ulur në hundën e një bombe” kur ishte brenda kabinës së një avioni. Ai u largua nga ushtria pas katër vjetësh për të ndjekur pasionin e tij origjinal: aktrimin. Dy dekada me aktrim të përkushtuar në skenë më vonë, Freeman mori rolin e tij të rëndësishëm në serialin “Një Botë tjetër” dhe përfundimisht u bë një film i rregullt pas shfaqjes së “Shawshank Redemption” të vitit 1994, me tituj duke përfshirë, “Outbreak”, “Kiss the Girls” dhe vazhdimin “Along Came a Spier”, “Deep Impact”, “Bruce Almighty” dhe vazhdimi i “Evan Almighty”, “Million Dollar Baby” dhe “Gone Baby Gone”. Ai gjithashtu ka një kompani produksioni me tituj që përfshirë seriale të tilla me skenar si “Madam Secretary” dhe seriale si, “Through the Wormhole” dhe “The Story of God With Morgan Freeman”.



Vitet e shërbimit: 1955-59



**James Earl Jones**

James Earl Jones, i cili është i njohur për rolin e tij në zërin e “Darth Vader” në “Star Wars”, iu bashkua ushtrisë gjatë Luftës së Koresë. Ai ishte në rrugën e tij të mirë për një karrierë të përjetshme në ushtri, duke kaluar nga toger i dytë në toger i parë, ndërsa stërviste shokët e tij në Kolorado. Pas vetë-reflektimit të vazhduar, ai vendosi të largohej nga ushtria në vend të një karriere të suksesshme televizive, filmike dhe teatrore. Dikush mund të mendojë se zëri i tij dallues e i fortë (është e vështirë të besohet se ai ka pasur ndonjëherë probleme me artikullimin) do t'i kishte shërbyer mirë si oficer komandues, por atëherë publiku më i madh nuk do të kishte përjetuar talentin e tij si Mufasa në “Mbreti Luan” i “Disney-t” (1994 dhe 2019) dhe Darth Vader në ekskluzivitetin e “Star Wars” dhe rolet e tij si Terence Mann në “Field of Dreams” të vitit 1989 dhe “King Jaffre Joffer” në “Coming to America” të vitit 1988 dhe vazhdimin e tij në 2021.




James Earl Jones  
Vitet e shërbimit: 1953-62




### Chuck Norris

Ai iu bashkua Forcave Ajrore pas shkollës së mesme përpara se të bëhej një forcë e filmit aksion. Ndërsa ishte në Kore, Norris u ekspozua ndaj botës së arteve marciale, sfida të tilla që e përgatitën atë për role si “Way of the Dragon” (1972, përballë Bruce Lee) dhe një nga rolet e tij kryesore, “Walker, Texas Ranger” (1993-2001). Ai ishte njeriu i parë perëndimor që fitoi një brez të zi të shkallës së tetë në Tae Kwan Do. Nga student në mjeshtër, ai i kaloi vitet e tij, pasi u la në hije nga aktorët e trajnimit ushtarak si Priscilla Presley dhe Steve McQueen, në artet marciale. McQueen e bindi Norris të ndiqte aktrimin, gjë që çoi në një karrierë të lulëzuar në televizion dhe film.



### Elvis Presley

Mbreti i Rock-ut shkëmbeu shkurtimisht “Këpucët e tij prej kamoshi blu” dhe prerjen ikonë të flokëve për një më të shkurtër dhe një uniformë ushtrie, kur u dërgua në detyrë në vitin 1957. Ai hyri në ushtri në vitin 1958. Epoka e tij si reshter i ushtrisë shërbeu si prag midis Elvisit në kulmin e tij dhe “Elvisit të pjekur”. Është raportuar gjerësisht se një nga shokët e tij ushtarakë e prezantoi atë me drogat që mund të kenë qenë përgjegjëse për vdekjen e tij dhe varësia e tij përkoi me kthimin e tij në një mbretëri rock 'n' roll-i që ishte ndryshe nga ajo që kujtonte.





Tom Selleck  
Vitet e shërbimit: 1967-73

### Tom Selleck

Ylli i "Blue Bloods" e ka kaluar pjesën më të madhe të karrierës së tij të aktrimit duke mbrojtur civilët si hetues privat apo shef policie, por ka qenë një kohë kur ai po mbronte vendin e tij në jetën reale. Koha e nënshkrimit të Selleck në programin e talenteve të "20th Century Fox" u ndërpre kur ai mori një thirrje për armë gjatë Luftës së Vietnamit. Ai u bë rreshter në Gardën Kombëtare të Ushtrisë së Kalifornisë. Aktiviteti i tij



si model gjatë ditëve të tij në USC erdhi në ndihmë kur Garda Kombëtare vendosi ta bënte Selleck yllin e posterave të saj të rekrutimit. Karriera e tij shkoi përpara 11 vjet më vonë, kur ai luajti si ylli i "Magnum P.I." (1980-88). Që atëherë, veterani është ftuar në shumë shfaqje dhe filma të shquar televizivë, duke përfshirë "Friends" (nga 1996-2000), ekskluzivitetin e filmave televizivë "Jesse Stone" dhe "Blue Bloods" të CBS. Një film televiziv i 10-të Jesse Stone është shpallur gjithashtu.



# 81 vjet nga Konferenca e Pezës

Më 16 shtator të vitit 1942 u mbajt Konferenca e Pezës, e cila pati për qëllim organizimin e forcave të ndryshme politike në një luftë të përbashkët kundër Italisë fashiste. Më vonë ky organizim mori emrin Fronti Nacional-Çlirimtar.

Konferenca e Pezës u mbajt në Pezë, një fshat pak kilometra larg nga Tirana. Protagonistë të këtij kuvendi ishin 20 delegatë përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasa dhe shtresa me bindje politike të ndryshme.

Pjesëmarrësit vinin nga rryma të ndryshme politike

Si, Abaz Kupi, Aziz Çami, Halim Begeja, Haxhi Lleshi, Ismail Petrela, Mustafa Xhani, Myslim Peza, Ndoc Çoba, Ramazan Jarani, Skënder Jegeni dhe Skënder Muço.

Nga PKSH morën pjesë Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Koço

Tashko, Enver Hoxha, Nako Spiru dhe Nexhmije Xhuglini (më vonë Hoxha).

Kryetar i konferencës u zgjodh Ndoc Çoba dhe sekretar, Mustafa Gjinishi.

Në konferencë u diskutua organizimi i forcave në një luftë të përbashkët kundër okupatorit, organizim ky që mori emrin më vonë, Fronti Nacional-Çlirimtar.

Të pranishmit hynë në debate në lidhje me simbolet komuniste, si ylli i kuq, i cili nuk pranohej nga jo-komunistët.

U miratua një rezolucion, në të cilin thuhej se përfaqësuesit e të gjitha tendencave nacionaliste, PKSH-së, Rinisë Komuniste, Rinisë Nacionaliste dhe Rinisë Femërore Popullore, miratonin deklaratën përkatëse, ku përkrahej koalicioni kundër boshtit, akuzohej rëndë

Mustafa Kruja dhe përkrahej lufta e atyre çetave që kishin luftuar deri ato momente, duke i dhënë rëndësi, nga ana tjetër, çështjes së këshillave nacionalçlirimtare.

### **Rezoluta e Konferencës së Pezës**

Delegatët e ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, përfaqësuesit e gjithë tendencave të nacionalizmit shqiptar, të Partisë Komuniste, të Rinisë Nacionaliste, të Rinisë Komuniste dhe Rinisë Femnore Popullore të Shqipërisë, të udhëhequr nga qëllimi i shenjtë për çlirimin e Shqipërisë nga thundra e Italisë fashiste dhe nga tradhtarët e shitur tek i huaji, mbasi përkujtuan dëshmorët e rënë në luftë kundër fashizmit, mbasi shqyrtuan mirë gjendjen shqiptare dhe veçanërisht, mbasi theksuan dëshirën dhe nevojën për organizimin e të gjithë energjive shqiptare për bashkim të plotë të tyre me luftën NÇ, arritën në këto përfundime: “Gjendemi në një botë të përgjakur anekënd prej forcave të errëta prej skllavëronjësve të fashizmit. Popuj e kombe u shkelën pa mëshirë prej barbarisë fashiste. Në këtë luftë gjiganteske që i ka kushtuar njerëzimit miliona e miliona të vrarë e të plagosur, që ka shkretuar e ka shembur fshatra e qytete të tëra, dy principe, në kundërshtim si dita me natën, në njërën anë tirania barbare dhe më skllavëronjësja që ka parë bota deri më sot, tirania fashiste, nga ana tjetër, blloku anglo-sovjeto-amerikan, bashkë me popujt e robëruar që bëjnë luftë të drejtë për zhdukjen nga faqja e dheut të murtajes fashiste, luftën për lirinë, për independencën dhe për lumturinë e popujve mbarë.

Traktati i 27 shteteve, i nënshkruar në Uashington prej

Amerikës, Anglisë, Bashkimit Sovjetik dhe Moskës dhe përpjekjet e vetë popujve të shtypur, na japin garanci për pavarësinë dhe lirinë tonë...

Fronti i dytë është një çështje javësh, luftërat nacional – çlirimtare sa vijnë po bëhen më të tmerrshme...”

Shqipëria jonë që nga të parat në Evropë që pati fatin e zi të robërohej prej fashizmit italian me pushkë kresë. Një të premte të zezë, më 7 prill, djemtë e Shqipërisë me Bazin e Canes në krye, i treguan fashizmit italian se populli shqiptar di të vdesë për tokën e vet. Në Shëngjin, në Durrës, në Vlorë, në Sarandë, gjaku i djemve tanë skuqi buzëdetin e Adriatikut. Kudo në Shqipëri u ngrit populli për të rrokur armët, kudo rinia shqiptare kërkoi armë, protestoi me demonstrata, greva e të tjera kundër zaptuesit dhe tradhtarëve. Qindra patriotë morën rrugën e hidhur të mërgimit.

### **Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar**

Konferenca zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacional, të përbërë nga: Kamber Qafmolla (kryetar), Mustafa Gjinishi (sekretar), Ndoc Çoba, Myslim Peza, Abaz Kupi, Enver Hoxha, Ymer Dishnica (anëtar).

Me përjashtim të Enver Hoxhës dhe Myslim Pezës, të gjithë të tjerët u cilësuan si tradhtarë nga historiografia komuniste.

Është për t'u theksuar se konferenca u dekonspirua shumë shpejt, gjë që linte të mendohej se ky dekonspirim kishte qenë shumë i shpejtë falë informatave të siguruara brenda pjesëmarrësve. Pasi fashistët kapën dokumente në lidhje me këtë konferencë, ata goditën Pezën. Pas pak javësh u ndërrua edhe drejtuesi i policisë.



# ISMAIL HAKI KUÇI, atdhetar i madh i kombit



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

## Majori

Ismail Haki Kuçi lindi në Kuç, në vitin 1873, në një familje të njohur për atdhetarizëm. Ismaili u edukua, punoi dhe luftoi për atdheun ndaj pushtuesit të huaj. Arsimin fillor e nisi në Kuç, për të ndjekur arsimin e mesëm dhe të lartë ushtarak në Stamboll. Ky arsimim u bë nën kujdesin e figurës patriotike rilindase, Halil Pashë Gjirokastrës, që ishte mik i familjes së tij.

Ismail Hakiu në radhët e ushtrisë osmane u shqua për kulturë, zgjuarsi, trimëri dhe aftësi si ushtarak dhe kuadër. Ai mori dhe kreu detyra të rëndësishme komanduese, ku në mjaft luftime tregoi zotësi dhe mori gradën e majorit. Kjo gradë ushtarake i hapi rrugët për të ngjitur shkallët e hierarkisë ushtarake, duke u bërë një personalitet i dëgjuar. Por Ismail Hakiu nuk dëshironte t'i shërbente qeverisë osmane dhe interesave të saj, ai donte që t'i shërbente popullit që e kish lindur, rritur dhe edukuar. Ismail Hakiu pati rastin që të njihet nga afër dhe personalisht me figurën kombëtare shqiptare Ismail Qemali dhe të tjerë. Ai nuk gëzohej kur atdheu i tij rënkonte nën robëri, ndaj dhe ndiqte me kujdes e vëmendje ngjarjet në Shqipëri. Ndjenja e atdhedashurisë në personalitetin e tij u shfaq kur ai vendosi të braktiste ushtrinë osmane dhe t'i kushtohej me gjithë shpirt problemeve të kombit. Ismail Haki Kuçi si atdhetar, përparimtar dhe demokrat, braktisi ushtrinë osmane dhe në bashkëpunim me atdhetarin Beqir Gebenenë, u larguan, duke filluar punën në regjimentet e ushtrisë shqiptare. Këto reparte me ligjin e ri "Nizami Xhedit", u kthyen kundër forcave osmane që vepronin në territoret jugore të Shqipërisë, deri në Çamëri dhe më tej, gjer në Janinë.

## Në krye të batalionit shqiptar

Në dokumentet arkivore, Ismail Kuçi, me propozimin e Ismail Qemalit, u emërua nga qeveria e tij, komandant batalioni, formacioni më i lartë ushtarak i kohës. Më 1913 në gradën 'major' komandoi forcat në territorin e Gjirokastrës dhe shpartalloi andartët, duke i vënë përpara deri jashtë kufijve kombëtarë. Ndaj tij, kundërshtarët vunë forca në shkallë të gjerë. Ai me luftime filloi tërheqjen në malet e Kurveleshit, duke organizuar qëndresë. Nga fundi i vitit 1914, udhëhoqi luftimet në Fier dhe Mallakastër, kundër rebelëve esadistë, duke i shpartalluar dhe ndjekur deri në



afërsitë e Lushnjës.

Me zbarkimin e ushtrisë italiane në Shqipërinë e Jugut dhe të Mesme, nga fillimi i vitit 1915 dhe me pushtimin e Shqipërisë së Veriut nga forcat Austro-Hungareze, Ismail Hakiu u largua për në Turqi, i dëshpëruar për të marrë gruan dhe djalin e vëllait të tij të madh. Vëllai i ra dëshmor në Kuç në luftime me andartët grekë, në vitin 1913. Në Turqi u arrestua, u burgos dhe u gjykua si dezertor dhe u dënua. Me ndërmjetësinë e miqve të tij dhe nga autoriteti, nga veprimtaria dhe cilësitë e shquara ushtarake të mëparshme, u lirua nga burgu, u mor sërish oficer i ushtrisë osmane dhe u dërgua Komandant Divizioni me gradën e 'majorit' në qytetin Garza të Jerusalemit. Ismail Hakiu porsa arriti, propagandoi dhe organizoi dezertimin me grupe të shqiptarëve që ndodheshin aty. Në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës dhe luftëtar në Luftën e Vlorës Pas vitit 1917 Ismail Hakiu u arratis dhe nga mesi i vitit 1917, së bashku me oficerë të tjerë, u kthye në Shqipëri. Qeveria e Durrësit e emëroi atë Komandant të Shkollës së Oficerëve, por

komandanti i forcave italiane në Durrës kërkoi pushimin e tij, sepse organizonte dhe zhvillonte veprimtari patriotike kundër pushtimit të Italisë. Ndaj e pushuan dhe u transferua në Elbasan. Këtu lidhi kontakte të ngushta me Aqif Pashë Elbasanin, një nga iniciatorët e Kongresit të Lushnjës. Ismaili në bashkëpunim dhe i ngarkuar prej tij, shkoi në Tiranë, në Ndroq dhe në Lushnje. Bashkë me komandantin e Lushnjës mbledhi dhe organizoi një forcë prej 500 vetash, xhandarë dhe civilë. Në krye të tyre, Ismail Hakiu siguroi mbrojtjen dhe zhvillimin e punimeve të Kongresit të Lushnjës në janar të vitit 1920. Ismaili edhe në këtë kohë u bë një figurë e nderuar atdhetare.

Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare e cakton atë me detyra të ndryshme. Me veprime luftarake spastroi periferinë rajonale të Lushnjës dhe Fierit, deri në afërsi të Vlorës, nga forcat italiane të pushtimit. Kongresi i Lushnjës, me vendim të veçantë, e dërgoi Ismail Hakiun në Vlorë për të luftuar kundër pushtuesit italian. Ismail Hakiu e mirëpriti këtë detyrë dinjitoze.

Me luftëtarët e tij u nis më këmbë, duke përshkuar Myzeqenë dhe arriti në Mifol, ku u takua me komisionin e Luftës së Vlorës. Si ushtarak i lartë u shqua për teori dhe taktikë në drejtim të forcave kryengritëse. Nga Panajaja, Babica e Vogël, Babica e Madhe, Xhuhëria, Kallafeti, Shashica dhe afërsitë e Radhimës, ishte sektori më i rëndësishëm i veprimeve të luftimeve ku mori pjesë. U shqua për trimëri, energji luftarake dhe qëndroi në radhë të parë, deri dhe në luftimin trup me trup me pushtuesin. Ai u mësoi luftëtarëve popullorë artin luftarak praktik dhe i frymëzuar për qëndresë e vendosmëri. Ismail Hakiu organizoi Gjyqin Ushtarak, ku gjykoi e dënoi ushtarakë dezertorë të Luftës së Vlorës.

Ai ishte anëtar i komisionit të organizuar për të arritur armëpushimin me gjeneral Pjaçentinin, i cili kërkonte me çdo kusht të mbante Vlorën dhe Sazanin. Ismail Hakiu me forcë kërkonte që pushtuesit të paguanin dëmtimet e luftës dhe shkatërrimet, të dorëzonin dhe të linin në vend të gjithë materialin luftarak, me të cilin kishin luftuar, veshmbathjen, ushqimin dhe materialet e depove dhe të magazinave të tyre, për të plotësuar nevojat e popullit të shkatërruar.

Nguli këmbë që italianët të dorëzonin dhe të lironin të gjithë personat që mbaheshin peng në Sazan, duke vepruar që edhe shqiptarët të lironin ushtarakët italianë të zënë rob, gjatë betejës e luftimeve dhe që ruheshin në Vajzë të Vlorës dhe Tepelenë. Ismail Hakiu ishte kundër vendimit të marrëveshjes për t'u lënë pushtuesve Sazanin, sepse Sazani, sipas tij, ishte porta e kalasë shqiptare.

#### **Në detyrën e qark komandantit**

Pas Luftës së Vlorës 1920, punoi për organizimin dhe stërvitjen e paraushtarakëve për të formuar një ushtri shqiptare sa më të fortë. Pas Luftës së Vlorës luftoi në Mat kundër serbëve, të cilët i nxori jashtë luftimit dhe çliroi zonën, si dhe shpartalloi forcat që kërkonin të rrëzonin qeverinë e Sulejman Delvinës.

Pas luftimeve kundër serbëve në Mat, ai u dërgua Qark Komandant në qytetin e Gjirokastrës. Ai organizoi punën për prurjen e ujit të pijshëm të Sopotit në Kalanë e Gjirokastrës, në bashkëpunim e marrëveshje me administratën shtetërore dhe popullin e qarkut të Gjirokastrës. Fshatarësia dhe pleqësia e tyre e donin dhe e nderonin Ismail Hakiun. Kështu ndërtoi një pjesë të rrugës dhe

periferisë së kalasë, meremtoi kalanë dhe vuri rregulla për të ruajtur dhe mbrojtur kalanë, sheshet e saj, si monument historik me vlera kombëtare.

Ismaili bashkëpunoi dhe bindi parinë e Kurveleshit dhe të Gjirokastrës për të luftuar energjikisht kundër elementëve që punonin për të minuar unitetin kombëtar. Bashkë me ta zbuloi, burgosi dhe organizoi gjyqin ushtarak të posaçëm, për dënimin e këtyre keqbërësve. Propagandës antikombëtare të disa elementeve që vepronin në Himarë, Delvinë dhe Sarandë, Ismail Haki Kuçi iu kundërvu me të gjithë vendosmërinë e tij. Ai arriti dhe t'i dërgojë një telegram Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, ku shquhej theksi i qëndrimit të tij patriotik. Ismail Kuçi bëri mbledhje me popullin e Delvinës, Sarandës dhe Bregdetit për të larguar farën e përçarjes, në mes të krahinave jugore dhe bregdetare.

#### **Përsëri qëndresë**


Në fillim të vitit 1922 u gjend në Durrës i transferuar dhe më 8 mars 1922, mori pjesë aktivisht në Lëvizjen e Marsit për zgjedhje të lira. Mirëpo Lëvizja e Marsit dështoi, Ismail Hakiu u mënjanua dhe mërgoi në Itali, pasi ishte dënuar me vdekje në litar. Në Itali punoi dhe shërbeu në një lokal shërbimi si pastrues. Së bashku me shokët e tij u ndihmuan nga Shoqëria Patriotike "Vatra". Nga fundi i vitit 1922, Ismail Haki Kuçi u kthye përsëri në atdhe. Miqtë dhe patriotë organizuan një peticion të firmosur nga populli i Kurveleshit dhe i Tepelenës, ku i kërkohet qeverisë lirimi i tij, kjo e detyroi qeverinë ta nxirrte në pension.

Më 1924, Ismail Hakiu, shkoi nga Durrësi në Vlorë me kortezhin që përcolli trupin e Avni Rustemit dhe mori pjesë në varrimin e tij. U radhit vendosmërisht në anën e lëvizjes së Nolit, me Kasëm Qafëzezin, Rexhep Shalën dhe shumë atdhetarëve demokratë dhe përparimtarë të kohës. Qeveria e Fan Nolit e rimori përsëri në shërbim si ushtarak Ismail Kuçin.

Zogu shpejt, pas gjashtë muajve, u rikthye në vend me sulme dhe operacione nga veriu i ndihmuar nga serbët. Ismail Hakiu komandant ushtarak i zonës së jugut, grumbulloi me shpejtësi dhe armatosi civilë dhe xhandarë, u nis nga Vlora drejt Tiranës, tek Shkallët e Tujanit dhe Guri i Bardhë. Ismail Hakiu sërish kthehet në jug, i dëshpëruar. Vendoset në Kuç, në vendlindje. Por qeveritarët e riardhur, më shumë për ta patur nën tutelë, e riveshën përsëri major në Gjirokastrë. Ai punoi me të gjitha fuqitë e tij për vepra bamirëse në shërbim të popullit. Mbledhi popullin e krahinës së Kurveleshit dhe u shfaq idenë për të ndërtuar rrugën Kuç-Borsh, një spital dhe një konvikt në Kuç. Për këto ai ndërhyri deri në Ministrinë Botore. Ismail Hakiu survejohej dhe ndiqej nga njerëz të caktuar, me qëllime antikombëtare e shoviniste. Sa në Shkodër, në Durrës dhe në Shijak, ku dhe e helmuan në vitin 1928. Ismail Hakiu, ishte bashkëpunëtor i ngushtë me Ismail Qemalin, Bajram Currin, Avni Rustemin, Halim Xhelon, Sali Cekën e shumë të tjerë. Ai u takua me personalitete të shquara të botës së qytetëruar të kohës, si francezi Justin Godard.

Vepra e atdhetarit të madh të kombit, Ismail Haki Kuçi, kujtohet dhe nderohet gjithmonë, pasi ai punoi për popullin dhe vendin e tij. Kurveleshi, në vitin 1942, batalionin partizan e pagëzuan me emrin "Ismail Hakiu". Kjo figurë e madhe e ushtrisë kombëtare shqiptare, është dekoruar dhe vlerësuar me urdhra dhe medalje të ndryshme, si "Për veprimtari patriotike", etj.

# Mbrojtja



<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>